

HUMAN

RIGHTS

HUMAN

**RAPORT I SHOQËRISË
CIVILE PËR TË DREJTAT
E NJERIUT**

NË KOSOVË NË VITIN 2021

HUMAN

RIGHTS

MAJ 2022

PËRMBAJTTJA

1. HYRJE

2. METODOLOGJIA

3. KORNIZA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË KOSOVË

4. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI NDIKIMIN E PANDEMISË COVID-19 NË TË DREJTAT E NJERIUT NË KOSOVË

5. PJESA A: TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE

- 5.1. E drejta për jetën
- 5.2. E drejta për trajtim njerëzor dhe ndalim të torturës
- 5.3. E drejta për liri dhe siguri të personit
- 5.4. E drejta për proces të rregullt gjyqësor dhe mjete juridike efektive
- 5.5. Liria e shprehjes dhe e mendimit, e drejta për informim dhe e drejta e privatësisë
- 5.6. Liria e tubimit paqësor
- 5.7. Liria e asociimit
- 5.7. Liria e besimit, ndërgjegjes dhe e fesë

6. PJESA B: TË DREJTAT EKONOMIKE, SOCIALE DHE KULTURORE

- 6.1. Të drejtat e punës
- 6.2. E drejta për arsim
- 6.3. E drejta për kujdes shëndetësor
- 6.4. Të drejtat pronësore
- 6.5. Të drejtat kulturore

7. PJESA C: TË DREJTAT E PERSONAVE DHE GRUPEVE TË CAKTUARA

- 7.1. Të drejtat e grave dhe barazia gjinore
- 7.2. Të drejtat e fëmijëve
- 7.3. Të drejtat e të rinjve
- 7.4. Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara
- 7.5. Të drejtat e komuniteteve jo-shumicë
- 7.6. Të drejtat e komuniteteve LGBTIQ+
- 7.7. Personat në lëvizje

8. Pjesa D: ÇËSHTJE TË NDËRLIDHURA/ÇËSHTJE SPECIFIKE LIDHUR ME TË DREJTAT E NJERIUT

- 8.1. Drejtësia tranzicionale dhe të drejtat e njeriut
- 8.2. Korrupsioni dhe të drejtat e njeriut
- 8.3. Mjedisi dhe të drejtat e njeriut

LISTA E AKRONIMEVE DHE SHKURTESAVE

AGK	Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës
AGTSH	Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë
AIP	Agjencia për Informim dhe Privatësi
AKKVP	Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës
Ashkali-K	Ashkali i Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
DUDNj	Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
DSLK	Dhuna seksuale e lidhur me konfliktin
Egjiptian-K	Egjiptian i Kosovës
IAP	Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
KDF	Konventa e të Drejtave të Fëmijëve
KDPAK	Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
KEDNj	Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore
KEGFDG	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
KEGFDR	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor
KEPT	Komisioni Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit apo Ndëshkimit Çnjerëzor apo Poshtëruar
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KK	Kuvendi i Kosovës
KKMPK	Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare
Komisioni i Venedikut	Komisioni Evropian i Venedikut për Demokraci përmes Ligjit
Konventa e Stambollit	Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
KOS	Kisha Ortodokse Serbe
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KQVR	Këshilli Qendror i Veprimit Rinor
KTN	Konventa kundër Torturës dhe Dënimeve ose Trajtimeve të tjera të Ndëshkimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruar
KVRL	Këshillat e Veprimit Rinor Lokal

KZM	Këshilli për Zbatim dhe Monitorim
LGBTIQ+	Lezbike, Gej, Biseksual, Transseksual, Interseks dhe Queer
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MPK	Mekanizmi Parandalues Kombëtar
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
OJQ(të)	Organizata(t) joqeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OP-CAT	Protokolli Fakultativ i Konventës kundër Torturës dhe Trajtimit apo Formave të tjera të Ndëshkimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruar
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OSHC(të)	Organizata(t) e shoqërisë civile
PNDPCP	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike
PNDESK	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore
PPM	Pajisje Personale Mbrojtëse
PSK	Prokuroria Speciale e Kosovës
QBPZh	Qendra Burimore për Persona të Zhdukur
OHCHR	Zyra e Komisarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut
QK	Qeveria e Kosovës
Rom-K	Rom i Kosovës
Serb-K	Serb i Kosovës
ShKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës
Shqiptar-K	Shqiptar i Kosovës
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë
UNHCR	Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
ZQM	Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mosdiskriminim

1. HYRJE

1. Ky dokument përbën raportin e tretë vjetor të OSHC-ve mbi situatën e të drejtave të njeriut në Kosovë për vitin 2021.¹ Raporti është realizuar bashkërisht nga organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të) që punojnë në një numër të gjerë fushash që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut. Qëllimi i këtij raporti është të shërbejë si mjet i pavarur për vlerësimin e gjendjes së përgjithshme të të drejtave të njeriut në Kosovë, duke e plotësuar kështu boshllëkun ekzistues në raportimin e përbashkët për të drejtat e njeriut në Kosovë në nivel vendor dhe ndërkombëtar, si dhe për ta shtuar bashkëpunimin dhe koordinimin mes OSHC-ve.

2. Ky raport është i strukturuar në katër pjesë kryesore. Pjesa A trajton të drejtat civile dhe politike, duke përfshirë të drejtën për jetën, të drejtën për trajtim njerëzor dhe ndalimin e torturës; të drejtën për liri dhe siguri të personit, të drejtën për proces të drejtë gjyqësor dhe qasje në drejtësi; lirinë e shprehjes, mendimit, informimit dhe të drejtën e privatësisë; lirinë e tubimit paqësor; lirinë e asociimit dhe lirinë e besimit, fesë dhe ndërgjegjës. Në Pjesën B analizohen të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, siç është e drejta për arsim; e drejta për kujdes shëndetësor; të drejtat e punës dhe e drejta për pronësi dhe përmblyllet me një vështrim të përgjithshëm të të drejtave kulturore. Pjesa C trajton të drejtat e grupeve dhe personave të caktuar, siç janë të drejtat e fëmijëve, të rinjve, personave me aftësi të kufizuara, komunitetet jo-shumicë, komunitetet LGBTIQ+ dhe personat në lëvizje. Raporti përmbillet me Pjesën D, ku shtjellohen një numër çështjesh të ndërlidhura dhe specifike për të drejtat e njeriut, siç është drejtësia tranzicionale dhe të drejtat e njeriut, korrupsioni dhe të drejtat e njeriut dhe ndikimi i çështjeve mjedisore në të drejtat e njeriut.

2. METODOLOGJIA

3. Raporti i përbashkët i OSHC-ve për të drejtat e njeriut për vitin 2021 shërben si vështrim gjithpërfshirës i gjendjes së të drejtave të njeriut në Kosovë në vitin 2021. Dokumenti reflekton mbi fushat kritike për ta kuptuar thellë zhvillimin e të drejtave të njeriut në Kosovë në kontekstin e tranzicionit të saj në një shoqëri demokratike me vlera universale të gjithpërfshirjes në thelb. Metodologjia është mbështetur me nevojën për një perspektivë të gjerë që ndërlidh aspektet e politikave, praktikës dhe përvojës. Si i tillë, raporti i përbashkët i OSHC-ve dallon nga shumë vështrime të tjera mbi të drejtat e njeriut në Kosovë. Edhe pse raporti është gjithpërfshirës, duhet pranuar që ka kufizime në atë që është mbuluar.

4. Procesi i hartimit të raportit është udhëhequr nga parimi i pjesëmarrjes dhe pronësisë së plotë të të gjitha OSHC-ve që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut në Kosovë. Në mbledhjen e të dhënave për përpilimin e raportit të përbashkët të OSHC-ve janë përfshirë disa qasje.

¹ Shih Raportet përkatëse të Organizatave të Shoqërisë Civile për situatën e të Drejtave të Njeriut në Kosovë në vitet 2019 dhe 2020. Ky raport u realizua me mbështetjen financiare të Komponentës së të Drejtave të Njeriut të Administratës së Përkohshme të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe Zyrës së Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (ZKLDNJ) si dhe të Mbrojtësve të të Drejtave Civile (MDC). Pikëpamjet e shprehura këtu janë vetëm të OSHC-ve kontribuese që e kanë përpiluar

Së pari, raporti është rezultat i kontributeve përkatëse të 37 OSHC-ve të përkushtuara ndaj çështjeve të caktuara të të drejtave të njeriut. Secilës OSHC i është kërkuar të ofrojë të dhëna esenciale në fushën e tyre përkatëse të punës. Kjo mundësoi që raporti të klasifikohet në katër pjesë: Pjesa A ka të bëjë me gjendjen e të drejtave civile dhe politike në Kosovë. Kjo pasohet nga Pjesa B, ku adresohen çështjet socio-ekonomike dhe kulturore. Në Pjesën C, trajtohen të drejtat e personave dhe grupeve të caktuara, pasuar nga tema të ndërlidhura duke përfshirë drejtësinë tranzicionale, korrupsionin dhe mjedisin në Pjesën D. Pjesa e dytë e këtij procesi ka përfshirë hulumtimin e literaturës. Për çdo pjesë të raportit, të dhënat janë mbledhur nga një mori burimesh të besueshme duke përfshirë dokumentet zyrtare të institucioneve qeveritare, raportet e organizatave ndërkombëtare dhe të ambasadave të huaja si dhe publikime të respektuara akademike dhe lajme nga mediat tradicionale. Përveç kësaj, raporti është rishikuar në dy faza të procesit të hartimit. Përmes tri takimeve këshilluese të organizuara nga Rrjeti i të Drejtave të Njeriut (RrDNj) (Nëntor 2021, shkurt 2022 dhe mars 2022), OSHC-të kontribuese kanë pasur mundësi t'i adresojnë çështjet dhe të japin sugjerime të cilat më pas u përfshinë në raportin e përbashkët të OSHC-ve.² Tutje, procedurat e konsultimit u mundësuan përmes korrespondencës me email mes OSHC YIHR KS, e cila shërben si sekretariat i RrDNj dhe dy hulumtuesve të jashtëm.

5. Në këtë raport kanë kontribuar 37 OSHC-të në vijim: Activism Roots, Advancing Together (AT), Artpolis, Rrjeti i Gazetarisë Hulumtuese në Ballkan (BIRN), Balkan Sunflowers Kosova (BSFK), Qendra e Berlinit për Ndërmjetësim të Integruar – QBNN, Qendra për Veprime Afirmative Sociale (CASA), Qendra për Barazi dhe Liri (CEL), Programi i të Drejtave Civile në Kosovë (PDC/K), Platforma CiviKos, Lëvizja FOL, Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ), Qendra e Inovacionit të Graçanicës (GIC), Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), HANDIKOS, Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë (HLCK), Koalicioni i Organizatave Joqeveritare (OJQ) për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMF), Koalicioni K10 me OJQ-në lidere Aksioni për Nëna dhe Fëmijë (AMC), Qendra për Arsimim e Kosovës (KEC), Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK), Kosova Young Lawyers (KYL), Këshilli Rinor Kosovar (KRK), Nisma Lokale LINK, Medica Gjakova, Qendra Burimore për Persona të Zhdukur (QBPZH), Rrjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptiane të Kosovës (RROGRAEK), Nisma e Re Sociale (NSI), OJQ AKTIV, OJQ THY, Roma Versitas Kosova (RVK), Syri i Vizionit, Terre des Hommes Kosovo (TDH), Zëri i romëve, ashkalive dhe egjiptianëve (VoRAE), Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë (YIHR KS). Kontributi përkatës i OSHC-ve për raportin e përbashkët është referuar në fusnota gjatë tërë tekstit.

3. KORNIZA E PËRGJITHSHME E TË DREJTAVE TË NJERIUT NË KOSOVË

6. Kushtetuta e Kosovës dhe legjislacioni i saj janë të harmonizuara me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, duke garantuar kështu të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

² Rrjeti i të Drejtave të Njeriut (RrDNj) (2021). RrDNj është një rrjet i përbërë nga shtatë organizata që punojnë së bashku për t'i avancuar më tutje të drejtat e njeriut për të gjithë në Kosovë. Anëtarët e RrDNj-së janë: Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Kosovë (YIHR KS), Shoqata e Paraplegjikëve dhe Fëmijëve të Paralizuar të Kosovës HANDIKOS, Qendra për Barazi dhe Liri (CEL), Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK), Nisma e Re Sociale (NSI), Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve (VoRAE). YIHR KS është organizata themeluese dhe sekretariat i RrDNj.

Mbrojtja e të drejtave të njeriut paraqitet në tri dimensione në Kushtetutë. Së pari, Kushtetuta përcakton dispozita të shumta lidhur me mbrojtjen dhe promovimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut.³ Nga dispozitat e përgjithshme e më tutje (Neni 3), Kushtetuta parasheh obligim për autoritetet publike në Kosovë për të siguruar trajtim të barabartë të të gjithë individëve para ligjit dhe respektim të plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të pranuar ndërkombëtarisht. Në nenin 7, Kushtetuta përcakton që rendi kushtetues i Kosovës bazohet në rend të parë në barazi, respektim të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe mosdiskriminim. Poashtu e mishëron barazinë gjinore si vlerë themelore. Kapitulli II i Kushtetutës i përcakton dispozitat kryesore të cilat i mbrojnë të drejtat civile dhe politike (p.sh. të drejtat për proces të rregullt gjyqësor, e drejta e privatësisë dhe liria e mendimit dhe e shprehjes, liria e tubimit paqësor, e shoqërimit dhe e lëvizjes) si dhe të drejta ekonomike, shoqërore dhe kulturore (p.sh. e drejta për arsim dhe liria e zgjedhjes së profesionit). Duhet të ceket që me nenin 53 përcaktohet që të gjitha interpretimet e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutën e Kosovës duhet t'i përmbahen jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

7. Kushtetuta përbëhet nga instrumente të shumta ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Integrimi i kornizës ndërkombëtare është paraparë në nenin 22: Nëntë instrumente rajonale dhe të OKB-së të të drejtave të njeriut zbatohen drejtpërdrejt në Kosovë, duke e fuqizuar kështu promovimin e të drejtave të njeriut në Kosovë në një bazë universale ligjore.⁴ Një zhvillim i rëndësishëm për të drejtat e grave dhe vajzave është përfshirja në Konventën e Stambollit. Në shtator të vitit 2020, KK e ndryshoi nenin 22 duke e shtuar Konventën e Stambollit në listën e instrumenteve të të drejtave të njeriut që zbatohen drejtpërdrejt.⁵ Është e rëndësishme të theksohet që këto instrumente të të drejtave të njeriut që zbatohen drejtpërdrejt kanë përparësi ndaj legjislacionit të Kosovës në raste të interpretimit të devijuar apo konfliktit. IPNDESHK nuk është radhitur në mesin e instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që zbatohen drejtpërdrejt në Kosovë. Për këtë arsye, KK e miratoi në janar 2018 Agjendën e vitit 2030 dhe 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm në mënyrë unanime. Kjo ofroi një pikënisje domethënëse për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore në Kosovë.

8. Organet mbikëqyrëse që e sigurojnë zbatimin e kornizës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që iu japin prioritet instrumenteve ndërkombëtare ndaj atyre të legjislacionit të Kosovës mbesin në juridiksionin e Kosovës. Kjo për arsye se Kosova nuk është anëtare e asnjërës prej organeve të traktateve ndërkombëtare të përfshira në deklaratat universale. Siç u tha më sipër, në nenin 53 theksohet në mënyrë specifike GJEDNJ në përpjekje për ta harmonizuar plotësisht interpretimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore me Komisionin Evropian edhe pse Kosova nuk është anëtare e Këshillit të Evropës.

9. Kushtetuta e Kosovës është veçanërisht e përkushtuar ndaj mbrojtjes dhe promovimit të komuniteteve jo-shumicë që kanë qenë tradicionalisht dhe historikisht të pranishme në Kosovë.⁶

³ [Kushtetuta e Kosovës](#) (2008).

⁴ Në nivel të OKB-së, këtu hyn [UDHR](#) (1948), [CCPR](#) (1966,1977), [CERD](#) (1965), [CEDAW](#) (1981); [CRC](#) (1990) dhe [CAT](#) (1984). Në nivel të BE-së, këtu hyn [GJEDNJ](#) (1950), [FCNM](#) (1995), [Konventa e Stambollit](#) (2011).

⁵ [Kushtetuta e Kosovës](#) (2008).

⁶ Ibid.

Mekanizmat me pushtet të ndarë të përshkruar në Kushtetutë iu ofrojnë komuniteteve jo-shumicë mbrojtje të konsiderueshme ligjore.

10. Në vitin 2015, Kosova bëri progres të mëtutjeshëm në harmonizimin e kornizës së saj ligjore me standardet ndërkombëtare. Në veçanti, QK e miratoi pakon e ligjeve themelore për të drejtat e njeriut, gjegjësisht, Ligjin nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Ligjin nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore dhe Ligjin nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi. Zbatimi i plotë i tyre është thelbësor për zbatimin efektiv të kornizës së të drejtave të njeriut në Kosovë dhe kërkon alokimin e burimeve të nevojshme dhe përpjekje serioze për ngritjen e kapaciteteve. Siç theksohet në tërë raportin, përveç ligjeve të renditura më lartë, Kosova ka miratuar edhe shumë ligje të tjera specifike lidhur me mbrojtjen e të drejtave dhe grupeve të caktuara.

11. QK e promovon dhe i mbron të drejtat e njeriut përmes mekanizmave të veçantë dhe organeve mbikëqyrëse. Në veçanti, Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Kundër Diskriminimit (ZQM) harton politika në fushën e qeverisjes së mirë, të drejtave të njeriut, mundësive të barabarta dhe në luftën kundër diskriminimit. ZQM poashtu i mbikëqyr dhe i këshillon Ministrinë në fushat e përmendura. Grupi Koordinues Ndërministror për të Drejtat e Njeriut është një mekanizëm politik i nivelit të lartë i krijuar nga Qeveria e Kosovës në prill të vitit 2016 për ta monitoruar zbatimin e politikave të të drejtave të njeriut në Kosovë. Takimi i fundit i këtij Grupi u mbajt gjatë periudhës së raportimit në korrik të vitit 2021. Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione ka mandat të përhershëm për të hartuar projektligje dhe për ta monitoruar zbatimin e ligjeve ekzistuese. Edhe pse Komisioni fillimisht nuk ishte paraparë si mekanizëm individual i ankesave, ai mund t'i theksojë çështjet dhe trendet e të drejtave të njeriut brenda KK-së dhe t'i adresojë ankesat individuale ose grupe, sipas nevojës. Institucioni i Avokatit të Popullit i Kosovës (IAP) është organ i pavarur kushtetues i cili e ka për detyrë mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të individëve nga shkeljet e autoriteteve. Në përmbushjen e mandatit të tij, mes tjerash, IAP mund të pranojë ankesa, të nisë hetime, të bëjë rekomandime dhe të publikojë raporte, si dhe të avokojë për ndryshime që e përmirësojnë zbatimin e standardeve të të drejtave të njeriut.

12. Kah fundi i vitit 2021, QK prezantoi një nismë për ta prezantuar një ligj me të cilin personave në Kosovë do t'u jepeshin më shumë mundësi për realizimin e të drejtave të tyre civile, veçanërisht të drejtën për proces të drejtë gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm kohor. Nëse hartohet dhe zbatohet në mënyrë efektive, ligji mund të ketë ndikim pozitiv për promovimin e proceseve të drejta dhe të paanshme gjyqësore pasi që parasheh mjete juridike kur shkelen kushtet e afatit të arsyeshëm kohor. Hapat e ardhshëm për këtë nismë pritet të konkretizohen në vitin 2022.

4. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI NDIKIMIN E PANDEMISË COVID-19 NË TË DREJTAT E NJERIUT NË KOSOVË

13. Pandemia ende e pranishme e COVID-19 vazhdoi të ndikojë në zhvillimin e situatës së të

Sa i përket situatës emergjente shëndetësore, QK u zotua se do t'i jepte prioritet menaxhimit të pandemisë së COVID-19 në programin e saj qeverisës të prezantuar në KK në maj të vitit 2021. Programi përfshin synimin për ta arritur një shkallë të vaksinimit prej 60 përqind deri në fund të vitit 2021. Që nga fillimi i Planit të Shpërndarjes dhe Vaksinimit në fund të marsit 2021, qeveria ka përdorur fushata aktive të vaksinimit dhe ka siguruar ekipe mobile të kujdesit shëndetësor për ta lehtësuar qasjen e lehtë dhe jodiskriminuese në qendrat e vaksinimit. Megjithatë, sipas raportit të BE-së, shumë banorë serbë-K janë vaksinuar në lokacione të përzgjedhura në Serbi.⁷ Përveç kësaj, kapacitetet diagnostifikuese janë shtuar për dhjetë herë më shumë me përdorimin e pajisjeve vitale të siguruar që nga fillimi i pandemisë. Megjithatë, përkundër këtyre përpjekjeve, shkalla e vaksinimit mbetet e ulët në krahasim me shtetet e tjera të Ballkanit perëndimor.⁸

14. Lidhur me të drejtën për qasje të përbalueshme dhe jodiskriminuese në vaksinat kundër COVID-19, Kosova e mori kontigjentin e parë të vaksinave AstraZeneca nga COVAX vetëm më 28 mars, duke ia mundur ta fillojë planin e vaksinimit prej tri fazash për vaksinimin e 60 përqind të popullsisë, duke iu dhënë përparësi fillimisht punëtorëve shëndetësorë, të moshuarve mbi moshën 80 vjeçare dhe personave të tjerë me sëmundje kronike. Pas arritjes së vaksinave shtesë, shtrirja e vaksinimit u zgjerua për t'i përfshirë personat mbi moshën 65 vjeçare në maj dhe kategoritë e tjera të njerëzve në qershor, si mësimdhënësit, stafi i mediave dhe personat me sëmundje kronike dhe për fëmijët e moshës 12 deri 15 vjeç në nëntor. Raportohet se Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK) kishte vaksinuar 90 përqind të të burgosurve me së paku një dozë të vaksinës deri më 2 shtator.⁹ Për t'i adresuar raportimet që pjesëtarët e komuniteteve rom-K, ashkali-K dhe egjiptian-K po përjashtoheshin nga procesi, Ministria e Shëndetësisë në korrik formoi ekipe mobile të vaksinimit për ta lehtësuar vaksinimin e tyre dhe për t'i vaksinuar personat e tjerë të cilët ishin fizikisht të paftë të udhëtonin për në qendrat e vaksinimit. Disa komuna, si Mitrovica e Jugut, Peja dhe Ferizaji, vunë në funksion ekipet mobile të vaksinimit për vaksinimin e pjesëtarëve të komuniteteve rom-K, ashkali-K dhe egjiptian-K, ndërsa OJQ BSKF punoi edhe për identifikimin dhe vaksinimin e pjesëtarëve nga këto komunitete në 13 komuna me mbështetjen e OKB-së. Përveç kësaj, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Ferizaj raportoi që i kishte vaksinuar 155 refugjatë afganë, ndërsa qendra e azilit në Magurë organizoi vaksinimin për mbi 30 azilkërkues.¹⁰

15. Përgjatë periudhës së raportimit, QK i hoqi, rishikoi dhe rivendosi një varg masash kundër COVID-19. Ngjashëm me trendet globale të përhapjes së COVID-19, në gusht u shënuar një rritje e papritur e infektiveve të reja me COVID-19. Kjo e nxiti QK-në t'i rikthente disa masa të reja për mbrojtjen e shëndetit.¹¹ Përveç kësaj, strategjia e përgjithshme institucionale e qeverisë lidhur me krizën e pandemisë ka qenë me miratimin e Ligjit Nr. 07/L-066 për Parandalimin dhe Luftimin e pandemisë COVID-19 në Kosovë. Ky Ligj parasheh masa që mund ta zëvendësojnë përkohësisht realizimin e plotë të të drejtave të njeriut për ta parandaluar përhapjen e mëtejshme të COVID-19. Këtu hynë kufizimet mbi të drejtën për tubim paqësor, të drejtat fetare, kulturore, lëvizja dhe të drejta të ngjashme që mund të bien ndesh me menaxhimin efektiv të përhapjes së pandemisë.

7 Komisioni Evropian (2021), [Raporti Vjetor i Progresit](#).

8 [Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës](#) (2022).

9 [Gazeta Metro](#) (2021).

10 [Zeri](#) (2021).

11 Komisioni Evropian (2021), [Raporti Vjetor i Progresit](#).

16. Masat që u morën në vitin 2021 për ta kontrolluar COVID-19 përfshinë orën policore, kufizimin e tubimeve deri në vetëm 10 persona në një kohë, lejimin e tubimeve fetare nga 5 prilli vetëm me kapacitete të kufizuara, lejimin e aktiviteteve kulturore me kapacitete të reduktura dhe ngritjen e kufizimeve të ndryshme për orarin e punës së bizneseve.¹² Më 6 dhjetor, QK vendosi një regjim obligativ të vaksinimit me të cilin pjesëmarrja në shumicën e fushave të jetës publike obligohej me dëshminë e dy dozave të vaksinave ose njëres dozë plus një test negativ PCR apo dëshmi që nuk jeni infektuar me COVID-19 në gjashtë muajt e fundit.¹³ Në veçanti, nga ky vendim u përjashtuan personat “me dëshmi mjekësore të cilët kanë kontraindikacione ndaj vaksinimit të dëshmuara në mënyrë shkencore”, edhe pse, megjithatë, iu kërkohej të paraqitnin test negativ PCR.

17. Të gjitha vendimet e QK-së lidhur me COVID-19 kërkuan që institucionet relevante ta monitoronin situatën epidemiologjike dhe t’i zbatonin masat, respektimi i të cilave mund të konsiderohet si synim për të qenë të harmonizuara me detyrimet e tyre për vëmendje të duhur pozitive ndaj të drejtës për shëndet dhe për jetë për ta zvogëluar përhapjen e sëmundjeve me kërcënim për jetën. Në prill, u arrestua një zyrtar policor nën dyshimin se ka përdorur forcë të tepruar ndaj një personi gjatë zbatimit të masave kundër COVID-19. OSHC-të raportuan që reagimi i qeverisë ndaj pandemisë pati shumë sfida, duke përfshirë mungesën e një baze të qartë ligjore për vendime, strategjitë e vjetëruara të reagimit në situata emergjente dhe burime e kapacitete të kufizuara.

18. Sa i përket të drejtës për arsim, shkollat vazhduan ta përdorin një version të kombinuar të të mësuarit në prani fizike dhe në distancë në sistemet arsimore të mbështetura nga Kosova dhe të mbështetura nga Serbia, megjithëse disa nivele të klasave u kthyen përsëri në mësim vetëm në distancë në mars, prill, gusht dhe shtator për shkak të gjendjes së rëndë epidemiologjike, duke ngritur shqetësime për nxënësit që nuk kishin pajisje teknologjike dhe/ose qasje në internet. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) e Kosovës njoftoi që, bazuar në vendimin e saj të 20 prillit, arsimi plotësues do të fillonte më 5 maj për nxënësit që kishin përjetuar “stagnim në arritjen e rezultateve [arsimore]” për shkak të pandemisë, duke përfshirë nxënësit me aftësi të kufizuara. Shkollat fillore dhe të mesme publike dhe private në sistemin e mbështetur nga Kosova mbetën të mbyllura deri më 26 shtator, ndërsa institucionet parashkollore dhe qendrat e kujdesit ditor ishin të mbyllura nga 12 deri më 26 shtator. Më 27 shtator, shumica e institucioneve publike dhe private të arsimit parauniversitar e filluan vitin e ri akademik në prani fizik me jo më shumë se 20 nxënës për klasë. Sipas MASHTI-t, një numër i vogël i shkollave filluan të mësojnë duke e përdorur një version të kombinuar të të mësuarit në prani fizike dhe në distancë, ndërsa pesë shkolla në Kamenicë e shtyen procesin e mësimdhënies për shkak të shpërndarjes së stafit mësimdhënës në shkolla të tjera. Shkollat fillore dhe të mesme në veri të Kosovës brenda sistemit të mbështetur nga Beogradi filluan të mësojnë duke përdorur të mësuarit në distancë gjatë shtatorit, ndërsa parashkolloret mbeten të mbyllura.

19. Në lidhje me pasojat socio-ekonomike të përhapjes së COVID-19, përpjekjet e qeverisë për lehtësimin e pjesërishtëm të efekteve u plotësuan me avancimin e skemave të rimëkëmbjes ekonomike. Në veçanti, KK e miratoi një rritje të buxhetit për vitin 2021 për financimin e pakos së rimëkëmbjes ekonomike prej 420 milion Euro.

12 QK (2021), [Vendimi i Qeverisë nr. 01/05](#)

13 Ibid.

20. Kriza shëndetësore e ka penguar edhe zhvillimin e reformave në lidhje me BE-në dhe planet zhvillimore të Kosovës. Fillimisht, QK u zotua në programin e saj kombëtar se do ta zbatonte fazën e dytë të agjendës së reformave evropiane përmes një plani të dedikuar të veprimit të miratuar në gusht të vitit 2021. Së dyti, kufizimet kundër COVID-19 e vështirësuan rëndë bashkëpunimin efektiv të qeverisë me OSHC-të sipas Strategjisë Kombëtare 2019-2023.

21. Pandemia e vazhdueshme me COVID-19 i theksoi ngecjet në sistemin gjyqësor të Kosovës. Numri i madh i rasteve i vështirësoi të drejtat elementare administrative. Masat parandaluese të shkaktuara nga pandemia e kufizuan numrin e seancave gjyqësore, duke e kufizuar rrjedhimisht qasjen në drejtësi dhe të drejtën për proces gjyqësor në kohë të arsyeshme. Përkundër kësaj, disa seanca u mbajtën në mënyrë elektronike, por investimi teknologjik dhe zgjerimi i shërbimeve të TI-së në institucionet gjyqësore ka nevojë urgjente për përmirësim nëse do t'iu përshtaten me efikasitet kushteve të krijuara nga pandemia.

22. Pandemia dhe masat për kontrollimin e COVID-19 vazhduan të ndikojnë në mënyrë jodisproportionale në të drejtat e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë në Kosovë dhe të personave në gjendje të cenueshme. Të drejtat e grave dhe vajzave vazhduan të ndikohen në mënyrë të pabarabartë nga kriza e vazhdueshme e COVID-19 për shkak të rritjes së raportuar të rasteve të dhunës me baza gjinore, duke përfshirë dhunën në familje dhe dhunën seksuale dhe punën e papaguar në përkujdesje, duke rezultuar në pengesa të konsiderueshme në përpjekjet për ta avancuar barazinë gjinore. Sipas Policisë së Kosovës, periudha janar-dhjetor 2021 pa 2,456 raste të raportuara të dhunës në familje, një rritje prej 2,069 rasteve të raportuara të dhunës në familje në vitin 2020.¹⁴ Pandemia poashtu vazhdoi të ndikojë në mënyrë jo të barabartë në të drejtat e fëmijëve për jetën, shëndetin fizik dhe mendor, sigurinë dhe arsimin, sidomos për fëmijët me aftësi të kufizuara.¹⁵ Pjesëtarët e Komuniteteve LGBTI+ vazhduan të ndikohen në mënyrë disproporcionale nga pandemia, pasi që komuniteti përjetoi një numër të pabarabartë të humbjes së vendeve të punës, ndikim negativ në shëndetin mendor, mbështetje tek partnerët dhe familja për mbështetje financiare dhe nevojë të shtuar për strehim nga dhuna në familje.¹⁶ Kriza e vazhdueshme vazhdoi ta pengojë realizimin e të drejtave të pjesëtarëve të komuniteteve rom-K, ashkali-K dhe egjiptian-K pasi që pjesëtarët e këtyre komuniteteve u përballën me sfida që kishin të bëjnë, mes tjerash, me qasjen në testim për COVID-19, arsim dhe masa të rimëkëmbjes ekonomike pasi që nuk ishin të regjistruar zyrtarisht në qendrat kosovare të punësimit. Përveç kësaj, komunikimi i krizës nga qeveria në gjuhët jo-shqipe u kufizua, kështu që komunitetet jo-shumicë nuk mund të kishin qasje në gjuhët amëtare me po aq shpejtësi sa shqip-folësit. Gjatë periudhës së raportimit, sipas Programit për të Drejta Civile në Kosovë (PDC-K), personat në lëvizje u ballafaquan me rrezik të shtuar të infektimit me COVID-19 për shkak të aftësisë së kufizuar për t'iu respektuar masat e distancimit fizik si dhe për shkak të qasjes së kufizuar në ushqim të mjaftueshëm, pajisje personale mbrojtëse (PPM), produkte higjienike dhe barna esenciale për sëmundjet kronike.¹⁷

14 [Fjalimi presidencial](#) (2021).

15 [Zyra e Kryeministrit](#) (2021).

16 [CEL](#) (2021).

17 Programi për të Drejta Civile në Kosovë (2021), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2021.

23. Sipas monitorimit të OSHC-ve dhe organizatave ndërkombëtare, SHKK në përgjithësi e ka menaxhuar mirë situatën në institucionet korrektuese dhe në burgje për t’i mbrojtur personat në mbajtje dhe të burgosurit nga COVID-19. Në mesin e masave të tjera, SHKK i ka lehtësuar, rikthyer dhe pastaj i ka hequr kufizimet për vizita familjare, lejet për dalje gjatë fundjavave dhe karantinën në përputhje me situatën epidemiologjike. Raportohet se 223 anëtarë të stafit të SHKK-së dhe 46 të burgosur u infektuan me COVID-19 dhe katër të burgosur vdiqën si pasojë deri në fund të marsit 2021, ndërsa mbipopullimi në burgjet e Kosovës nuk është problem për shkak të një rënjeje prej 20 përqind në numrin e të burgosurve nga 12 marsi deri më 31 dhjetor 2020. Në janar, SHKK vendosi t’i lejojë përsëri daljet gjatë fundjavave për të burgosurit që i plotësojnë disa kushte të caktuar që iu nën masat parandaluese të COVID-19, si vendosja në karantinë e të burgosurve që kthehen për së paku shtatë ditë. Në gusht, SHKK vendosi masa të reja kundër COVID-19 për qendrat korrektuese për ta mbrojtur shëndetin e të burgosurve, personave në mbajtje dhe të stafit korrektues që ishin në fuqi nga 31 gushti deri më 15 shtator.¹⁸ Si pjesë e këtyre masave, u ndaluan përkohësisht vizitat familjare; u ndaluan daljet gjatë fundjavave, puna jashtë institucioneve korrektuese dhe vizitat në objekte të veçanta; dhe transferet e të burgosurve u kufizuan vetëm për “raste të nevojshme”. Të burgosurve iu lejua ta përdornin Skype për t’i mbajtur kontaktet familjare dhe u rrit numri i telefonatave të lejuara. Të paraburgosurit mund t’i kontaktonin avokatët e tyre mbrojtës për raste që ishin në zhvillim, ndërsa vizitat u lejuan me test negativ PCR ose antigjen nga AIP, që vepron si mekanizëm parandalues ndaj torturës dhe keqtrajtimit dhe organizatat e monitorimit të të drejtave të njeriut që kanë memorandum mirëkuptimi me Ministrinë e Drejtësisë dhe SHKK-në. Masat u lehtësuan përsëri në shtator kur u lejuan vizitat familjare me një familjar të afërm nga 28 shtatori nëse familjari i posedonte njërën prej dëshmimeve të lartpërmendura për COVID-19.¹⁹ SHKK vendosi ta lejonte vazhdimin e daljeve gjatë fundjavave për të burgosurit nga 5 tetori dhe i lehtësoi kufizimet për vizitat familjare për të burgosurit duke i lejuar, nga 28 tetori, dy të rritur dhe dy fëmijë që ta vizitojnë një të burgosur nën masat mbrojtëse kundër COVID-19, si distanca fizike dhe paraqitja e dëshmimeve për COVID-19.

5. PJESA A: TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE

5.1 E drejta për jetën

24. E drejta për jetën është e drejtë themelore e mishëruar me Kushtetutë, e përcaktuar në nenin 25 të Kushtetutës. Në përputhje me nenin 2 të KEDNj-së, e cila është përfshirë në Kushtetutë, e drejta për jetën mbrohet me çdo kusht dhe proces ligjor. Sipas Protokollit 13 të KEDNj-së që zbatohet drejtpërdrejt, dënimi me vdekje është i ndaluar në Kosovë.²⁰

25. IPK është përgjegjës për hetimin e pretendimeve lidhur me vrasjet e paligjshme dhe arbitrare nga agjentët qeveritarë ndërsa Prokurori i Shtetit është përgjegjës për ndjekjen penale të rasteve.²¹ Në vitin 2021, nuk pati raportime që QK apo agjentët e saj kryen vrasje arbitrare dhe/ose joligjore.

18 [Shërbimi Korrektues i Kosovës](#) (2021).

19 *ibid* (2021).

20 [Shih KEDNj-në.](#)

21 Shih: Raporti i të Drejtave të Njeriut në Kosovë për vitin 2020, Departamenti i Shtetit të SHBA-ve, Zyra e Demokracisë, të Drejtave të Njeriut dhe e Punës, i disponueshëm në: <https://www.state.gov/reports/2020-country-reports-on-human-rights-practices/kosovo/>

26. Shkëputjet mes mekanizmave ligjorë dhe zbatimit të tyre në praktikë u vërejtën në numrin e vrasjes së grave që kanë të bëjnë me dhunën në familje. Mungesa e mekanizmave dhe veprimeve mbrojtëse në ankesat e raportuara të abuzimit mund të ketë kontribuar tërthorazi në fatalitetet në rastet e abuzimit në familje. Sipas PK-së, tri gra u vranë në vitin 2021 në kontekstin e dhunës në familje dhe dhunës me baza gjinore.²² Raporte të besueshme tregojnë që nga viti 2017 deri në vitin 2020, janë vranë të paktën 74 gra.²³ Sipas të drejtës ndërkombëtare dhe vendore, njohuritë paraprake të ekspozimit të grave ndaj dhunës në familje vetëvetiu kërkojnë ndërmarrjen e veprimeve nga agjencitë dhe institucionet përkatëse.

27. Rastet përkatëse të vrasjes së Sebahate Morinës dhe Marigona Osmanit nga abuzuesit meshkuj familjarë nxori në pah mungesën e masave mbrojtëse të ndërmarra nga PK dhe agjencitë e tjera institucionale. Edhe pse viktimat dhe familjet e tyre përkatëse kishin paraqitur ankesa dhe e kishin njoftuar PK-në, institucionet përkatëse kishin dështuar në zbatimin e mekanizmave ligjorë të themeluar për mbrojtjen e viktimave të abuzimit në familje. Në rastin e Sebahate Morinës, e bija e kishte lajmëruar policinë për rrezikun që nëna ndaj jetës së nënës së saj. Kjo ndodhi njëmbëdhjetë ditë para vrasjes së viktimës nga bashkëshorti i saj, por PK-ja nuk ndërmori asnjë veprim. Në prill të vitit 2021, AIP e paraqiti një ankesë në emër të Sebahate Morinës në bazë të neglizhencës dhe joprofesionalizmit. Rasti aktualisht është në pritje në Gjykatën Kushtetuese. Njësoj, në rastin e Marigona Osmit, abuzuesi ishte në procese gjyqësore për raste të tjera, pasi që institucionet kosovare nuk arritën të ndërmarrin veprime të duhura ligjore.

28. Vdekja e një personi si rezultat i përdorimit të forcës nga autoritetet policore dhe agjencitë e tjera institucionale kërkon hetim të pavarur dhe efektiv, siç e përcakton neni 2 i KEDNj-së. Hetimi duhet të zhvillohet sipas pesë parimeve dalluese të pavarësisë, efektivitetit, shpejtësisë, transparencës publike dhe përfshirjes së familjes. KEDNj thotë që "qëllimi kryesor i një hetimi të tillë është të sigurohet zbatimi efektiv i ligjeve vendore që e mbrojnë të drejtën për jetë dhe, në raste të përfshirjes së agjentëve ose organeve shtetërore, të sigurohet llogaridhënie për vdekjet që kanë ndodhur nën përgjegjësinë e tyre".

29. Mbrojtja e të drejtës për jetën vlen edhe për vendet e ndalimit duke përfshirë burgjet, stacionet policore dhe vendet e izolimit, pasi që personat në mbajtje janë nën mbikëqyrje të plotë të institucioneve shtetërore. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut thekson qartë që autoritetet e kanë për detyrë t'i mbrojnë të burgosurit (Oselav kundër Turqisë). Në rast të vdekjes së të burgosurve ose personave në mbajtje, Prokurori i Shtetit e ka për obligim të bëjë hetim ex-officio lidhur me shkakun e vdekjes. Ashtu si në vitet e kaluara, nuk pati raportime të tilla të hetimeve që i shpallën autoritetet e burgjeve përgjegjëse për vdekjet në burg.

30. Rekomandime:

- Është e nevojshme të shtohen kompetencat e autoriteteve të zbatimit të ligjit për t'i respektuar të drejtat e njeriut në vendet e privimit të lirisë ku e drejta për jetën është më së shumti e cenuar;

²² RRGK (2021), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2021.

²³ [Kallxo](#) (2021).

- Në rast të vdekjes së një personi në duart e autoriteteve, organet hetuese dhe i tërë sistemi gjyqësor i përfshirë duhet të reagojë me shpejtësi, efikasitet dhe duke e respektuar parimin e publicitetit.
- Të shtohen mekanizmat parandalues dhe reagues brenda autoriteteve të zbatimit të ligjit për të reaguar ndaj rasteve të dhunës në familje ku rrezikohet/cenohet e drejta e grave për jetën.

5.2 E drejta për trajtim njerëzor dhe ndalimin e torturës

31. Kushtetuta e Kosovës e ndalon haptas çdo lloj të trajtimit jonjerëzor. Këtu përfshihet tortura, trajtimi dhe ndëshkimi mizor, çnjerëzor apo poshtëruës, sipas nenit 27. Ky përcaktim duhet të shikohet si pjesë e të drejtave universale të njeriut nën nenin 22 dhe instrumentet e tij ndërkombëtare që zbatohen drejtpërdrejt në Kosovë. Siç u cek më sipër, dispozitat ndërkombëtare kanë epërsi ndaj institucioneve publike dhe ligjeve vendore.

32. Veçanërisht në lidhje me ndalimin e torturës, trajtimit ose ndëshkimit mizor, çnjerëzor apo poshtëruës, Konventa e OKB-së kundër Torturës dhe Dënimeve ose Trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese (UNCAT) dhe KEDNj shërbejnë si instrumente ndërkombëtare që zbatohen drejtpërdrejt në Kosovë.

33. Përveç mbrojtjes kushtetuese nga keqtrajtimi dhe tortura, korniza ligjore e Kosovës e shtjellon edhe më tej të drejtën për trajtim njerëzor duke e kriminalizuar torturën dhe keqtrajtimin në ushtrimin e detyrave zyrtare nga institucionet publike. Në Kodin Penal Nr. 06/L-074, tortura dhe keqtrajtimi nga autoritetet zyrtare përcaktohen si vepra penale.

34. Legjislacioni përkatës në Kosovë përcakton që AIP vepron si Mekanizëm Kombëtar Parandalues (MKP) kundër torturës dhe trajtimit ose ndëshkimit tjetër mizor, çnjerëzor ose poshtëruës dhe është në përputhje me Protokollin Opsional të Konventës kundër Torturës dhe Formave të Tjera të Trajtimit apo Ndëshkimit Mizor, Çnjerëzor apo Poshtëruës (OP-CAT).²⁴

35. Sipas raporteve të OSHC-ve të ndryshme, Raportit të Progresit të BE-së (2021) dhe Raportit të SHBA-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë (2020), parandalimi i torturës dhe keqtrajtimit është i kënaqshëm në Kosovë dhe autoritetet e Kosovës vazhdojnë të shfaqin përkushtim për t'i parandaluar këto praktika në të gjitha rrethanat.

36. Përpjekjet për adresimin e rekomandimeve të lëshuara nga KPT në vitin 2015 janë duke vazhduar. Gjatë vitit 2020, një delegacion i KPT-së e vizitoi Kosovën për ta përgatitur një raport të ri.²⁵ Mekanizmi Kombëtar Parandalues kundër torturës dhe formave të tjera të trajtimit ose ndëshkimit tjetër mizor, çnjerëzor ose poshtëruës (MKPT), që vepron në kuadër të IAP-së, i pezulloi përkohësisht vizitat për të burgosurit, qendrat e mbajtjes, qendrat psikiatrike dhe stacionet

24 IKD (2021), kontribut për Raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë për vitin 2021.

Ibid.

[gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10922](https://www.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10922)

25 Komisioni Evropian (2021), [Raporti Vjetor i Progresit](#).

policore në mars për shkak të masave lehtësuese ndaj COVID-19. Pandemia e ka dëmtuar edhe kontaktin e të burgosurve me MKPT-në përmes avokatëve, familjarëve dhe organizatave ndërkombëtare. Për të siguruar mbrojtjen e të burgosurve, MKPT i ka krijuar katër linja telefonike që ofrojnë qasje 24 orë në zyrat e MKPT-së dhe ka përdorur kuti për ankesat me shkrim në qendrat e mbajtjes. Vetëm stafi i IAP-së ka qasje në këto telefonata dhe ankesa me shkrim. Para pezullimit të vizitave në terren, MKPT realizoi 40 vizita në stacionet policore, burgje, qendra psikiatrike, shtëpi të kujdesit social dhe në institucione që përdorshin për karantinimin. Gjatë vizitave të MKPT-së, nuk u paraqitën pretendime të torturës apo keqtrajtimit nga personat në ndalim policer. MKPT paraqiti raporte për gjetjet e tij dhe publikoi raporte përcjellëse mbi pajtueshmërinë e qeverisë.²⁶

37. Me kërkesën e YIHR KS, IAP deklaroi që gjatë vitit 2021, janë paraqitur gjithsej 98 ankesa nga personat e privuar nga liria. Prej tyre, 39 janë pranuar dhe 59 janë hedhur poshtë për arsye juridik-sioni.²⁷

38. Situata në Kosovë sa i përket të drejtës për trajtim njerëzor dhe ndalimit të torturës gjatë vitit 2021 nuk ka ndryshuar dukshëm nga viti paraprak, por janë shënuar disa zhvillime pozitive në drejtim të përmirësimit të kushteve materiale për të burgosurit. Ndryshimi më i rëndësishëm është nisma e Ministrisë së Drejtësisë për renovimin bllokun D në Qendrën Korrektuese në Dubravë, si vend i posaçëm për personat me nevoja të veçanta që janë të privuar nga liria. Me funksionimin e këtij blloku, pritet të ketë një përmirësim në kushtet e trajtimit të duhur dhe njerëzor të të burgosurve me nevoja të veçanta, sidomos të atyre me çrregullime mendore, pasi që deri më tani kjo ka qenë njëra prej sfidave më të mëdha me të cilat është ballafaquar SHKK-ja. Legjislacioni penal ka paraparë dispozita të veçanta në Kodin Penal të Kosovës (KPK) dhe në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) për vendosjen dhe trajtimin e tyre. Megjithatë, këto dispozita ligjore nuk janë zbatuar në praktikë. Përderisa neni 509, pjesa 2 e KPPK-së përcakton që autorët e veprave penale me çrregullime mendore mund të mbahen në institucione të kujdesit shëndetësor, sistemi korrektues dhe shëndetësor i Kosovës nuk ka institucione të veçanta për zbatimin e burgosjes për raste të tilla. QKRMT ka avokuar vazhdimisht për sigurimin e një vendi të veçantë për të burgosurit me çrregullime mendore, prandaj, pasi që Ministria e Drejtësisë e ka ndarë buxhetin për renovimin e bllokut D për të burgosurit me nevoja të veçanta, është e nevojshme të merren parasysh edhe hapësirat e veçanta për të burgosurit e mitur dhe femra.

39. Bazuar në raportimin e QKRMT-së mbi vizitat monitoruese në institucionet korrektuese, ka pasur pretendime nga disa të burgosur për keqtrajtim dhe përdorim të tepruar të dhunës ndaj tyre nga zyrtarët korrektues. Më tutje, janë raportuar edhe raste të dhunës (seksuale) ndaj të dënuarve.²⁸ Institucionet ku janë raportuar raste të tilla janë Burgu i Dubravës, Burgu i Sigurisë së Lartë në Gërdoc, Qendra e Paraburgimit në Prishtinë dhe Burgu i Lipjanit. Edhe pse në vitet e fundit është shënuar rënie në rastet e përdorimit të tepruar të forcës, ky fenomen është ende i pranishëm në institucionet korrektuese në Kosovë. Raportimi i incidenteve të tilla bazohet në intervistat që i kanë realizuar monitoruesit e QKRMT-së me të burgosurit.

26 Qeveria e Shteteve të Bashkuara (2020), [raport vendor mbi të drejtat e njeriut në Kosovë](#).

27 IAP (2021), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2021.

28 [Kallxo](#) (2021).

40. Njëra prej ankesave më të shpeshta që QKRMT i ka pranuar gjatë intervistave me të burgosurit ishte Paneli i Lirimit me Kusht. Sipas tyre, vendimet e këtij paneli po merren në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe raportet e vlerësimit të ofruara nga zyrtarët e institucioneve korrektuese. Tutje, ka pasur pretendime nga të burgosurit nga shumica e qendrave korrektuese të vizituara që shumë vendime të këtij paneli po merren në baza korruptive. Lidhur me këtë çështje, pritët të ketë ndryshime pozitive me miratimin e projektligjit për ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Ndëshkimeve Penale, i cili iu jep të burgosurve të drejtën për të paraqitur ankesë kundër vendimit të Panelit të Lirimit me Kusht, pasi që deri më tani nuk e kanë pasur këtë të drejtë. Kjo ka qenë një sfidë sistematike për performancën e Panelit për shumë vite dhe njëra prej shqetësimeve kryesore të KPT-së, IAP-së dhe organeve vendore monitoruese në Kosovë.

41. Poashtu, QKRMT vazhdimisht pranon ankesa për vonesa ose mungesë të përgjigjeve për kërkesat për transfer. Në disa burgje, të dënuarit duhet të kërkojnë dhe të vijnë personalisht për t'i marrë këta formularë vetë kur duan të paraqesin ankesë, ndërsa Stafit Korrektues apo Shefi i Bllokut ua jep një kopje të ankesës së plotësuar pas dorëzimit të formularit. Disa të burgosur kanë deklaruar që nuk kanë paraqitur ankesa sepse janë frikësuar se stafi korrektues do të hakmerrej ndaj tyre. QKRMT rekomandon që në disa institucione formulari i ofrimit dhe adresimit të kërkesave duhet të korrigojohet dhe që konfidencialiteti duhet të ruhet. Është shumë e rëndësishme që shqetësimet dhe ankesat e të dënuarve të shqyrtohen nga Drejtori i institucionit, sidomos kur kërkesat janë të vazhdueshme dhe ngrisin pretendime të cenimeve të rënda të të drejtave të njeriut.

42. Sipas QKRMT-së, SHKK ende nuk ka arritur të zbatojë programe të mirëfillta të rehabilitimit dhe riintegrit për të dënuarit në bazë të kërkesave dhe nevojave individuale, prandaj kjo çështje mbetet sfiduese sa i përket riintegrit të të burgosurve pas përfundimit të dënimit të tyre.

43. Gjatë vizitave monitoruese në vitin 2021, QKRMT ka identifikuar raste kur në një repart të qendrës korrektuese për të mitur, po mbaheshin të burgosur të rritur për vepra të rënda dhe dënime të gjata. Pas reagimit të QKRMT-së, në dhjetor të vitit 2021 këta të burgosur u transferuan nga kjo qendër.²⁹

44. Një situatë e paqartë u paraqit në fund të vitit 2021 me lajmin se Kosova dhe Danimarka pritej të nënshkruanin një marrëveshje për t'ia huazuar Danimarkës përdorimin e Qendrës së Paraburgimit në Gjilan për një periudhë prej së paku 5 vitesh. Numri i të burgosurve që pritej të transferoheshin ishte 300 dhe asnjë prej tyre nuk janë shtetas danezë. QKRMT e sheh këtë veprim nga Ministria e Drejtësisë me rezervime pasi që rivendosja e 200 të burgosurve në këtë qendër do të rezultonte në mbipopullim dhe përkeqësim të kushteve në burgjet tjera dhe qendrat e mbajtjes. Ministria e Drejtësisë e Kosovës dhe Ministria e Drejtësisë e Mbretërisë së Danimarkës nënshkruan letra të qëllimit për të lidhur një marrëveshje të tillë në dhjetor të vitit 2021. Janë shprehur shqetësime lidhur me cenimin apo rreziqet e mundshme që mund t'i paraqesë kjo marrëveshje për të drejtat e të burgosurve, duke përfshirë të drejtën për vizita nga familjet e tyre dhe të drejtën e respektimit të jetës së tyre private dhe familjare, shtëpisë dhe korrespondencës së tyre.³⁰

29 Të dhëna të marra nga Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës (QKRMT), 15.03.2022.

30 Shih [QKRMT](#) (2021).

45. Rekomandime:

- Ministria e Drejtësisë duhet të ofrojë trajnime për stafin korrektues për sjelljen e tyre ndaj të burgosurve dhe ta monitorojë performancën e tyre;
- Ministria e Drejtësisë, përmes ShKK-së, duhet të sigurohet që stafi korrektues në institucionet korrektuese në Kosovë është i vetëdijshëm që të gjitha format e abuzimit fizik apo keqtrajtimi janë të ndaluara me ligjet në fuqi dhe standardet ndërkombëtare dhe që veprimet e tilla ndëshkohen me ligj;
- ShKK-ja duhet të sigurohet që të gjitha format e paraqitjes së kërkesave dhe ankesave janë të disponueshme, duke përfshirë qasjen e lehtë në formularët e ankesave për të burgosurit;
- ShKK-ja duhet të sigurohet që plani individual i dënimit të çdo të burgosuri hartohet në bazë të kërkesave dhe nevojave individuale të të burgosurit;
- Përveç vendosjes së të burgosurve dhe të arrestuarve të rritur me çrregullime mendore në një bllok të veçantë në Burgun e Dubravës, rekomandohet që Ministria e Drejtësisë dhe SHKK të marrin masa për të siguruar vendosje të tillë të veçantë edhe për të burgosurit e mitur dhe femra.

5.3 E drejta për liri dhe siguri të personit

46. Kushtetuta e Kosovës, legjislacioni dhe instrumentet që zbatohen drejtpërdrejt për të drejtat e njeriut, ofrojnë një bazë të fortë për mbrojtjen e së drejtës për liri dhe siguri të një personi. Neni 29 i Kushtetutës parasheh që të gjithë individëve iu garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë dhe se askush nuk mund të privohet nga liria, përveç rasteve të parapara me ligj dhe pas vendimit të gjykatës kompetente. Dënimet për kryerjen e një krimi, paraburgimi i detyrueshëm, masat edukative për të miturit, mbikëqyrja mjekësore e një personi dhe rastet e hyrjes së paligjshme në Kosovë janë të renditura në mesin e përjashtimeve/arsyeve për të cilat liria e një personi mund të kufizohet ligjërisht. Garancitë e tilla kushtetuese janë dhënë edhe në Kodin e Procedurës Penale dhe në Kodin e Drejtësisë për të Mitur.

47. Pavarësisht përcaktimeve ligjore që e garantojnë të drejtën e lirisë, autoritetet vazhdojnë ta zbatojnë paraburgimin si masë të përkohshme për kategori të ndryshme migrantësh (p.sh. ata që nuk kërkojnë azil ose nuk konsiderohen azilkërkues). Duhet të merren parasysh masat alternative të paraburgimit të parapara me Ligjin nr. 06/L-026 për Azilin në Kosovë dhe ndalimi të përdoret vetëm si mjet i fundit.³¹

48. E drejta për lirinë dhe sigurinë e një personi, në fund të fundit, varet dhe lidhet me një gjyqësor të pavarur dhe efikas. Përkundër një kornize të mirë normative që e mbështet administrimin e

31 Komisioni Evropian (2021), [Raporti Vjetor i Progresit](#).

drejtë, të pavarur dhe të paanshëm të drejtësisë, sistemi i drejtësisë në Kosovë vazhdon të dëmtohet nga një administrim i drejtësisë që mbetet i ngadalshëm, joefikas dhe i cenueshëm ndaj ndikimeve të panevojshme politike.³²

49. Në kontekstin e të drejtës për liri dhe siguri të personit, OJQ FOL thekson rëndësinë e zbatimit të Ligjit nr. 05/L-003 për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave, lëvizja e të cilit kufizohet me Vendimin e Gjykatës të miratuar nga KK në vitin 2015.³³ Megjithatë, Ligji ende mbetet të zbatohet gjashtë vite pas hyrjes në fuqi për shkak të mungesës së nismës nga Ministritë përkatëse (Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Jashtme). Ministritë nuk kanë ndërmarrë masa për të themeluar mekanizma të zbatimit, duke përfshirë funksionimin e dhomës operative brenda PK-së apo sigurimin e byzylykëve elektronikë.

50. Mbikëqyrja elektronike mund të jetë thelbësore në mbrojtjen e viktimave të krimit në përgjithësi dhe viktimave të dhunës në familje në veçanti. Zbatimi i këtij ligji padyshim se mund të jetë një garanci që institucionet mund t'iu ofrojnë viktimave të dhunës në familje. Megjithatë, përkundër garancisë dhe sigurisë që do të mund të ofronte ky ligj, krijimi i kushteve për zbatimin e tij në praktikë nuk është adresuar në Strategjinë Kombëtare të Kosovës për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Planin e Veprimit 2016-2020, të prezantuar nga Ministria e Drejtësisë, një vit pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 05/L-003 për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave.

51. Mundësimi i kushteve për zbatimin e mbikëqyrjes elektronike është planifikuar përmes Strategjisë së re Kombëtare të Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2022-2026, e cila ishte në proces të hartimit gjatë vitit 2021. Në kuadër të objektivit “përmirësimi i ligjit” të kësaj draft strategjie, një aktivitet i veçantë parasheh ngritjen e një sistemi të monitorimit dixhital për zbatimin adekuat të urdhrave të mbrojtjes.³⁴

52. Sipas monitorimit të drejtpërdrejtë të trendeve në komunitetet joshumicë, ka pasur një rritje të shqetësimeve brenda komunitetit serb të shkaktuara nga një numër i incidenteve të sigurisë. Gjatë 6 muajve të parë të vitit 2021, OJQ-ja AKTIV dhe Grupi Qytetar i Reagimit të Shpejtë (GQRSH) kanë regjistruar 48 incidente të ndryshme në mbarë Kosovën. Rritja e numrit të incidenteve ka qenë në periudhën nga 23 marsi deri më 30 qershor, gjatë së cilës shqetësuese kanë qenë 27 incidente të ndryshme të regjistruara.³⁵ Përkundër faktit se OJQ AKTIV paraqiti kërkesa për situatën e sigurisë në mesin e komuniteteve serbe tek institucionet relevante të nivelit qendror dhe iu kërkoi atyre të reagojnë, nuk morën asnjë përgjigje zyrtare.

53. Rekomandime:

- KGJK-ja dhe Gjykata Supreme duhet t'iu bëjnë thirrje të gjitha gjykatave penale që t'i zbatojnë siç duhet dispozitat lidhur me përdorimin e paraburgimit dhe t'i shqyrtojnë alternativat në vend të paraburgimit. Ekziston një aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës i nxjerrë në vitin 2019 për përdorimin e paraburgimit dhe alternativave në të gjitha fazat e procedurës penale që duhet të shërbejë si udhërrëfyes për gjyqtarët në Kosovë;

32 Ibid.

33 Shih [Gazetën Zyrtare](#) (2015).

34 [Draft Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave \(2022-2026\)](#) (2022).

35 AKTIV (2021), [incidentet e sigurisë në periudhën nga 1 janari deri më 30 qershor, 2021](#).

- Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme duhet të ndërmarrin veprime për themelimin e mekanizmave përmbarues, duke përfshirë funksionimin e sallës operative në kuadër të Policisë së Kosovës dhe sigurimin e byzylykëve elektronikë, me qëllim të zbatimit të Ligjit për Mbikëqyrjen Elektronike.

5.4 E drejta për proces të drejtë gjyqësor dhe mjete juridike efektive

54. Kushtetuta dhe instrumentet ndërkombëtare në fuqi i mbrojnë të drejtat e qytetarëve për proces gjyqësor të drejtë dhe mjete juridike efektive. Neni 31 i Kushtetutës iu siguron të gjithë personave mbrojtje të barabartë të të drejtave në procedurat para gjykatave. Në seancat dëgjimore publike, e drejta për të marrë në pyetje dëshmitarët dhe prezumimi i pafajësisë derisa të provohet fajësia janë poashtu përbërës thelbësor të gjykimeve të drejta dhe të paanshme sipas nenit 31.

55. E drejta për mjet juridik efektiv është e përcaktuar edhe në një sërë dispozitash në kuadër të Kushtetutës. Në nivel të përgjithshëm, neni 32 i Kushtetutës iu garanton të gjithë individëve të drejtën për të ndjekur mjete juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat i cenojnë të drejtat apo interesat e tyre, në mënyrën e paraparë me ligj. Përveç kësaj, çdo individ i privuar nga liria përmes arrestit apo ndalimit e gëzon të drejtën për të përdorur mjete juridike për ta sfiduar ligjshmërinë e arrestimit apo të ndalimit sipas nenit 29(4) të Kushtetutës. Ky nen përcakton që gjykata do të vendosë për rastin brenda një afati sa më të shkurtër kohor dhe do të urdhërohet lirimi nëse arresti apo ndalimi vërtetohet të jetë jo i ligjshëm. Tutje, e drejta për mjete juridike ofrohet edhe me klauzolën për mbrojtjen e përgjithshme gjyqësore të të drejtave në nenin 54 i cili parasheh që të gjithë personat kanë të drejtë të mbrojtjes gjyqësore nëse është cenuar apo mohuar ndonjë e drejtë e garantuar me këtë Kushtetutë apo me ligj. Poashtu, të gjithë personat kanë të drejtë për mjete juridike efektive nëse konstatohet se janë cenuar këto të drejta. Në fund, në nivel kushtetues, neni 113 (7) dhe (8) e lejon ngritjen e rasteve individuale dhe incidentale para Gjykatës Kushtetuese.

56. E drejta për proces të drejtë gjyqësor dhe mjete juridike efektive është në përputhje me standardet ndërkombëtare që janë të zbatueshme në rendin ligjor të Kosovës përmes nenit 22 të Kushtetutës. Më i përdoruri prej tyre është neni 6 i KEDNJ-së i cili përdoret shpesh nga gjykatat e instancave të larta (sidomos Gjykata Kushtetuese) për kthimin në rigjykim ose anulimin e rezultateve të procedurave gjyqësore nga gjykatat e instancave më të ulëta.

57. Në nivel legjislativ, e drejta për proces të drejtë gjyqësor dhe mjete juridike efektive është e rregulluar me ligje të ndryshme procedurale. Dispozitat e tilla gjenden në ligje specifike që e rregullojnë çdo lloj të procedurës (p.sh. Kodi Nr. 06/L-074 i Procedurës Penale, Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative etj.).

58. Sipas IKD-së, cenimi i të drejtës për proces gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm kohor manifestohet në disa forma. Cenimet më të shpeshta kanë të bëjnë me vonesat në procedurën e gjykatave deri në epilogun e fundit dhe për shkak të vonesave në ekzekutimin e vendimit të

formës së prerë pas rasteve gjyqësore. Ashtu si në vitet e kaluara, gjatë periudhës së raportimit, përpunimi efikas i rasteve u pengua nga numri i madh i lëndëve në sistemin gjyqësor dhe në kohëzgjatjen e tyre.

59. Poashtu, sipas IKD-së, 224,801 raste mbetën në pritje gjatë dhjetorit të vitit 2021. Përveç kësaj, efikasiteti i gjyqësorit në zgjidhjen e rasteve që janë në proces e sipër ka shënuar një trend negativ. Kjo është shkaktuar nga fakti se në vitin 2018, rreth 42.33 përqind e rasteve janë zgjidhur, ndërsa në vitin 2019 kjo shkallë ra në 39.81 përqind, pastaj në 29.10 përqind në vitin 2020 dhe vetëm 20.18 përqind gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2021.

60. Pas emërimit të 24 gjykatësve në janar dhe në mars të vitit 2021, Kosova tani i ka 400 gjykatës (132 gra dhe 268 burra) dhe 187 prokurorë (79 gra dhe 108 burra), që nënkupton rreth 21 gjykatës dhe 10 prokurorë në 100,000 banorë. Sipas Komisionit Evropian të Këshillit të Evropës për Efikasitet në Drejtësi (KEED), mesatarja evropiane është 21 gjykatës dhe 12 prokurorë në 100,000 banorë. Fatkeqësisht, sipas organizatave të pavarura monitoruese në vend kjo nuk është reflektuar në efikasitet të shtuar në trajtimin e rasteve që janë në vazhdim, pasi që numri i rasteve në pritje mbetet i lartë. Një çështje tjetër shumë e rëndësishme është që Kosova ende e ka një përqindje të ulët të gjykatëseve dhe prokurorëve në krahasim me shumicën e shteteve të tjera evropiane.³⁶

61. Më tutje, bazuar në analizat e IKD-së, problemi i shtyerjes së seancave në gjykata si faktor që ndikon në kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore ende vazhdon. Gjatë periudhës nga janari deri në nëntor 2021, në Divizionin Penal u shtynë 810 seanca ose 37.90 përqind e numrit total të seancave të rasteve. Në Divizionin Civil, shkalla totale e shtyerjes ishte 22.25 përqind. Sipas organizatës së njëjtë, Departamenti i Krimeve të Rënda i ka shtyrë 26.24 përqind të seancave gjatë periudhës së raportimit.³⁷

62. Sa i përket kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore, nga 250 aktgjykimet/rastet e analizuara në instancën e parë, IKD konstatoi që kohëzgjatja e zgjidhjes së rasteve ka qenë shqetësuese. Në ato raste, kanë kaluar mesatarisht 2,309 ditë mes ngritjes së aktakuzës dhe lëshimit të vendimit nga Divizioni Penal i Departamentit të Përgjithshëm në rastin e instancës së parë. Në Departamentin e Krimeve të Rënda, kjo periudhë ishte mesatarisht 2,158 ditë, ndërsa në rastet civile, gjykatat vonuan 1,755 ditë për lëshimin e një vendimi të instancës së parë pas paraqitjes së padive.³⁸

63. Probleme të ngjashme u raportuan në një raport të Grupit për Studime Ligjore dhe Politike (GPLS) në vitin 2021. Bazuar në raportet nga "Drejtësia Sot" të cilat përmabjnë të dhëna nga periudha prill-shtator 2021, shkelje ligjore u gjetën nga gjykatat lidhur me afatet procedurale për caktimin dhe mbajtjen e seancave gjyqësore në rastet e korrupsionit.³⁹ Këto shkelje janë gjetur në pothuajse të gjitha gjykatat anëmbanë Kosovës, një situatë e cila e dëmton të drejtën për proces të drejtë gjyqësor. Shkelja e parë ka të bëjë me mosrespektimin e afatit procedural për caktimin e seancës së parë, ndërsa shkelja e dytë është mosrespektimi i afatit procedural për caktimin dhe mbajtjen e gjykimit kryesor – afatet janë të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës Nr. 04/L-123 (KPPK). Sipas këtij raporti, afati për mbajtjen e seancës së parë nga gjykata nuk është

36 Komisioni Evropian (2021), [Raporti Vjetor i Progresit](#).

37 IKD (2021), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-së për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2021.

38 Ibid.

39 [Drejtësia Sot](#) (2021).

respektuar në 9 raste, ndërsa afati për mbajtjen e gjykimit kryesor nuk është respektuar në 3 raste, duke shkaktuar vonesa në progresin e procedurave gjyqësore. Në këtë kontekst, vonimi i tillë i seancave gjyqësore përbën cenim të të drejtave themelore të njeriut të garantuara me instrumentet ndërkombëtare si e drejta për proces të drejtë gjyqësor e përcaktuar në nenin 6 të KEDNJ-së.

64. Poashtu, gjatë periudhës së raportimit, GLPS shënoi një rast në të cilin në të cilin inçizimi gjatë procedurave gjyqësore nuk u lejua ose u kufizua përmes një vendimi të paarsyetuar përkundër faktit se standardet ndërkombëtare dhe praktikat e mira e diktojnë nevojën për vendim të arsytuar.

65. Zhvillime pozitive janë evidentuar qartë në publikimin e aktgjykimeve nga gjykatat, gjë që ka kontribuar dukshëm në transparencën e sistemit gjyqësor. Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme i kanë publikuar gjithnjë e më shumë aktgjykimet e tyre. Në kohën e përpilimit të këtij raporti, gjykatat i kanë publikuar mbi 63,000 aktgjykimeve.⁴⁰ Aktgjykimet publikohen në uebfaqen e secilës gjykatë si dhe në uebfaqen e KGJK-së. KGJK poashtu e ka publikuar një numër të shtuar të vendimeve disiplinore, një trend i vitit 2020 dhe 2021.⁴¹

66. Ngarkesa e madhe e lëndëve dhe numri i lëndëve të pazgjidhura, që janë shkaktuar nga menaxhimi joefikas i rasteve, burimet dhe kapacitetet e pamjaftueshme njerëzore dhe progresi i ngadaltë në zgjidhjen e rasteve ndër vite, vazhdon ta pengojë administrimin efikas të drejtësisë dhe procesin e duhur. Ritmi i zgjidhjes së rasteve mbetet i ngadaltë, duke kontribuar në një klimë të pasigurisë ligjore për shumë njerëz në Kosovë. Përveç rasteve të reja, mijëra raste të pazgjidhura janë transferuar çdo vit. Tabela në vijim e pasqyron situatën me lëndët e grumbulluara në vitin 2021.⁴²

40 Shih [Aktgjykimet](#) e të gjitha gjykatave (2021).

41 Shih [Statistikat dhe vendimet disiplinore](#) (2021).

42 Të dhëna zyrtare nga [KGJK](#) (2021).

Tabela 1: Shkalla e zgjidhjes së rasteve për çdo lloj procedure⁴³

Lloji i rastit	Rastet aktive	Rastet e pazgjidhura	Përqindja
Penal	32,959	14,399	11.87
Krime të rënda	4,129	2,159	1.78
Të mitur	1,429	552	0.46
Civil	74,899	25,764	21.25
Komercial	1,731	239	0.2
Administrativ	6,045	1,829	1.51
Departamenti Special	64	21	0.02
Rastet e zgjedhura	121,256	76,293	62.92

67. Këto vonesa në procedurat gjyqësore, të kombinuara me një preferencë për ndalim në vend të alternativave të ndalimit siç parashihet me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, kanë çuar përsëri në raste të ndalimit tejet të gjatë.⁴⁴

68. Në fund të vitit 2021, QK prezantoi një ide të prezantimit të një ligji i cili do t'iu jepte qytetarëve mundësi për realizimin e të drejtave civile, duke përfshirë të drejtën për proces të drejtë gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm kohor. Nëse hartohet dhe zbatohet siç duhet, ligji mund të ketë ndikim pozitiv në promovimin e proceseve gjyqësore të drejta dhe të paanshme në një afat kohor të arsyeshëm, duke përcaktuar mjete juridike kur cenohen këto të drejta. Hapat e ardhshëm për këtë nismë pritet të konkretizohen gjatë vitit 2022.

69. Rekomandime

- KGJK-ja duhet të punojë për ta rritur efikasitetin e gjykatësve në trajtimin e rasteve dhe uljen e numri të rasteve të pazgjidhura i cili mbetet i lartë;
- KGJK-ja duhet ta mbikëqyrë dhe të sigurojë respektimin e caktimit e afateve procedurale të seancave të para dhe afateve procedurale për caktimin dhe mbajtjen e gjykimit kryesor në procedurat gjyqësore siç është e përcaktuar me Kodin e Procedurës Penale.

⁴³ Ibid.

⁴⁴ Komisioni Evropian (2021), [Raporti Vjetor i Progresit](#).

5.5 Liria e shprehjes dhe e mendimit, e drejta për informim dhe e drejta për privatësi

70. Liria e shprehjes është e garantuar me nenin 40 të Kushtetutës e cila e përkufizon lirinë e tillë duke e përfshirë të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush. E drejta për informim është e paraparë me nenin 41, i cili i garanton çdo personi të drejtën për qasje në dokumente publike. E drejta për privatësi mbrohet me nenin 36 të Kushtetutës, e cila i garanton çdo personi të drejtën që t'i respektohet jeta private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës dhe fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe e formave të tjera të komunikimit.

71. Në nivel legjislativ, dispozitat mbrojtëse të Kushtetutës në lidhje me lirinë e shprehjes, e drejta për informim dhe mbrojtje të të dhënave personale janë garantuar në një sërë ligjesh, duke përfshirë Ligjin Nr. 04/L-046 për Radio Televizionin e Kosovës, Ligjin Civil Nr. 02/L-65 kundër Shpifjes dhe Fyerjes, Ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Ligji Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, Ligji Nr. 04/L-137 për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë dhe Ligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në vitin 2018, Ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve e zëvendësoi Ligjin paraprak nr. 04/L-043 për Mbrojtjen e Informatorëve të vitit 2011, ndërsa Ligji Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumentet Publike u ndryshua në vitin 2019.

72. Kosova përfiton nga një mjedis i gjallë dhe pluralist mediatik dhe korniza e saj ligjore është kryesisht në përputhje me standardet evropiane.⁴⁵ Indeksi i fundit i Sigurisë së Gazetarëve në Ballkanin Perëndimor tregoi që korniza ligjore në Kosovë është e mjaftueshme, megjithatë Kosovës i mungon zbatimi i ligjeve relevante.⁴⁶ Sipas raportit të lartpërmendur, Ligji Nr. 02/L-65 kundër Shpifjes dhe Fyerjes e përkufizon përgjegjësinë civile ndaj personave apo gazetarëve kur ka padi për shpifje apo fyerja. Kornia ligjore në Kosovë i ka dekriminalizuar fyerjet. Prandaj, gazetarët nuk mund t'iu nënshtrohen hetimeve penale për artikujt, raportet apo opinionet e tyre. Ligji civil nr. 02/L-65 kundër Shpifjes dhe Fyerjes është hartuar për t'u zbatuar dhe interpretuar në përputhje me praktikën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut si garanci për promovimin e lirisë së shprehjes dhe mendimit. Megjithatë, mungesa e njohurive dhe ekspertizës nga ana e gjykatësve për zbatimin e praktikave të KEDNJ-së është pengesë për promovimin e të drejtave të gazetarëve dhe mediave në Kosovë.⁴⁷

73. Në vitet e fundit është vërejtur një rritje e numrit të Padive Strategjike kundër Pjesëmarrjes Publike (PSP). Gjatë vitit 2021, pas një beteje prej 11 vitesh, Gjykata e Apelit vendosi në favor të YIHR KS dhe kundër padisë së Klan Kosovës të ngritur në vitin 2010 pasi YIHR KS e kishte publikuar një raport ku thuhej se, bazuar në monitorim të gjerë, ekzistonte një lidhje e qartë mes këtij agjencioni mediatik dhe një partie të caktuar politike.⁴⁸ Radio Televizioni publik i Kosovës e paditi z. Agron Demi, aktivist i shoqërisë civile, në vitin 2021 për "dëmtim të imazhit publik" të këtij instituti

45 Ibid.

46 Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve në Ballkanin Perëndimor, [Raport narrativ për Kosovën 2020](#).

47 Ibid.

48 [Nisma e të Rinjve për të Drejta të Njeriut, Kosovë](#), (2021).

cioni, pasi që z. Demi e publikoi një postim në Facebook.⁴⁹

74. Sa i përket lirisë së medias, legjislati i mbron burimet anonime të gazetarisë dhe profesionistët e tjerë të medias. Gazetarët dhe profesionistët e tjerë të medias janë të obliguar ta zbulojnë identitetin e burimit të informacionit vetëm me kërkesën e gjykatës kompetente dhe vetëm në rastet kur zbulimi i burimit është i domosdoshëm për parandalimin e një kërcënimi të rëndë ndaj integritetit fizik që rezulton në vdekjen e një apo më shumë personave. Në Kosovë, është në fuqi Ligji Nr. 04/L-137 për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë, me të cilin parashihen standarde dhe siguri për gazetarët, duke e kufizuar obligimin e tyre për zbulimin e burimeve anonime vetëm me vendim të gjykatës. Ky ligj e ka kufizuar të drejtën e Policisë, Prokurorisë apo institucioneve të tjera të zbatimit të ligjit në Kosovë që të kërkojnë zbulimin e burimeve anonime të gazetarëve pa vendim të lëshuar nga gjykata kompetente. Gazetarët nuk e kanë për detyrë t’iu përgjigjen ftesave të Policisë apo të Prokurorisë për të folur për burimet e informacionit.⁵⁰ Një rast pozitiv i zbatimit të garancive të tilla kushtetuese dhe ligjore ishte zbulimi i skemës së gjerë të punësimit pa merita të bazuar në lidhje politike nga Insajderi (një portal i gazetarisë hulumtuese) që çoi në ngritjen e aktakuzës ndaj një sërë figurash kryesore brenda partisë së PDK-së, i njohur edhe si “Rasti Pronto”.⁵¹

75. Sa i përket mbrojtjes së privatësisë, Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është i harmonizuar me Rregulloren për Mbrojtjen e të Dhënave të Përgjithshme (Rregullorja (BE) (GDPR)).⁵² Që nga hyrja e këtij ligji në fuqi, dispozitat e tij ende mbetet të testohen në praktikë. Pas shumë vonesave dhe dështimeve për të arritur konsensus politik për kandidatët, deputetët e KK-së, më 17 qershor, arritën ta zgjedhin Komisionerin e parë për Informim dhe Privatësi, i cili është përgjegjës për Agjencinë për Informim dhe Privatësi⁵³ (AIP) dhe është përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë së individëve. I tërë procesi është monitoruar nga shoqëria civile dhe përzgjedhja e komisionierit është mirëpritur nga të gjitha institucionet dhe akterët relevantë.⁵⁴ Gjatë vitit 2021, një agjenci e respektuar e lajmeve raportoi për dyshime të keqpërdorimit të të dhënave personale të fëmijëve në Kosovë nga një OJQ ndërkombëtare.⁵⁵

76. Sa i përket privatësisë së të dhënave, gjatë vitit 2021, AIP lëshoi një var “këshillash” lidhur me shqetësimet e ngritura nga institucionet publike dhe individët.⁵⁶ Nuk është e qartë nëse këto dokumente janë dokumente obligative dhe në të gjashtë opinionet këshilluese të publikuara nga AIP, nuk ka pasur shkelje të ligjit dhe nuk është gjetur asnjë cenim i informatave personale.⁵⁷ AIP e publikon në uebfaqen e tij statusin e ankesave për cenim të mundshëm të informatave personale. Asnjë inspektim nuk është kryer nga inspektorët e AIP-së për ankesat lidhur me mbrojtjen e të dhënave apo privatësisë të paraqitura nga qytetarët, për shkak të mungesës së kapaciteteve.⁵⁸

49 [Kallxo](#) (2021).

50 Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve në Ballkanin Perëndimor, [Raport narrativ për Kosovën 2020](#).

51 [Insajder](#) (2021).

52 [Rregullorja për Mbrojtjen e të Dhënave të Përgjithshme \(Rregullorja \(BE\) 2016/679\)](#)

53 [KK](#) (2021)

54 [Letra e Shoqërisë Civile Kosovare](#) (2021).

55 [Kallxo](#) (2021).

56 Shih [Agjencioni për Informim dhe Privatësi](#) (2021).

57 Pogledajte [Agenciju za informacije i privatnost](#) (2021).

58 Shih AIP (2021), [Raport për Mediat](#).

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës përfundoi që shumë portale të lajmeve kanë publikuar artikuj në portale që i cenojnë informatat personale dhe privatësinë, që është shkelje e Kapitullit VII të Kodit të tyre.⁵⁹ Numri i rasteve në të cilat Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës ka miratuar ankesa dhe ka gjetur cenime të privatësisë është rritur.⁶⁰

77. Në praktikë, OSHC-të raportuan një trend të vazhdueshëm pozitiv të respektimit të lirisë së shprehjes këtë vit.⁶¹ Ngjashëm me periudhën paraprake të raportimit, OSHC-të nuk raportuan probleme apo vështirësi në ushtrimin e kësaj të drejte. Megjithatë, gjatë periudhës së raportimit, disa OSHC vërejtën një përpjekje për ta kufizuar lirinë e shprehjes. Gjatë procesit të përzgjedhjes së Bordit për Ankesa në Komisionin e Pavarur të Mediave, OSHC-ve që po e monitoronin këtë proces iu kërkua ta nënshkruanin një deklaratë të konfidencialitetit që ua ndalonte publikimin e çfarëdo informacioni lidhur me procesin, derisa të përfundonte përzgjedhja. Një grup i OSHC-ve dhe aktivistëve e lëshuan një deklaratë të përbashkët duke theksuar që një veprim i tillë përbën përpjekje për t'i heshtur OSHC-të dhe për ta kufizuar lirinë e shprehjes. Një portal vendor e publikoi një audio inçizim ku figura të shquara të mediave, gjyqësorit dhe Agjencisë Kosovare të Inteligjencës pretendohet se ishin dëgjuar duke bërë plane për t'i kapur mediat dhe për të publikuar artikuj me të cilët targetoheshin figura të ndryshme publike në Kosovë.⁶²

78. Përveç kësaj, gjatë vitit 2021 u raportuan raste të kërcënimeve dhe gjuhës shpifëse si dhe sulme fizike ndaj gazetarëve. Në dhjetëra raste, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) e dënoi gjuhën shpifëse të përdorur ndaj gazetarëve dhe mediave të tyre elektronike. Një shembull i tillë është rasti i Këshilltarit të Presidentes së Kosovës, Blerim Vela. Vela i etiketoi portalet si “media të ish-regjimit Pronto”. AGK deklaroi që kjo është “gjuhë që shërben për të shpërndarë urrejtje dhe nxit sulme ndaj gazetarëve dhe mediave në Kosovë” dhe e ftoi Presidenten, Vjosa Osmani, të sigurojë që gjuha shpifëse nuk do të përsëritej më nga zyra e saj në të ardhmen.⁶³ AGK-ja i dënoi kërcënimet dhe fyerjet ndaj gazetarëve të uebfaqes së lajmeve “Gazeta Sinjali” nga familjarët e pesë burrave të cilët u arrestuan nga Policia e Kosovës mbi dyshimin se kishin planifikuar sulme terroriste në Kosovë. AGK-ja iu bëri thirrje autoriteteve kompetente “që t'i mbrojnë gazetarët dhe këtë medium elektronik në mënyrë që të parandalohet çdo incident i mundshëm”.⁶⁴ Ngjashëm me vitin e kaluar, institucionet përgjegjëse nuk po bëjnë sa duhet për zgjidhjen e rasteve të sulmeve ndaj gazetarëve. Hetimet vonohen dhe/ose ndikohen nga palë të treta, gjë që rezulton në një shkallë të ulët të rasteve të zgjidhura dhe dhënje të dënimeve të shkurta.

79. Një zhvillim tjetër i rëndësishëm ishin sulmet ndaj gazetarëve nga protestuesit serbë të Kosovës në komunat veriore të Kosovës derisa po raportnin drejtpërdrejt për një aksion të Policisë së Kosovës kundër kontrabandës dhe krimit të organizuar. Sulmet ndaj gazetarëve u dënuan nga Sekretari i Përgjithshëm i Federatës Evropiane të Gazetarëve, Ricardo Gutierrez, dhe AGK-ja.⁶⁵

59 Duke përcaktuar se “mediat e shkruara duhet t'i shmangin ndërhyrjet dhe hetimet në jetën private të një individi, përveç rasteve kur ndërhyrjet ose hetimet e tilla janë të nevojshme për shkak të interesit publik. Trajtimi i historive që përfshijnë tragjedi personale do të trajtohet me ndjeshmëri dhe individëve të prekur do t'iu qasen me ndjeshmëri dhe maturi.”

60 Shih [Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës](#) (2021).

61 FKSHC (2021), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë për vitin 2021.

62 Ardita Zeqiri për [Kallxo](#) (2021).

63 [Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës](#) (2021).

64 Ibid.

64 Shih [Koha](#) (2021) dhe [Kallxo](#) (2021).

80. Sipas raportit të Freedom House për vitin 2021, Kosova ka shënuar rënie në renditje për dy pikë, nga vendi i 56-të në vendin e 54-të, duke e karakterizuar vendin si “pjesërisht të lirë”.⁶⁶ Kosova shënoi rënie për tetë pozita edhe në një raport të vitit 2021 nga Raporterët Pa Kufi, duke rënë nga vendi i 70-të në vitin 2020 në vendin e 78-të në vitin 2021.⁶⁷

81. Gjatë pandemisë përgjatë viteve 2020 dhe 2021, u raportua se për shkak të zbatimit jo të duhur të të drejtave gjuhësore, raportohet se është shkelur e drejta për informim. Në disa raste, për shkak të mungesës së përkthimit në serbisht, pjesëtarët e komuniteteve joshumicë patën qasje të kufizuar në informata për situatën epidemiologjike dhe për masat e ndërmarra nga institucionet për ta luftuar epideminë dhe për t’i tejkaluar pasojat e saj ekonomike. Rrjedhimisht, kjo mund ta ketë rritur rrezikun e përhapjes së virusit, por edhe rrezikun që banorët e Kosovës që nuk flasin shqip të ndëshkoheshin për shkelje të masave ose t’iu mohohet ndihma ekonomike. Gazetarë të shumtë dhe organizata të shoqërisë civile gjatë pandemisë e kanë kritikuar vazhdimisht mungesën e informatave në gjuhën serbe. Ankesat iu kanë drejtuar drejtpërdrejt institucioneve që e kanë shkelur Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve ose Zyrës së Komisionerit për Gjuhë.⁶⁸ Komisioneri i Gjuhëve e konfirmoi që e kishte marrë vetëm një ankesë të kësaj natyre në vitin 2021, duke nënvizuar që gjatë vitit 2020 ishte paraqitur një numër më i madh i ankesave 2020.

82. Gjatë vitit 2021, Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN) i paraqiti gjithsej 172 kërkesa për qasje në dokumente publike, prej të cilave 122 u aprovuan, 4 u refuzuan dhe 45 mbetën pa përgjigje.⁶⁹ BIRN-i ka raportuar për shtatë padi aktive kundër organizatës mbi pretendime të shpifjes dhe/ose fyerjes, që zakonisht dhe me shumë gjasë pasuan publikimin e emisioneve hetimore që kishin për qëllimin ekspozimin e keqmenaxhimit në sektorë dhe institucione të ndryshme.

83.Rekomandime

- Degët relevante të qeverisë, duke përfshirë legjislativin, ekzekutivin dhe gjyqësorin, duhet t’i mbrojnë garantitë kushtetuese dhe ligjore për lirinë e shprehjes, informimit dhe privatësisë;
- Gjyqësori duhet të ofrojë trajnime më specifike mbi jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut lidhur me lirinë e shprehjes, informimit dhe privatësisë;
- Rekomandohet një mekanizëm më i qëndrueshëm për t’iu ndihmuar mediave, OSHC-ve dhe sinjalizuesve me paditë SLAPP;
- Institucionet publike duhet t’i shkurajojnë punonjësit e tyre nga përfshirja në diskutime jo të shëndosha rreth gazetarëve, mediave dhe anëtarëve të OSHC-ve;
- QK dhe gjyqësori duhet të vazhdojnë së praktikuari trajtimin efektiv dhe të shpejtë institucional dhe ligjor të rasteve të kërcënimeve ndaj anëtarëve të mediave dhe OSHC-ve;

66 [Raporti i Freedom House për vitin 2021](#) (2022).

67 [Raporterët pa Kufi](#) (2021).

68 [AKTIV](#) (2021).

69 BIRN (2022), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2021.

- PK duhet të krijojë masa adekuate dhe të zbatojë masa të tilla që janë të domosdoshme për ta garantuar sigurinë e gazetarëve në rastet e protestave;
- Të gjithë akterët duhet të sigurohen që çdo përpunim i të dhënave që kanë të bëjnë me shëndetin janë të sigurta dhe ruhen në mënyrë konfidenciale në përputhje me kornizën ligjore në fuqi në Kosovë;
- Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës duhet të zbatojë masa më drastike për të siguruar që portalet e lajmeve nuk e shkelin Kapitullin VII të Kodit të Këshillit;
- Komisioneri për Informim dhe Privatësi duhet të jetë më aktiv dhe më i angazhuar publikisht në çështje me interes për publikun.

5.6 Liria e tubimit paqësor

84. Sloboda mirnog okupljanja zagantovana je Ustavom u članu 43. On svakom licu daje pravo da organizuje skupove, proteste i demonstracije, kao i pravo da učestvuje na njima. Takva prava mogu biti ograničena zakonom ako je neophodno da se zaštiti javni red, javno zdravlje, nacionalna bezbednost ili zaštita prava drugih.⁷⁰

85. Raporte të besueshme ndërkombëtare theksojnë që e drejta për liri të tubimit paqësor në përgjithësi respektohet.⁷¹ Gjatë periudhës së raportimit, demonstratat ishin të kufizuara në numër dhe madhësi për shkak të masave të shëndetit publik në lidhje me pandeminë. Në shumicën e rasteve, masat kundër COVID-19 u respektuan, me përjashtim të dukshëm të organizimeve të fushatave elektorale të partive politike para zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Nuk u raportua asnjë incident i madh i sigurisë në lidhje me tubimet publike.⁷²

86. Në nivelin legjislativ, liria e tubimit paqësor është e përfshirë në një sërë ligjesh, duke përfshirë Ligjin Nr. 03/L-118 për Tubimet Publike, Ligjin Nr. 04/L-076 për Policinë dhe Kodin Penal Nr. 06/L-074 të Kosovës.

87. Ligji Nr. 03/L-118 për Tubimet Publike iu garanton të gjithë qytetarëve të drejtën për të organizuar dhe për të marrë pjesë në tubime publike. OSHC-të e gëzojnë të drejtën për lirinë e tubimit publik si individualisht ashtu edhe përmes organizatave të tyre. Autoritetet kompetente janë të obliguara të sigurohen që janë plotësuar të gjitha kushtet e percaktuara me ligj për organizimin e një tubimi, ndërsa procedurat administrative konsiderohen të lehta për t'u zbatuar. Parakushti i vetëm për organizimin e një tubimi publik është që autoritetet kompetente duhet të njoftohen 72 orë më herët. Dispozitat e ligjit iu referohen vetëm "qytetarëve të Kosovës", duke e lënë të paqartë nëse liria e tubimit vlen edhe për personat pa shtetësi, refugjatët, shtetasit e huaj dhe të tjerët. Edhe pse nuk përmenden me këta terma, tubimi i njëkohësishëm dhe kundër-tubimi nuk lejohen

70 Kushtetuta e Kosovës (2008), neni 43.

71 Komisioni Evropian (2021), [Raporti Vjetor i Progresit](#).

72 Ibid.

më Ligj. Ligji për Tubime Publik është në proces të ndryshimit dhe ka kaluar nëpër konsultim publik me shkrim gjatë pjesës së dytë të vitit 2021. Disa OSHC i kanë dorëzuar komentet e tyre, duke i trajtuar kryesisht çështjet e paqarta që u diskutuan në këtë paragraf.

88. Në vitin 2020, u miratua Ligji nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19. Ligji në fjalë i ka paraqitur disa kufizime ndaj lirisë së tubimit paqësor sa i përket pandemisë. Prandaj, siç kanë raportuar OSHC-të, kjo liri u kufizua më së shumti nga masat kundër përhapjes së COVID-19, gjë që ndikoi në zbatimin e saj praktik.⁷³

89. Në vitin 2021, QK prezantoi një sërë masash parandaluese për ta luftuar përhapjen e COVID-19. Këto masa më së shumti kanë pasur ndikim në lirinë e tubimit paqësor.

90. Në ndërlidhje të drejtpërdrejtë me numrin e infektiveve të reja, kjo liri iu nënshtrua disa llojeve të kufizimeve. Nga gjysma e dytë e vitit 2020, pasi që u rrit numri i infektiveve të reja, qeveria prezantoi masa të reja parandaluese pas rekomandimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike. Këto masa i ndaluan të gjitha llojet e tubimeve, duke përfshirë tubimet e më shumë se pesë personave në sheshet publike dhe liria e lëvizjes së qytetarëve u kufizua për një periudhë të caktuar nga ora 05:00 deri në orën 22:30. Nga fundi i shtatorit 2020, pasi që numri i rasteve të reja me COVID-19 filloi të bie, QK filloi t'i lehtësojë disa prej masave, duke përfshirë kufizimet e ngritura për lirinë e lëvizjes. Megjithatë, kufizimet për tubime publike nuk u hoqën, me përjashtim për pjesëmarrje në rituale fetare si dhe në aktivitete të brendshme dhe të jashtme sportive. Këto kufizime të njëjta të imponuara ndaj lirisë së tubimit paqësor vazhduan edhe në vitin 2021.

91. Megjithatë, përkundër masave ndaj pandemisë, trendi pozitiv i organizimit të tubimeve publike për ngritjen e zërit lidhur me shqetësime të ndryshme vazhdoi edhe në vitin 2021. Edhe pse u ngritën kufizime të shumta, kryesisht që ndikonin në lirinë e tubimit paqësor, për shkak të përhapjes së virusit COVID-19, qytetarët arritën të gjejnë mënyra kreative për ta ngritur zërin.

92. Gjatë vitit 2021, pati tubime të shpeshta publike lidhur me tema të ndryshme. U mbajtën protesta në të cilat u kërkuan veprime urgjente dhe të menjëhershme kundër rasteve të shumta të vrasjes së grave në Kosovë, ku protestuesit bënë thirrje për të drejtat dhe barazinë e grave. Një shembull i tillë është protesta ku u kërkua drejtësi për vrasjen e një gruaje 18 vjeçare nga partneri i saj.⁷⁴ Kolektivi për Mendim dhe Veprim Feminist realizoi aksione në qytete të ndryshme në tërë Kosovën në vitin 2021. Ngjyrosja e hapësirave publike me mesazhe si “puna e papaguar e grave e mban shtetin” dhe “ngacmuesit seksualë janë kriminelë” e tërhoqën vëmendjen e publikut.⁷⁵

93. Edhe punëtorët shëndetësorë ishin të zëshëm në shprehjen e kërkesave të tyre përmes protestave. Ata kryesisht kërkuan kushte më të mira të punës, sidomos gjatë pandemisë. Më saktësisht, ata kërkuan “vazhdimin e dialogut social me Ministrin, lëshimin e Udhëzimit Administrativ për Shtesa në Paga, si dhe miratimin e Ligjit për Paga” dhe pagesë shtesë për punën gjatë festave shtetërore.⁷⁶ Në një rast tjetër, stafi mjekësor i Spitalit Rajonal të Mitrovicës protestoi në përkrahje të kolegëve të tyre që ishin sulmuar fizikisht nga një familjar i një pacienti. Ata iu bënë thirrje

73 FKSHC (2021), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2021.

74 [Kallxo](#) (2021).

75 [Koha](#) (2021).

76 [Koha](#) (2021).

autoriteteve kompetente që ta ndjeknin rastin penalisht dhe t'i jepnin autorit të asaj vepre një dënim meritör.⁷⁷

94. Në lidhje me protestat dhe marshet për të drejtat e punëtorëve, u organizuan dhjetëra tubime ku morën pjesë punëtorë të institucioneve private dhe publike duke kërkuar kushte më të mira të punës. Njerëzit anëmbanë Kosovës u organizuan për të kërkuar nga komunat e tyre përkatëse përmirësime në infrastrukturë dhe kushte të tjera të punës në lagjet e tyre.⁷⁸ Përmes protestave, qytetarët shprehën pakënaqësi me disa aktvendime, siç ishte ai i Gjykatës Themelore në Ferizaj për ta liruar në arrest shtëpiak personin që e shkaktoi një aksident me veturë që shkaktoi 5 viktima.⁷⁹

95. Partitë politike i mbajtën fushatat e tyre pa i respektuar sa duhet masat kundër COVID-19 dhe organizuan protesta dhe performanca të shumta kryesisht me qëllimin për të ushtruar presion ndaj qeverisë.⁸⁰ Shembuj të tillë përfshin përdorimin e protestuesve paqësorë para ndërtesës së qeverisë në përpjekje për ta kundërshtuar vendimin e qeverisë për mbylljen e çerdheve si pjesë e masave të reja kundër COVID-19.⁸¹ Në një rast tjetër, dhjetëra aktivistë e dënuan marrëveshjen e arritur mes Kosovës dhe Serbisë për vendosjen e stikersave në automjete dhe targa me të cilat mbuloheshin targat zyrtare të veturave me stikerë të ngjashëm.⁸²

96. Në vitin 2021, u raportuan së paku dy raste të dhunës policore ndaj organizuesve ose pjesëmarrësve të rasteve të tubimit publik.⁸³ Këto raste ndodhën kur aktivistët e Partisë Social Demokrate të Kosovës u arrestuan përderisa po organizonin aksione dhe protesta dhe partia e akuzoi PK-në për dhunë, duke pretenduar që aktivistët e saj ishin lënduar gjatë arrestimeve.

97. Rekomandime:

- Në Ligjin e ndryshuar për Tubime Publike duhet të merret parasysh liria e tubimit paqësor edhe për kategoritë e personave pa nënshtetësi, refugjatëve, shtetasve të huaj dhe të tjerët;
- Policia e Kosovës duhet të sigurojë zbatimin efektiv të lirisë së tubimit paqësor të qytetarëve si e drejtë kushtetuese dhe ligjore dhe të përmbahet nga përdorimi i panevojshëm i forcës duke i respektuar parimet elementare si ligjshmëria dhe proporcionaliteti në rastet e arrestimit;
- Rekomandohet IPK-ja ta monitorojë performancën e zyrtarëve policorë në lidhje me sjelljet e tyre gjatë tubimeve ose protestave të ndryshme të qytetarëve.

77 [Kallxo](#) (2021).

78 [Kallxo](#) (2021).

79 [Koha](#) (2021).

80 [Slobodna Evropa](#) (2021).

81 [Kallxo](#) (2021).

82 [Kallxo](#) (2021).

83 [Civicus](#) (2021).

5.7 Liria e asociimit

98. Neni 44 i Kushtetutës e garanton lirinë e asociimit, duke përfshirë të drejtën e secilit për të themeluar, për t'iu bashkuar dhe për të marrë pjesë në një organizatë pa leje dhe të drejtën për të themeluar sindikata. Më tutje ai parasheh që gjykatat kompetente mund të ndalohen organizatat që "kanë për qëllim cenimin e rendit kushtetues, shkeljen e lirive dhe të drejtave të njeriut, ose nxitjen e urrejtjes racore, kombëtare, etnike a fetare". Dhjetëra instrumente të të drejtave të njeriut që zbatohen drejtpërdrejt në Kosovë e mbrojnë poashtu lirinë e asociimit.⁸⁴

99. Ligji i ri Nr. 06/L-043 për Lirinë e e Asociimit në Organizata Jo-Qeveritare hyri në fuqi në vitin 2019. Dispozitat e tij ligjore, të harmonizuara me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, e garantojnë të drejtën e asociimit pa nevojën për të marrë leje. Ligji e lejon ekzistimin e OJQ-ve në tri forma ligjore: shoqata, fondacione dhe institute. Ai poashtu përcakton që OJQ-të duhet të ofrojnë përfitim publik apo të ndërsjellë dhe iu garanton një status të lehtësirave tatimore. Ligji Nr. 04/L-011 për Organizimin Sindikal në Kosovë e mbron të drejtën për të formuar sindikata të sektorit privat dhe publik, ndërsa Ligji Nr. 03/L-212 i Punës i përcakton të drejtat e punës në lidhje me lirinë e asociimit.

100. Në vitin 2019, Departamenti i OJQ-ve (OJQD) e nisi procesin e hartimit të legjislacionit dytësor për zbatimin e Ligjit për Lirinë e Asociimit në OJQ.⁸⁵ Gjatë vitit 2021, nuk u nxorrën akte nënligjore për zbatimin e Ligjit në fjalë, në krahasim me vitin 2020 kur u nxorën dy akte të tilla nënligjore.⁸⁶

101. Regjistrimi i organizatave nuk është obligativ. Liria e asociimit vlen njësoj për individët dhe subjektet juridike që duan të themelojnë shoqata, fondacione apo institute. Mbrojtja nga çdo formë e diskriminimit është e garantuar me Ligjin Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi.⁸⁷ Askush nuk mund të përndjeket penalisht për vendimin për t'iu bashkuar apo për të mos u bashkuar dhe askush nuk obligohet të bashkohet vullnetit të tij. Kur grupet e caktuara vendosin të marrin status ligjor, duhet të plotësohen këto kritere: shoqatat janë organizata me anëtarësi, prandaj nevojiten së paku tre persona fizikë ose juridikë për themelimin e tyre; fondacionet mund të themelohen nga një person apo një testament dhe nevojitet një fond monetar fillestar; institutet mund të themelohen nga së paku një person. Ligji i ri e ka shkurtuar procedurën e regjistrimit nga 60 në 30 ditë. Regjistrimi është falas dhe rregullat e regjistrimit konsiderohen të thjeshta për tu ndjekur. Platforma elektronike për regjistrimin e OSHC-ve e lehtëson edhe më shumë procesin.

102. Kosova ende nuk e ka një kornizë ligjore të dedikuar për organizimin në nivel bazë. Megjithatë, edhe pse nuk përmendet me këta terma, organizimi i tillë është paraparë me Ligjin për Lirinë e Asociimit në OJQ. Ligji nuk i njeh organizatat e nivelit bazë si kategori specifike për ushtrimin e kësaj lirie edhe pse e lejon funksionimin e nismave të peregjistruara. Rrjetet regjistrohen si shoqata, prandaj, vlejné të njëjtat rregulla dhe procedura sipas Ligjit për Lirinë e Asociimit.

84 Kushtetuta e Kosovës (2008, neni 22 dhe 44).

85 Ibid.

86 Shih [Gazetën Zyrtare](#) (2019).

87 [Kallxo](#) (2021).

103. Në vitin 2021, nuk pati pezullime të OSHC-ve nga DOJQ-ja. Vala e fundit e pezullimeve ndodhi në vitin 2018 kur u pezulluan 20 OSHC. Problemi qëndron në bazën ligjore në të cilën mbështetet DOJQ, Udhëzimi Administrativ i QRK-së – Nr. 02/2014 për Regjistrimin dhe Funkcionimin e OJQ-ve,⁸⁸ i cili pohon që OSHC-të mund të pezullohen nga DOJQ për veprimtari që nuk përputhet me rendin kushtetues të Kosovës, bazuar në kërkesën e “institucioneve të autorizuara të sigurisë”. Megjithatë, në rastet e pezullimeve deri më sot, nuk ka dëshmi të hetimeve paraprake se janë bërë shkeljet e pretenduara dhe “institucionet e autorizuara të sigurisë” që i kanë lëshuar kërkesat nuk janë specifikuar asnjëherë. Të dhënat e FKSHC-së tregojnë që nga viti 2014 deri në vitin 2021, janë pezulluar gjithsej 70 OSHC. Vendimet për pezullimin e 24 organizatave ripërtërihen çdo vit, që nënkupton se mbeten të pezulluara.

104. Legjislacioni për raportimin financiar dhe rregullat e kontabilitetit nuk ndryshoi në vitin 2021. Si i tillë, ai vazhdon ta injorojë natyrën specifike të OSHC-ve. OSHC-ve iu lejohet të përfshihen në aktivitete ekonomike për ta mbështetur veprimtarinë e tyre në përputhje me parimin “jopërfituese”. Legjislacioni lejon që OSHC-të të përfshihen në aktivitete ekonomike drejtpërdrejt ose përmes pronësisë së pronës dhe asetëve. Të hyrat e gjeneruara përmes aktiviteteve të tilla duhet të shfrytëzohen vetëm për qëllime që kanë të bëjnë me misionin e organizatës. Përveç aktiviteteve ekonomike, OSHC-ve iu lejohet të marrin financim të jashtëm dhe privat, pasi që legjislacioni në fuqi nuk e ndalon atë në asnjë formë.

105. Në vitin 2021, nuk u raportuan raste të shkeljes së Ligjit për Lirinë e Asociimit. Asnjë OSHC nuk raportoi vështirësi në ushtrimin e lirisë së asociimit, qoftë në internet apo në mënyrë fizike.⁸⁹ Megjithatë, u shënuar një vonesë në regjistrimin e një organizate. Prindërit e fëmijëve që vijnë çerdhet me bazë në komunitet u obliguan ta regjistronin një organizatë për funksionimin e çerdes. Përkundër aplikimit të tyre në tetor të vitit 2020, ky grup raportoi në pjesën e parë të vitit 2021 se DOJQ ende nuk kishte lëshuar një përgjigje.⁹⁰

106. Rekomandime:

- Duhet të plotësohet korniza specifike ligjore lidhur me organizimin në nivelin bazë;
- Departamenti për OJQ duhet të hartojë akte nënligjore të Ligjit Nr. 06/L-043 për Lirinë e Asociimit në OJQ me përfshirjen e OJQ-VE. Për më tepër, DOJQ duhet t’i ngrisë kapacitetet në mënyrë që ta zbatojë mandatin e tij në mënyrë efektive. Staf i tij duhet të trajnohet në parimet ndërkombëtare të lirisë së asociimit dhe dispozitat e reja të përfshira në Ligjin e miratuar Nr. 06/L-043 për Lirinë e Asociimit në OJQ;
- Njësia e Inteligjencës Financiare, Ministria e Financave dhe Banka Qendrore e Kosovës duhet të hartojnë dhe të miratojnë kornizën specifike rregullative për bankat dhe OSHC-të bazuar në rekomandimin nr. 8 të FATF-së, përkatësisht për vlerësimin e rrishtit sektorial, për të mundësuar shërbime financiare të papenguara për OSHC-të dhe për t’i inkurajuar transaksionet bankare brenda operacioneve financiare të OSHC-ve.

⁸⁹ FKSHC (2021), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2021.

⁸⁸ Udhëzimi Administrativ i QRK – Nr. 02/2014 për Regjistrimin dhe Funkcionimin e OJQ-ve, (2021).

5.7 Liria e besimit, ndërgjegjes dhe e fesë

106. Besimi, ndërgjegjja dhe feja janë të drejta të garantuara me Kushtetutë sipas nenit 3 të Kushtetutës së Kosovës. Liria e besimit, ndërgjegjes dhe e fesë ngërthen të drejtën për ta pranuar dhe për ta manifestuar fenë, të drejtën për t'i shfaqur bindjet personale dhe të drejtën për të pranuar ose refuzuar për të qenë anëtar i një bashkësie ose grupi fetar (neni 38 paragrafi 2). Poashtu, është me rëndësi të ceket që Kushtetuta e përcakton Kosovën si shtet laik dhe neutral në çështjet e besimeve fetare, duke siguruar mbrojtjen e trashëgimisë fetare dhe duke e ndaluar diskriminimin në baza fetare (neni 8). Për më tepër, dhjetëra instrumente të të drejtave të njeriut që e mbrojnë këtë liri zbatohen drejtpërdrejt në Kosovë sipas nenit 22 të Kushtetutës.

107. Situata lidhur me kornizën ligjore nuk ka ndryshuar nga periudha e kaluar e raportimit. Ligji Nr. 02/L-31 për Liritë Fetare në Kosovë e garanton lirinë e besimit, ndërgjegjës dhe të fesë për të gjitha komunitetet fetare në Kosovë, edhe për sa iu përket të drejtave të barabarta, mbrojtjes ligjore dhe të drejtave pronësore. Megjithatë, ai nuk i ofron komuniteteve fetare të drejtën për të regjistruar dhe fituar status të personit juridik, gjë që sipas Komisionit të Venedikut e shkel nenin 9 dhe 11 të KDNJ-së mbi bazën që komuniteteve fetare të cilave iu mungon statusi i personit juridik me gjasë do të ballafaqohen me "pengesa diskriminuese juridike" që kanë të bëjnë me blerjen apo qiradhënien e pronës, çështjet financiare, kontratat dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre në forume ligjore.

108. Që nga tetori i vitit 2017, është në pritje një projektligj me të cilin synohet të ndryshohet Ligji nr. 02/L-31 për Liritë Fetare për t'iu mundësuar komuniteteve fetare në Kosovë të regjistrohen dhe të marrin statusin e personit juridik. I përgatitur fillimisht në bazë të rekomandimeve të akterëve ndërkombëtarë dhe me kërkesat e komuniteteve fetare në Kosovë,⁸⁹ projektligji u rishikua në vitin 2017 dhe më në fund u fut në agjendën e KK-së në maj të vitit 2019, megjithatë as nuk u diskutua as nuk u miratua nga KK-ja në vitin 2019. Nëse miratohet, projekti ligji do të parashihte regjistrimin automatik dhe statusin ligjor të gjashtë komuniteteve fetare të njohura në Kosovë dhe regjistrimin opsional për komunitetet "e reja" fetare nëse plotësohen disa kushte të caktuara. Komisioni i Venedikut konstatoi që ky sistem i diferencuar është në përputhje me nenin 9 dhe 14 të KEDNJ-së pasi që ekziston një "objektiv dhe bazë e justifikueshme për arsye historike" në Kosovë për t'i trajtuar ndryshe këto komunitete fetare.⁹¹ Deri në ndryshimin e ligjit, grupeve fetare nuk iu lejohet të regjistrohen si subjekte juridike në Kosovë, gjë që ua bën atyre të pamundur të praktikojnë afarizëm, partneritete monetare apo çështje juridike me subjekte të tjera publike dhe private. Ndryshimi i Ligjit për Liritë Fetare është në Programin Legjislativ të Qeverisë për vitin 2022.⁹¹

109. Në Kosovë ndodhen 24 Zona të Veçanta nën Mbrojtje të përcaktuara në bazë të rëndësisë fetare dhe kulturore të cilat mbrohen me ligj nga aktivitetet që mund ta prishin apo dëmtojnë mjedisin historik, kulturor ose natyror. Një njësi multietnike e policisë ofron mbrojtje të specializuar 24 orë në këto zona. Edhe pse nuk është raportuar ndonjë incident në këto lokacione në dy vitet e fundit, janë raportuar vjedhje dhe vandalizëm në lokacione të Kishës Ortodokse Serbe (KOS) jashtë këtyre zonave.

110. Aktgjykimi i formës së prerë i vitit 2016 i Gjykatës Kushtetuese lidhur me kontestin pronësor

90 [Gazeta e Prizrenit](#) (2021).

91 Shih [Programin Legjislativ për vitin 2022](#).

mes Manastirit të Deçanit dhe Komunës së Deçanit me të cilin u vërtetua pronësia ligjore e manastirit mbi pronën mbetet i pazbatuar.⁹²

111.Rekomandime:

- Aktgjykimi KI132/15 i Gjykatës Kushtetuese lidhur me Manastirin e Deçanit duhet të zbatohet;
- Policia e Kosovës dhe Prokurori i Shtetit duhet t'i hetojnë plotësisht dhe me efikasitet dhe krimet veprat penale me motive fetare;
- QK dhe KK duhet të sigurojnë ndryshimin e duhur të Ligjit Nr. 02/L-31 për Liritë Fetare për t'iu ofruar grupeve ligjore të drejtën për të regjistruar dhe fituar status të personit juridik.

6. PJESA B: TË DREJTAT EKONOMIKE, SOCIALE DHE KULTURORE

6.1 Të drejtat e punës

112. Të drejtat e punës në Kosovë mbrohen me Kushtetën e Kosovës. Ligji garanton të drejtën për punë dhe për zgjedhje të lirë të një profesioni sipas nenit 49.1 dhe 49.2, "Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës". Liria e asociimit, liria për të themeluar sindikata dhe ndalimi i punës së detyruar janë të mbrojtura poashtu me Kushtetutë. Dispozitat e tjera përfshinë sigurimin social themelor që ka të bëjë me papunësinë në nenin 51, si dhe përfaqësimin e barabartë të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në punësimin publik në nenin 61.⁹³ Baza ligjore është formuar edhe me Ligjin nr. 03/L-212 të Punës, me Ligjin nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe Ligjin nr. 05/L-011 për Organizimin Sindikal në Kosovë, të cilët i rregullojnë dhe i përcaktojnë të drejtat dhe liritë e punëtorëve për të themeluar sindikata në sektorin publik dhe privat.

113. Inspektorati i Punës në Kosovë është organi kryesor monitorues që e mbikëqyrë zbatimin e ligjeve të punës në praktikë. Megjithëse numri i inspektorëve është rritur në krahasim me vitin 2020, nga 30 në 39 të punësuar, Projektligji nr. 07/L-028 për Inspektoratin e Punës, me të cilin synohet të adresohet punësimi joformal dhe rritja e kapaciteteve të inspektorëve të bizneseve për parandalimin e shkeljeve, ende është duke e pritur miratimin sipas raportit të kaluar të progresit.

114. Sa i përket ofrimit të sigurisë dhe shëndetit në punë (SSHO), Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP) raporton që Kosova i ka shtuar përpjekjet për zhvillimin e një legjislacioni dhe

⁹² Komisioni Evropian (2021), [Raporti Vjetor i Progresit](#).

⁹³ Kushtetuta e Kosovës (2008).

inspektorati të punës të harmonizuar me standardet ndërkombëtare dhe evropiane. Megjithatë, përkundër miratimit të parimeve ndërkombëtare, janë identifikuar boshllëqe të mëdha lidhur me respektimin e procedurave të rrepta nga punëtorët që të mund të arrihet një mjedis i sigurt i punës, sidomos në fushën e ndërtimitarisë. Përveç kësaj, ekziston një mungesë kritike e statistikave për aksidentet që kanë të bëjnë me punën, mungesë e vetëdijes publike për SSHO-në në punë dhe mungesë e një sistemi të mirëfilltë të mbikëqyrjes së shëndetit i cili do ta siguronte trajtimin e sëmundjeve që kanë të bëjnë me punën.⁹⁴

115. Sipas IKD-së, gratë në veçanti janë në rrezik të kontesteve që kanë të bëjnë me punën.⁹⁵ Nga shkurti 2020 deri në dhjetor 2021, IKD i identifikoi dhe i monitoroi 151 seanca gjyqësore të natyrës civile dhe administrative ku gratë ishin të përfshira në konteste të ndryshme lidhur me punësimin e tyre. Gjykatat nuk vendosën për asnjërën prej këtyre rasteve mbi baza të diskriminimit sipas Ligjit nr. 5/L-021 kundër Diskriminimit.

116. Papunësimi në mesin e të rinjve mbetet sfidë e madhe socio-ekonomike në Kosovë. Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) raporton një Shkallë të Papunësisë tek të Rinjtë (SHPR) prej 46.8 përqind për vitin 2021. Poashtu, raporti i Komisionit Evropian e përshkruan një shkallë të mosaktivitetit tek të rinjtë prej rreth 62 përqind.⁹⁶ Përkundër një rënieje diakronike që nga viti 2018 (shih Tabelën 4), për shkak të kushteve socio-ekonomike të rinjtë kosovarë nuk e ndejnë një lidhje të mirëfilltë mes standardeve të Kosovës dhe atyre të Evropës Perëndimore të prosperitetit dhe zhvillimit ekonomik.

117. Komunitetet rom-K, ashkali-K dhe egjiptian-K vuajnë nga papunësia e lartë dhe individët me këtë përkatësi etnike janë në rrezik veçanërisht të lartë të diskriminimit në vend të punës në bazë të përkatësisë së tyre etnike.⁹⁷

118. Sot në Kosovë ekzistojnë rreth 208 shoqata sindikaliste. Përkundër kësaj, kushtet e punës së të punësuarve, sidomos në sektorin privat, mbesin të dobëta ndërsa paga minimale e ulët dhe kushtet e punës që varen pothuajse tërësisht në vullnetin e punëdhënësve për t'i zbatuar ligjet e punës. Studime të ndryshme paraqesin një imazh shqetësues të të drejtave në tregun e punës në Kosovë.⁹⁸ Nepotizmi dhe njëanshmëria në bazë të preferencave personale janë një fenomen i përhapur në vendet e punës në sektorin publik dhe privat pasi që mungojnë mekanizmat e mjaftueshëm të kontrollit. Transparenca e pamjaftueshme ka rezultuar në staf të punësuar në mënyrë joformale në ndërmarrjet formale.

119. Rekomandime:

- QK duhet të sigurojë që të miratohet Projektligji Nr. 07/L-028 për Inspektoratin e Punës;
- QK duhet të ofrojë më shumë përkrahje konkrete për të gjithë personat e papunësuar, me fokus të veçantë në grupet e marginalizuara;

94 [Organizata Ndërkombëtare e Punës \(2021\).](#)

95 IKD (2021), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2021.

96 Komisioni Evropian (2021), [Raporti Vjetor për Kosovën.](#)

97 [Qendra Kosovare për Studime Gjitnore \(2021\).](#)

98 Instituti Demokratik i Kosovës (IKD, 2021), [Anketë e opinionit publik në Kosovë.](#)

- QK duhet t'i kushtojë më shumë vëmendje që ta sigurojë të drejtën e të gjithë punëtorëve për siguri dhe shëndet në punë, duke përfshirë, veçanërisht, mjedise të dhura të punës që iu përmbahen plotësisht masave të mbrojtjes dhe sigurisë nga COVID-19.

6.2 E drejta për arsim

120. Neni 47 i Kushtetutës iu garanton të gjithëve të drejtën për arsim bazë falas dhe kërkon që institucionet publike t'iu ofrojnë mundësi të barabarta arsimore "në përputhje me aftësitë dhe nevojat e tyre specifike". Poashtu, Kushtetuta iu ofron pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë të drejtën për arsim publik në një rreth prej gjuhëve zyrtare sipas zgjedhjes së tyre në të gjitha nivelet në përputhje me ligjin, ku pragu i formimit të klasëve ose shkollave specifike për këtë qëllim duhet të jetë më i ulët se ai i përcaktuar zakonisht për institucionet arsimore.⁹⁹ Kushtetuta iu cakton ligjeve të arsimit një status special si legjislacion me interes vital (neni 81).

121. Sipas nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Kosovë, të gjithë personat që iu takojnë komuniteteve kanë të drejtë të marrin shkollim publik në të gjitha nivelet në një rreth prej gjuhëve zyrtare që ata e zgjedhin.¹⁰⁰ Poashtu, detyra e përgjithshme e Ministrisë është t'iu ofrojë mundësi të barabarta të gjithë nxënësve për qasje në shkollim sipas aftësive dhe nevojave të tyre specifike dhe ta promovojë arsimimin dhe zhvillimin e tyre social.¹⁰¹

122. OJQ Advancing Together (AT) raporton që, ashtu si në vitet e kaluara, MASHTI ka vazhduar me praktikën e mirë të mbështetjes së nxënësve në arsimin e mesëm të lartë nga komunitetet ashkali-K, egjiptian-K dhe rom-K me bursa.¹⁰² Si rrjedhojë, 500 nxënës kanë përfituar nga kjo mbështetje. Megjithatë, për herë të parë, një grup i nxënësve rom-K (afro 70) që vijonin arsimin brenda sistemit arsimor të mbështetur nga Beogradi janë përjashtuar nga ky proces. Për shkak të mungesës së kurrikulës arsimore në gjuhën e tyre amtare apo për shkak të arsimit në gjuhën serbe në zonat e tyre specifike nga autoritetet kosovare, këta nxënës rom-K janë të detyruar ta vijojnë sistemin arsimor të administruar nga Beogradi.

123. Një Projektligj për Arsimin e Lartë, i cili do të siguronte mekanizma të sigurimit të cilësisë dhe funksionimit të pavarur dhe autonom të arsimit të lartë, nuk është miratuar ende. Korniza kosovare e kualifikimeve në fushën e arsimit bazohet në Kornizën Evropiane të Kualifikimeve. Ligji Nr. 05/L-066 për Profesionet e Rregulluara, me të cilin rregullohet njohja e ndërsjellë e kualifikimeve profesionale mes shteteve anëtare të BE-së, është i harmonizuar deri në një masë të caktuar me kornizën ligjore të BE-së por ende nevojitet harmonizim i mëtutjeshëm. Agjencia Kosovare e Akreditimit, e cila bën akreditimin e institucioneve publike dhe private për arsimin e lartë, u përjashtua nga Regjistri Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë në

99 Kushtetuta (2008), neni 59.

100 Shih [Ligjin nr. 03/L-047](#)

101 Shih [Ligjin nr. 04/L-032](#)

102 AT (2021), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2021.

shtator të vitit 2019 dhe ende mbetet ta rikthejë statusin e anëtarit pranë atij institucioni. Mungesa e këtij anëtarësimi ka shkaktuar një sërë pasojash negative, të cilat kanë ndikuar kryesisht në këmbimin e të dhënave dhe pengesa në njohjen e dokumenteve të lëshuara nga institucionet arsimore në Kosovë.¹⁰³

124. Regjistrimi i fëmijëve në arsimin e obliguar, në arsimin fillor, të ulët dhe të mesëm të ulët është universal (100 përqind e vijnë nga klasa 1-5, 90.5 përqind 5-9 dhe 86.6 përqind 9-12). Shkalla e braktisjes së shkollave mbetet e lartë në mesin e fëmijëve romë-K, ashkali-K dhe egjiptian-K, edhe pse statistikat nuk janë të besueshme.¹⁰⁴

125. Sipas HANDIKOS, pandemia e ka ndërprerë qasjen në arsim për personat me aftësi të kufizuara.¹⁰⁵ Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin arsimor mbetet sfidë.¹⁰⁶ Të dhënat e fundit tregojnë që 3,903 fëmijë me nevoja të veçanta janë të regjistruar në klasat e rregullta dhe 349 në qendra burimore.¹⁰⁷ Bazuar në informatat e UNICEF-it dhe ato të MASHTI-t, vetëm 11 deri në 12 përqind e fëmijëve me aftësi të kufizuara janë të përfshirë në procesin arsimor. Gjatë periudhës 2017-2021, klasat e bashkangjitura në mbarë Kosovën janë reduktuar nga 76 në 18 sosh. Këto klasa pritet të shndërrohen në klasa burimore.

126. OSHC-të raportojnë që pjesëmarrja dhe përfshirja e fëmijëve rom-K, ashkali-K dhe egjiptian-K në arsimin obligativ është rritur me kalimin e viteve. Megjithatë, pjesëmarrja e fëmijëve në arsimin parashkollor, parafillor dhe të mesëm të lartë mbetet sfidë.¹⁰⁸ Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, përfshirja e fëmijëve/nxënësve nga komunitetet rom-K, ashkali-K dhe egjiptian-K, sidomos në arsimin parashkollor, parafillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë vazhdon të jetë jashtëzakonisht e ulët në krahasim me mesataren kombëtare.¹⁰⁹

127. Pandemia COVID-19 i ka prekur të gjithë fëmijët, por në veçanti fëmijët nga grupet në situata të cënueshme,¹¹⁰ fëmijët me status të varfër socio-ekonomik, fëmijët me nevoja të veçanta arsimore dhe fëmijët nga komunitetet rom-K, ashkali-K dhe egjiptian-K. Poashtu, folësit jo-shqiptarë janë prekur negativisht, pasi që fillimisht mësimi në distancë përmes klasëve virtuale filloi vetëm në gjuhën shqipe. Studimet tregojnë që fëmijët nga grupet e marginalizuara u ballafaquan me mungesë të pajisjeve të teknologjisë informative pasi që shumë familje nga grupet e marginalizuara nuk kanë laptop, tablet apo kompjuter dhe shpesh disa fëmijë në një familje e kanë vetëm një telefon të mençur në dispozicion për mësim në distancë, kështu që iu mohohet e drejta për arsim për shkak të pengesave teknike. Asnjë politikë konkrete nuk është zhvilluar për ta shmangur thellimin e pabarazive në arsim gjatë pandemisë. Kosova është përpjekur t'i tejkalojë problemet e mungesës së platformave digjitale dhe materialeve të mësimi duke shfaqur orë mësimore të inçizuara paraprakisht në Radio Televizionin e Kosovës (RTK), në të cilin ka qasje një numër i madh njerëzish. Megjithatë, për të ofruar orë mësimore në mënyrë masive në televizion, lëndët e mësuara dhe koha e mësimi u shkurtuan konsiderueshëm, gjë që nënkupton se e drejta për arsim e

112 Ibid.

103 [Radio Evropa e Lirë](#) (2019).

104 Komisioni Evropian (2021), [Raporti Vjetor i Progresit](#).

105 HANDIKOS (2021), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2021.

106 KOMF (2021), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2021.

107 BSFK (2021), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2021.

108 Ibid.

109 Shih [KEC](#) (2021).

110 Ibid.

nxënësve që mbështeteshin në televizion u lehtësua me më pak efektivitet se sa për ata që kishin infrastrukturë të mirëfilltë digjitale dhe shkathtësi të teknologjisë së informimit.¹¹¹ Për më tepër, kalimi nga arsimit fizik në atë online dhe anasjelltas ka shkaktuar probleme për nxënësit me nevoja të veçanta pasi që mësimi online duhet të bëhet përmes prindërve.

128. RrGK raporton që Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKS) dhe Shërbimi Sprovues ende nuk kanë programe për riintegrimin dhe rehabilitimin e autorëve të veprave të dhunës apo për përcjelljen e këtyre rasteve. Qendrat për Punë Sociale kanë pasur vështirësi në ofrimin e menaxhimit të duhur të rasteve për shkak të mungesave të stafit. Kjo e ka ulur aftësinë e tyre për t'i përfaqësuar të drejtat e fëmijëve. Strehimoret kanë vazhduar të ballafaqohen me probleme financiare, edhe pse financimi është¹¹² përmirësuar që nga viti 2019. Përfaqësuesit e institucioneve arsimore dhe shëndetësore kanë vazhduar të kenë mungesë të ndërgjegjësimit për dhunën me baza gjinore dhe jo gjithmonë mund t'i raportojnë rastet në polici. Programet për trajtim janë të kufizuara. Zyrtarët e Qendrës së Aftësimin Profesional dhe të Zyrës së Punësimit në përgjithësi nuk janë të vetëdijshëm për përgjegjësitë e tyre ligjore dhe qasjen që duhet ta kenë kur iu ndihmojnë personave që kanë vuajtur nga dhuna me baza gjinore.¹¹²

129. Ndikimi i pandemisë së COVID-19 dhe sfidave që i solli ajo e kanë përkeqësuar edhe më shumë pozitën sociale të të rinjve në Kosovë. Shkallët e larta të papunësisë, mungesa e harmonizimit mes arsimit dhe nevojave të tregut të punës dhe nepotizmi në proceset e rekrutimit janë çështje të dukshme të theksuara nga të rinjtë dhe probleme të vazhdueshme të rinisë kosovare të shënuara në raporte të shumë OJQ-ve dhe organizatave ndërkombëtare e rajonale. Shkalla e papunësisë tek të rinjtë shkon deri në 49 përqind, ndërsa shkalla e jo aktivitetit të të rinjve është rreth 62 përqind.¹¹³

130. Strategjia ekzistuese për Rininë 2019-2023, në përputhje me Ligjin nr. 03/L-145 për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë, përbëjnë themelin për pjesëmarrjen e të rinjve në proceset e vendim-marrjes, në jetën publike, në arsimin joformal, në punësueshmëri, arsim, promovim të shëndetit, kulturë, sport dhe rekreativitet. Kjo strategji thekson arsimin joformal si mënyrë e zgjerimit të shkathtësive të të rinjve dhe e angazhimit të tyre për të ndikuar në rrethin e tyre.¹¹⁴

131. Rekomandime:

- MASHTI duhet t'i shtojë përpjekjet për zbatimin e legjislacionit në fuqi në gjuhët zyrtare në sistemin arsimor;
- Projektligji për Arsimin e Lartë duhet të përpunohet në mënyrë të duhur për miratim për të siguruar mekanizma të sigurimit të cilësisë dhe funksionim të pavarur dhe autonomi të institucioneve të arsimit të lartë;

111 Shih [KEC](#) (2021).

112 Ibid.

113 Komisioni Evropian (2021), [Raporti Vjetor i Progresit](#).

114 MKRS (2021), [Strategjia për Rininë \(2019-2023\)](#).

- Institucionet duhet ta adresojnë përqindjen e ulët shqetësuese të përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin arsimore;
- MASHTI duhet t'i shqyrtojë dhe nisë masat për kompensimin e ndikimit të COVID-19 në grupet më të cenueshme;
- Edhe pse QK është zotuar për zbatimin e Skemës së Punësimit të Garantuar për të Rinjtë, duhet ta emërojë një koordinator dhe një organ koordinues si dhe ta fillojë përpilimin e një plani për zbatimin e Skemës së Punësimit të Garantuar për të Rinjtë;
- QK duhet të zhvillojë plane strategjike ndërministrorë për ta plotësuar boshllëkun mes arsimit dhe tregut të punës në Kosovë me qëllimin që arsimit të bëhet më i orientuar ndaj nevojave të tregut të punës, duke përfshirë ofrimin e më shumë mundësive të përvojës praktike me pagesë për studentët në fushën e tyre të studimeve si dhe ofrimin e ligjëratave në formë elektronike;
- Komunitetet me një numër të konsiderueshëm të komuniteteve rom-K, ashkali-K dhe egjiptian-K duhet të hartojnë rregullore për t'i lehtësuar kushtet e regjistrimit dhe të vijimit të fëmijëve rom-K, ashkali-K dhe egjiptian-K në nivelin e arsimit parashkollor dhe të mesëm të lartë.

6.3 E drejta për kujdes shëndetësor

132. E drejta për kujdes shëndetësor është e mbuluar me nenin 51 të Kushtetutës i cili parasheh që kujdesi shëndetësor dhe sigurimi social rregullohen me ligj. Kushtetuta përcakton që "Sigurimi social themelor, që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë, rregullohet me ligj".¹¹⁵ Në nivel ligjor, ofrimi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor rregullohet me disa ligje. Lista në vijim përfshin ligjet relevante në fuqi në kontekstin e të drejtës për kujdes shëndetësor: Ligji Nr. 04/L-125 për Shëndetësinë, Ligji Nr. 06/L-042 për Gjak dhe Përbërës të Gjakut, Ligji Nr. 02/L-76 për Shëndetin Riprodhues, Ligji Nr. 02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, Ligji Nr. 02/L-78 për Shëndetësi Publike dhe Ligji Nr. 2004/38 për Të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Qytetarëve në Kujdesin Shëndetësor.

133. Autoritetet shëndetësore në Kosovë ishin të fokusuar kryesisht në menaxhimin e pandemisë COVID-19 gjatë viteve 2020-2021. Gjatë vitit 2021, IAP nxorri një raport ex-officio nr. 434/2020 për kufizimet në ofrimin e shërbimeve shëndetësore gjatë pandemisë COVID-19 në Kosovë, në të cilin rekomandoi një sërë masash për t'i mbrojtur të drejtat kushtetuese dhe ligjore në fuqi në këtë fushë të shëndetësisë. Vaksinimi po vazhdon sipas Planit Kombëtar të Shpërndarjes dhe Vaksinimit me Vaksina kundër COVID-19. Në kohën e finalizimit të këtij raporti, gjithsej 1,815,804 persona ishin të vaksinuar.¹¹⁶ Në Prishtinë dhe në qendra rajonale u ngritën objekte dhe pajisje për t'i mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Shëndetësisë për menaxhimin e pandemisë. Kapacitetet diagnostifikuese të laboratorëve qendrorë dhe rajonalë janë rritur dukshëm. Megjithatë, pandemia COVID-19 ka vendosur barrë të madhe mbi sistemin shëndetësor të Kosovës.¹¹⁷

¹¹⁵ [Kushtetuta e Kosovës](#) (2008, neni 51).

¹¹⁶ Shih Ministrinë e Shëndetësisë (2021), [Të dhëna lidhur me vaksinat](#).

¹¹⁷ Komisioni Evropian (2021), [Raporti Vjetor i Progresit](#)

Ministria e Shëndetësisë e informon publikon në baza ditore për statistikën kryesore në lidhje me pandeminë, duke përfshirë rastet e reja, numrin e vaksinimeve, numrin e vdekjeve, etj. Megjithatë, informatat e tilla shpërndahen kryesisht në gjuhën shqipe, duke e zvogëluar kështu aftësinë e personave që nuk e flasin shqipen për të pasur qasje në këto të dhëna dhe informata.

134. Megjithëse është arritur progres i konsiderueshëm në qasjen në shërbime shëndetësore, cilësia e kujdesit shëndetësor vazhdon të jetë burim për shqetësim. Kosova ende mbetet ta zbatojë planin universal të kujdesit shëndetësor. Miratimi i Ligjit për Sigurim Shëndetësor, si dhe fillimi i mbledhjes së premie shëndetësore, është shtyrë edhe një herë. Sistemi i informatave të shëndetit publik mbetet jofunksional. Sistemi shëndetësor po dëmtohet nga emigrimi i shtuar i stafit shëndetësor, gjegjësisht mjekëve dhe infermierëve të licencuar. Në krahasim me vitin 2020, buxheti i përgjithshëm për sektorin e shëndetësisë në vitin 2021 u rrit për 10 përqind. Përkundër kësaj rritjeje, shpenzimet për kujdesin shëndetësor ende përbëjnë rreth 3 përqind të BPB-së. Nuk ka pasur progres në strategjinë për sektorin e shëndetësisë dhe jo të gjithë qytetarët kanë qasje të barabartë në kujdes shëndetësor.¹¹⁸ Qasja në kujdesin shëndetësor është falas por shpenzimet për shërbimet diagnostifikuese dhe barna nuk rimbursohen. Mbështetja e madhe në shpenzimet private nga xhepi (që vlerësohet të jenë 40 përqind e totalit të kostove mjekësore – vetëm 65 përqind e nevojave vjetore të shëndetit publik mbulohen nga shpenzimet publike, kryesisht nga kostot fikse) e kufizon qasjen për grupet e cenueshme. Financimi i shëndetësisë nuk bazohet në vlerësimet e nevojave dhe llogaridhënia institucionale nuk është rritur.¹¹⁹

135. Sfidë në Kosovë mbetet gjendja shëndetësore e fëmijëve në situata të cenueshme. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, 73 përqind e fëmijëve të moshës 24-26 muajshe në Kosovë janë vaksinuar sipas kalendarit të imunizimit.¹²⁰ Prej tyre, 4 në 5 fëmijë të moshës 24-35 muajshe që jetojnë me familje të pasura në Kosovë janë plotësisht të vaksinuar në krahasim me 3 në 5 fëmijë të së njëjtës moshë që jetojnë me familje të varfra. Për më tepër, vetëm 38 përqind e fëmijëve nga komunitetet rom-K, ashkali-K dhe egjiptianë-K janë plotësisht të vaksinuar në krahasim me 73 përqind të fëmijëve nga popullata e përgjithshme. Kjo statistikë është shumë shqetësuese pasi tregon probleme të rënda shëndetësore për fëmijët në afat të shkurtër, të mesëm dhe të gjatë. Nga 1000 lindje vdesin 16 fëmijë nën 5 vjeç. Kjo statistikë është pothuajse dy herë më e lartë për fëmijët nga komunitetet rom-K, ashkali-K dhe egjiptian-K, ku 27 fëmijë vdesin në çdo 1000 lindje. Fëmijët viktimë të abuzimit me drogën nuk mund t'i marrin shërbimet e nevojshme rehabilituese, për shkak të mungesës së kapaciteteve të mjaftueshme të psikiatrive dhe pediatrave, si dhe për shkak të mungesës së burimeve të nevojshme në dispozicion. Si rezultat, nuk ka shërbime për identifikimin, rehabilitimin fizik dhe psikologjik dhe integrimin social të viktimave të tilla.¹²¹ Për më tepër, siç raporton KOMF në lidhje me përmirësimin e kornizës ligjore, Kodi Penal i Kosovës mbetet shqetësues, pasi e sanksionon shitjen dhe shërbimin e alkoolit për personat nën moshën 16 vjeçare, ndërsa bazuar në Kushtetutën e Kosovës, çdo person nën moshën 18 vjeçare konsiderohet fëmijë.¹²²

118 Organizata Botërore e Shëndetësisë (2021), [Mbajtja e shërbimeve esenciale shëndetësore në Kosovë](#).

119 Ibid, fusnota 103.

120 KOMF (2021), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi Të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2021.

121 Ibid.

122 Ibid.

136. Pandemia COVID-19, përmes ndikimit të saj në shumë veprimtari jetësore, ka shkaktuar shqetësim, ankth dhe traumë tek njerëzit, sidomos në mesin e fëmijëve. Bazuar në dëshmitë e siguruar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës përmes publikimit të anketës MICS nën kapitullin "Funksionimi i fëmijëve, ankthi është raportuar si sfera kryesore e vështirësive funksionale tek fëmijët e moshës 5-17 vjeçare.¹²³

137. Sipas raportit të OSHK BSKF mbi statusin shëndetësor të komuniteteve rom-K, ashkali-K dhe egjiptian-K në komunën e Fushë Kosovës, Shtimes, Obiliqit dhe Graçanicës, 16 përqind e të posalindurve dhe 63 përqind e nënave nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian nuk kanë pasur vizita pas lindjes pas lirimimit nga spitali. Sipas këtij raporti, 60.4 përqind e grave në Fushë Kosovë dhe 71.15 përqind në Obiliq nuk e kanë vizituar rregullisht gjinekologun e tyre. Bazuar në të dhënat e këtij raporti, mbi 50 përqind e të anketuarave janë përgjigjur se nuk kanë nevojë për gjinekolog. Shkalla e lindjes në komunitet rom-K, ashkali-K dhe egjiptian-K mbetet e lartë nga viti në vit. Në katër komunat janë 43 (7.5 përqind) gra shtatzëna nga 574 familjet e anketuara. Prej këtij numri, 15 prej tyre janë nën moshën 18 vjeçare.¹²⁴ Vetëm 38 përqind e fëmijëve që jetojnë në komunitetet rom-K, ashkali-K dhe egjiptian-K janë të vaksinuar plotësisht në krahasim me 73 përqind e fëmijëve në popullsinë e përgjithshme që i kanë marrë të gjitha vaksinat sipas kalendarit të imunizimit.¹²⁵

138. Rekomandime

- Ministria e Shëndetësisë dhe spitalet në Kosovë duhet të sigurohen që vizitat tek mjeku specialist dhe operacionet opsionale iu ofrohen atyre që kanë nevojë për to brenda një afati të shkurtër kohor edhe gjatë pandemisë në përputhje të plotë me masat për parandalimin e COVID-19;
- QK duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar menjëherë zbatimin e Ligjit Nr. 04/L-249 për Sigurimin Shëndetësor pa asnjë vonesë të mëtejshme, si dhe të sigurohet që të gjithë njerëzit në Kosovë kanë sigurim universal shëndetësor;
- QK duhet ta rrisë buxhetin e ndarë për sistemin shëndetësor në Kosovë, duke përfshirë financimin shtesë për shërbimet shëndetësore për shëndetin mendor;
- Ministria e Shëndetësisë dhe IKSHP-ja duhet t'iu përmbahen plotësisht obligimeve të tyre të përcaktuara me Ligjin Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve duke siguruar që të gjitha komunikimet zyrtare, përfshirë uebfaqet e tyre, japin informata në gjuhët zyrtare të Kosovës;
- QK duhet ta hartojë një plan për zbatimin e Ligjit për Sigurimin Shëndetësor;
- QK duhet ta shqyrtojë mundësinë e ndryshimeve në Kodin Penal për ta ndaluar shërbimin e alkoolit për të miturit nën moshën 18 vjeçare;

123 Ibid.

124 Ibid.

125 [Balkan Sunflowers](#) (Balkanski suncokreti) (2021).

- Ministria e Shëndetësisë duhet ta rrisë vaksinimin dhe imunizimin dhe të ofrojë shërbime të tjera shëndetësore për grupet në gjendje të cenueshme;
- Institucionet përkatëse duhet të sigurojnë zbatim të plotë dhe të vazhdueshëm të Raportit Ex-Officio të IAP-së (Rasti ex-officio nr. 489/2018) për përdorimin e substancave narkotike nga fëmijët.¹²⁶

6.4 Të drejtat pronësore

139. Kushtetuta e garanton, e vlerëson dhe e ndalon ndërhyrjen në të drejtën e pronësisë në pronë. Neni 46 në veçanti e trajton mbrojtjen e pronës, duke përkufizuar që e drejta e pronës është e garantuar. Shfrytëzimi i pronës, sipas Kushtetutës, rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik. Kushtetuta e ndalon privimin nga prona në mënyrë arbitrare. Asnjë autoritet publik i Kosovës nuk mund ta bëjë shpronësimin e pronës, përveç në raste kur ky shpronësim është i ligjshëm dhe duhet ta mbrojë pronën intelektuale. Përveç kësaj, me nenin 156 të Kushtetutës, Kosova e ka për obligim t’iu ndihmojë refugjatëve dhe PZHBV-ve “në kthimin e pronave dhe posedimeve të tyre”. Neni 122 e rregullon shfrytëzimin e pronës me interes të veçantë dhe burime natyrore, ndërsa neni 159 i trajton ndërmarrjet në pronësi shoqërore dhe interesat pronësore.

140. Në nivel legjislativ, ligjet dhe rregulloret relevante për mbrojtjen e të drejtave pronësore përfshijnë Ligjin Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat e Tjera Sendore, Ligjin Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP), Ligjin Nr. 2002/5 për Themelimin e Regjistrit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, Ligjin Nr. 03/L-007 për Procedurën Jokontestimore, Ligjin Nr. 2004/26 për Trashëgiminë, Ligjin Nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore, Ligjin Nr. 2004/32 për Familjen dhe Rregulloren Nr. 01/2018 për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme.

141. Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP) është një Agjenci e pavarur, e themeluar me nenin 142 të Kushtetutës dhe me Ligjin për AKKVP-në nga viti 2016 që e ka trashëguar mandatin e Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP) dhe të Drejtorisë për Strehim dhe Prona (DSP) lidhur me pronat e zaptuara. Sipas nenit 16.6 të Ligjit, vendimet e Gjykatës Supreme të Kosovës janë të formës së prerë dhe të zbatueshme dhe nuk mund të goditen përmes mjeteve juridike të zakonshme ose të jashtëzakonshme. Megjithatë, ka raste kur gjykatat e kanë lejuar rigjykimin e kontesteve të gjykuara me vendime të vlefshme të Komisionit për Kërkesa Banesore dhe Pronësore (KKBP) apo të Komisionit për Kërkesa Pronësore (KKP). Bashkësia ndërkombëtare në Kosovë iu ka bërë thirrje institucioneve të përgjegjshme që ta respektojnë legjislacionin relevant dhe të sigurojnë që të drejtat themelore të të gjithë qytetarëve respektohen, duke përfshirë kthimin në vendin e origjinës.

126 Raport i projektit të BSFK dhe UNICEF në 12 komuna: Mitrovicë, Podujevë, Obiliq, Fushë Kosovë, Lipjan, Shtime, Ferizaj, Gjiilan, Klinë, Istog, Pejë, Prizren

142. Lidhur me të drejtat pronësore, projektligji për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP) u rishikua sipas rekomandimeve të OILn-së, por nuk u miratua nga KK-ja. Në përgjithësi, zbatimi i vendimeve gjyqësore, duke përfshirë 33 vendimet e Gjykatës Kushtetuese, vazhdon të jetë një problem, veçanërisht në rastet pronësore në lidhje me konfliktin. Gjatë vitit 2021, institucionet i morën disa masa pozitive në lidhje me mbrojtjen e të drejtave pronësore të komuniteteve në situata të cenueshme, personave të zhvendosur dhe grave. AKKVP bëri dëbimin dhe një shembje të një strukture të kundërligjshme të ndërtuar në pronën e një personi të zhvendosur, duke ofruar dëmshpërblim efektiv të të drejtave pronësore. Është arritur pak progres në zbatimin e Udhëzimit Administrativ për Shembjen e Strukturave të Kundërligjshme të miratuar në prill të vitit 2020, edhe pse mungesa e mjeteve ia bënë të pamundur AKKVP-së të kryejë shembje në afat të shkurtë kohor.¹²⁷

143. Në prill të vitit 2021, QK e zgjeroi masën afirmative për ta rritur regjistrimin e pronës së përbashkët të paluajtshme në emër të të dy bashkëshortëve për gjashtë vite. Kjo masë, e prezantuar për herë të parë në vitin 2016, ka çuar në një rritje të dukshme në regjistrimin e grave si pronare të pronave, nga vetëm 104 në vitin 2016 në 7,417 në vitin 2020.¹²⁸ Nuk ka të dhëna të disponueshme lidhur me regjistrimin e pronës nga gratë si pronare/bashkëpronare për vitin 2021.

144. OSHC-të raportojnë për rëndësinë e zgjidhjes së kërkesave pronësore si një hap i madh drejt mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve joshumicë. Respektimi efektiv dhe i qëndrueshëm i kësaj të drejte themelore të njeriut mund të ketë efekt pozitiv për ta krijuar një rrugë drejt sigurisë ligjore për ata qytetarë që ende nuk kanë mundur t'i ushtrojnë të drejtat e tyre pronësore. OJQ AKTIV raporton që sa i përket çështjeve që kanë të bëjnë me të drejtat pronësore, një grup në situatë veçanërisht të cenueshme janë PZHBV-të, kthimi i të cilëve kushtëzohet në rend të parë nga e drejta për shfrytëzim të lirë të pronës së tyre. Çështjet e tilla mund ta parandalojnë çdo progres serioz në politikën e PZHBV-ve që kthehen në Kosovë.¹²⁹ Rasti i Gragica Gasiq mund të ketë vendur një precedent të rëndësishëm në këtë aspekt, pasi që pas kthimit në banesën e saj në qytetin e Gjakovës, Komuna e Gjakovës ngriti padi për anulimin e kontratës së Gasic. Komuna i kërkoi Gjykatës Themelore ta dëbojë të kthyerën serbe pasi që nuk kishte paguar qira që nga viti 1997.¹³⁰ Megjithatë Gjykata Themelore e hodhi poshtë padinë në gusht të vitit 2021, rastet e tilla mund t'i frikësojnë personat e tjerë të zhvendosur nga kthimi në shtëpitë e tyre.

145. Rregullimi i vendbanimeve të mëdha joformale ku banorët iu takojnë kryesisht komuniteteve në situata të cenueshme, vazhdon të pengohet nga mungesa e vullnetit politik për ta adresuar këtë çështje.¹³¹

146. Rekomandime:

- Zgjidhja e kërkesave pronësore duhet të përdoret si mjet për lehtësimin e pajtimit mes komuniteteve dhe për shmangien e konflikteve të mundura të nxitura nga kontekstet lidhur me pronën;

127 Komisioni Evropian (2021), [Raporti Vjetor i Progresit](#).

128 Ibid.

129 [AKTIV](#) (2021).

130 [Gazeta Express](#) (2021).

131 Komisioni Evropian (2021), [Raporti Vjetor i Progresit](#).

- QK duhet të vazhdojë zgjerimin e masave afirmative për regjistrimin e përbashkët të pronës derisa statistikat të tregojnë shpërndarje më të barabartë në regjistrimin e pronës për të dy gjinitë;
- Policia e Kosovës dhe Prokuroria duhet të sigurojnë që pronat të cilat iu takojnë anëtarëve të komuniteteve joshumicë nuk zaptohen përsëri pas dëbimeve të kryera nga AKKVP-ja;
- Autoritetet e nivelit qendror dhe lokal duhet ta vazhdojnë fushatën vetëdijësuese për rëndësinë e legalizimit të ndërtimeve pa leje;
- Autoritetet e nivelit qendror dhe lokal duhet të marrin hapa të duhur për formalizimin e vendbanimeve joformale me kohë.

6.5. Të drejtat kulturore

147. Në kornizën ligjore të Kosovës, Kushtetuta i thekson të drejtat kulturore të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre. Neni 59 përcakton që pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë të “shprehin, mbajnë dhe zhvillojnë kulturën e tyre dhe të ruajnë elementet thelbësore të identitetit të tyre, përkatësisht fenë, gjuhën, traditat dhe kulturën e tyre”.¹³² Për më tepër, komunitetet kanë të drejtë “të themelojnë shoqata të kulturës, artit, shkencës dhe arsimit, si dhe shoqata të studiuesve e shoqata të tjera për shprehjen, avancimin dhe zhvillimin e identitetit të tyre”.¹³³ Ndërsa Kushtetuta e Kosovës përfshin të drejta të ndryshme universale të njeriut dhe instrumente ndërkombëtare (shih nenin 22), e njëjta nuk vlen për Konventën Ndërkombëtare të të Drejtave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore e cila ende mbetet të përfshihet dhe të drejtat e saj kulturore ndërkombëtare të reflektohen në kornizën ligjore të Kosovës. Cenimi i të drejtave kulturore kuptohet në Rezolutën 30/20 të Këshillit për të Drejta të Njeriut në kontekstin e një kërcënimi ndaj “stabilitetit, kohezionit social dhe identitetit kulturor”.¹³⁴ Në programin e saj qeverisë, QK zotohet ta përmirësojë kornizën ligjore për promovimin e trashëgimisë kulturore të Kosovës.¹³⁵

148. Infrastruktura për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare të Kosovës është përcaktuar në nenin 9 të Kushtetutës së Kosovës. Në nenin 9, trashëgimia kulturore e komuniteteve përshkruhet si “pjesë integrale e trashëgimisë së Kosovës” dhe kështu theksohet që “[...] Kosova ka detyrë të veçantë të sigurojë mbrojtje efektive të të gjitha vendeve dhe monumenteve të rëndësishme kulturore dhe fetare të komuniteteve”.¹³⁶ Në Ligjin nr. 02/L-88 për Trashëgimi Kulturore, fushëveprimi i trashëgimisë kulturore përkufizohet si “trashëgimi arkitekturore, arkeologjike, e luajtshme dhe shpirtërore, pavarësisht nga koha e krijimit dhe ndërtimit, tipi i ndërtimit, përfituesit, krijuesit ose implementuesit të punës”.¹³⁷

132 Kushtetuta e Kosovës (2008).

133 Ibid.

134 Ibid.

135 Republika e Kosovës (2021), [Programi Qeverisë 2021-2025](#),

136 Ibid., neni 58.5.

137 [Ligji për Trashëgimi Kulturore](#) (2005, neni 1.3).

149. Kosova ende mbetet ta hartojë Ligjin për Trashëgimi Kulturore, për të cilin është zotuar QK në Shtojcën V të Planit të Ahtisaarit. Sipas Raportit të Komisionit Evropian (2021), Këshilli për Zbatim dhe Monitorim (KZM) mbetet mekanizmi i vetëm formal për dialog mes qeverisë dhe Kishës Ortodokse Serbe.¹³⁸ Pas tensioneve të ripërtërira, u arrit marrëveshje për punët e rrugës brenda dhe rreth Zonës Speciale të Mbrojtur të Deçanit (ZSM). Përderisa KZM është i paraparë për monitorimin e këtij progresi, ka nevojë për komunikim dhe bashkëpunim për përmirësim mes të dy anëve. Këshilli për Zbatim dhe Monitorim duhet t'i vazhdojë takimet dhe të identifikojë zgjidhje të përbashkta që duhet të arrihen mes Kosovës dhe KOS. Përveç kësaj, Ministria e Drejtësisë e ka formuar një ekip për hartimin e strategjisë kombëtare për drejtësi tranzicionale dhe ballafaqim me të kaluarën. Ekipi përbëhet nga përfaqësues shtetërorë, ekspertë të huaj dhe përfaqësues të OSHC-ve që do ta përgatisin një draft dokument me hollësi rreth mëyrës se si duhet të zbatohet strategjia. Megjithatë, është shumë e rëndësishme që dokumenti dhe procesi i hartimit të jetë gjithpërfshirës dhe të përqendrohet edhe në komponentën e pajtimit që deri më tash ka munguar.

150. Diskurset reciproke kontradiktore të shqiptarëve dhe serbëve rreth identitetit etnik të Kosovës vazhdojnë ta politizojnë trashëgiminë kulturore të njëri-tjetrit në rajon. Në vitin 2021, vazhduan shqetësimet për sigurinë e objekteve fetare të KOS-it dhe objektet fetare serbe mbeten në Listën e UNESCO-s të Vendeve të Trashëgimisë Botërore në Rrezik. QK u zotua për ta mbrojtur trashëgiminë kulturore të Kosovës dhe kërkoi që manastiri i Deçanit, Patriarkana e Pejës, Manastiri i Graçanicës dhe Kisha e Virgjëreshës së Shenjtë të Ljeviš/Kisha e Shën Premtës të hiqen nga lista.¹³⁹ Që nga viti 2015, QK duhet të kërkojë anëtarësi në UNESCO.

151. Përkundër pakënaqësisë së QK-së, OJQ-ja Europa Nostra, e cila është e përkushtuar për ruajtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore në Evropë dhe me qendër në Hagë të Holandës, e përfshiu manastirin e Deçanit në listën e shtatë vendeve të trashëgimisë më të rrezikuara në Evropë. Ky njoftim shkaktoi reagime si nga përfaqësuesit e Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë ashtu edhe nga anëtarët e QK-së. Kisha Ortodokse Serbe e mirëpriti vendimin. Duke iu referuar Raportit të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, përfaqësuesit e Kishës i akuzuan autoritetet e Kosovës se po përpiqen ta bëjnë Kosovën "një territor etnikisht të pastër shqiptar".¹⁴⁰ Pavarësisht pretendimeve të QK-së që manastiri nuk i plotëson kushtet për t'u përfshirë në atë listë, manastiri mbetet në Listë ashtu si katër vendet fetare të lartpërmendura në Listën e UNESCO-s të Vendeve të Trashëgimisë Kulturore në Rrezik.

152. Vandalizimi i kishave ortodokse serbe dhe përdhosja e varrezave me piktura dhe grafitë anti-serbe vazhdon të jetë shqetësuese në Kosovë, sipas mediave në gjuhën serbe dhe Ministrisë së Kulturës Serbe.¹⁴¹ Në qershor 2021, u raportua se është përdhosur kisha e Shën Pjetrit dhe Palit në fshatin Brod. Gjendja e dobët e shumë kishave dhe varrezave ortodokse serbe rreth Kosovës janë gjithashtu rezultat i shpopullimit të fshatrave serbe të Kosovës dhe zvogëlimit të numrit të besimtarëve serbë në këtë zonë. Mirëpo kohëve të fundit, u mbajtën protesta shqiptare nga studentët e universitetit në Kosovë pasi u organizua një liturgji kishtarë në Kishën Ortodokse Serbe. Protestat kishin të bënin me një mosmarrëveshje të gjatë midis Kishës Ortodokse Serbe

138 Komisioni Evropian (2021), [Raport Vjetor për Kosovën](#).

139 Këshilli i Sigurimit i OKB-së (2021), [Raport Vjetor për Kosovën](#).

140 Ibid.

141 Shih [Balkan Insight](#) (2021).

dhe universitetit në lidhje me pronësinë e tokës: Kisha është ngritur në kampusin e Universitetit të Prishtinës nën administratën e Slobodan Millosheviqit në mesin e viteve 1990. Kjo u bë pasi autoritetet serbe e hoqën përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe nga universiteti dhe institucioni u emërua Свети Сава (Latin: Sveti Sava) sipas Shenjtorit Kombëtar Serb.

153. Rekomandime:

- QK duhet t'i njohë të drejtat kulturore si parime themelore njerëzore dhe t'i përfshijë në Konventën Ndërkombëtare të të Drejtave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore në Kushtetutë;
- QK duhet ta respektojë plotësisht Ligjin Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve në të gjitha aktivitetet dhe të ofrojë informata për të drejtat kulturore dhe për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore me kohë në gjuhët zyrtare të Kosovës, duke përfshirë uebfaqen e MKRS-së;
- QK duhet të bëjë përpjekje ta depolarizojë çështjen e trashëgimisë kulturore pa diskriminim;
- QK duhet ta miratojë Ligjin për Trashëgiminë Kulturore dhe të sigurojë funksion të vazhdueshëm të zbatimit të tij;
- QK duhet të ofrojë financim të qëndrueshëm afatgjatë për aktivitetet kulturore dhe të ofrojë informata për të drejtat kulturore dhe mbrojtjen e aktiviteteve kulturore përmes ndarjes së buxhetit të mjaftueshëm.

7 PJESA C: TË DREJTAT E PERSONAVE DHE GRUPEVE TË CAKTUARA

7.1 Të drejtat e grave dhe barazia gjinore

154. Korniza ligjore e Kosovës e përcakton barazinë gjinore si të drejtë themelore dhe parim themel. Në nenin 7.2 të Kushtetutës, barazia gjinore njihet "si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore."¹⁴² Përveç njohjes së barazisë gjinore si parim themelore i zhvillimi demokratik, Kushtetuta i thekson marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare. Në veçanti, neni 22.5 thekson që konventat e njohura ndërkombëtarisht kanë prioritet mbi ligjet dhe dispozitat vendore. Kushtetuta i referohet veçanërisht Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (KEGFDG) dhe Konventës së Stambollit.¹⁴³ Edhe pse nuk ceket fjalë për fjalë në Kushtetutë, legjislativi i

¹⁴² Kushtetuta e Kosovës (2008).

¹⁴³ Konventa e Stambollit njihet zyrtarisht si Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Kosovës e njeh Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1325 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë (Rezoluta 1325 e OKB-së).¹⁴⁴ Ligjet dhe rregulloret vendore për barazinë gjinore i reflektojnë parimet dhe legjislacionin ndërkombëtar për barazinë gjinore dhe promovimin e të drejtave të grave. Këtu përfshihet Ligji nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore, Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe Ligji nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. Ngacmimi seksual dhe dhuna në familje janë përfshirë në Kodin Penal të rishikuar të vitit 2020.

155. Mekanizmat institucionalë që e mbrojnë zbatimin e barazisë gjinore si e drejtë kushtetuese në institucionet publike dhe i mbrojnë politikatat që sigurojnë qasje të barabartë të grave në shoqëri dhe në shërbime, janë të rregulluar me ligj. Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ) është organi qeverisës i ngarkuar me monitorimin e zbatimit lokal të politikave publike ndërkombëtare dhe sistemimin e integritimit gjinor në politikatat e QK-së.

156. Një përparim i rëndësishëm drejt integritimit gjinor në politikëbërjen vendore të Kosovës dhe zbatimin e kornizës ligjore është Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024 (PKBGJ).¹⁴⁵ Detyrimi për zhvillimin e PKBGJ-së si një platformë referimi për zhvillimin e veprimeve dhe strategjive institucionale në drejtim të zbatimit të kornizës ligjore është përcaktuar në nenin 11 të Ligjit nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore. Objektivi kryesor i PKBGJ-së është t'i "çojë përpara parimet e barazisë gjinore dhe të arrijë një shoqëri paqësore, të begatë dhe harmonike për gratë dhe burrat në Kosovë".¹⁴⁶ Për ta bërë këtë, PKBGJ i vendos veprimet e saj strategjike në tre shtylla: (1) fuqizimi ekonomik dhe mirëqenia sociale e grave, (2) rolet e zhvillimit njerëzor dhe marrëdhëniet gjinore, dhe (3) të drejtat e grave dhe qasja në drejtësi dhe siguri. Plani strategjik me mjetet dhe treguesit e PKBGJ-së është bërë i qashtëm në Planin e Veprimit për periudhën 2020-2022.

157. Barazia gjinore ka prioritet në proceset integruese të Kosovës në BE. Përveç miratimit të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së (neni 23), barazia gjinore ka qenë fokusi i gjithsej trembëdhjetë direktivave administrative, që i përkasin kryesisht rregulloreve të tregut të punës.¹⁴⁷

158. Pavarësisht bazës së fortë legjislative mbi të cilën barazia gjinore është ngritur dhe njohur në kontekstin e të drejtave universale të njeriut, në Kosovë vazhdojnë mospërputhjet ndërmjet politikës dhe praktikës. Në veçanti, integrimi gjinor dhe buxheti i përgjegjshëm gjinor (BGJP) ende nuk janë institucionalizuar plotësisht.¹⁴⁸ Po aq mospërputhje ka në kornizën zgjedhore vendore e cila bie ndesh me Ligjin nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore. Megjithëse është mandatuar një kuotë për barazi gjinore prej 50 përqind për Kuvendin e Kosovës, legjislacioni zgjedhor ka një standard prej 30 përqind. Sipas Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK), ndërprerjet e tilla të vazhdueshme e pengojnë zhvillimin e një shoqërie vërtet të barabartë në të cilën individëve iu ofrohet qasje e barabartë në mundësi, pavarësisht gjinisë.

144 [Rezoluta 1325](#) e konfirmon ndikimin e luftës në gra dhe vajza dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së plotë të grave në zgjidhjen e konfliktit.

145 Termi integrim gjinor është përcaktuar në Ligjin nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore në nenin 1.16 si: "[...] përfshirja e perspektivës gjinore në çdo fazë të procesit, planifikimit, miratimit të zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të legjislacionit, politikave apo programeve [...] duke marrë parasysh promovimin dhe avancimin e mundësive të barabarta mes burrave dhe grave" (f. 3).

146 [Programi i Kosovës për Barazi Gjinore](#) (2020).

147 Gueye, Elisabeth (2021), Barazia gjinore në Kosovë.

148 Ibid.

159. Duke rezultuar pjesërisht në pabarazitë e përmendura më lart, sfidë mbetet përfaqësimi i barabartë i grave në pozita vendimmarrëse domethënëse në fushën legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore. Raporti i Komisionit Evropian (2021) thotë se "rekrutimi i bazuar në merita" është përdorur në mënyrë konvencionale si një arsye për ta anashkaluar zbatimin e duhur të kuotës së barazisë gjinore.¹⁴⁹ Zgjedhjet e fundit të vitit 2021 treguan një përparim në këtë drejtim me një numër rekord prej 43 vendesh nga 120 (36 përqind) në Kuvendin e Kosovës, të fituara nga gratë pas zgjedhjeve të parakohshme të shkurtit 2021. Edhe pse këto ngjarje sinjalizuan përparim pozitiv drejt barazisë gjinore, Instituti Kombëtar Demokratik (IKD) ka tërhequr vëmendjen për përjetësimin e kulturave të dominuara nga meshkujt në strukturat politike duke deklaruar se strukturat partiake të dominuara nga meshkujt i dekurajojnë gratë nga ndjekja e roleve udhëheqëse, një gjë që u bë e dukshme në zgjedhjet e fundit komunale, në të cilat asnjë politikane nuk u zgjodh kryetare e komunës.¹⁵⁰

160. Ndërprerjet ndërmjet politikës dhe praktikës janë reflektuar edhe në përfaqësimin e pamjaftueshëm të grave në agjendat e paqes dhe sigurisë. Sipas Rezolutës 1325, proceset e sigurisë dhe të ndërtimit të paqes në Kosovë kërkojnë përfshirjen e grave në ekipet e bisedimeve gjatë dialogut ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Megjithatë, qeveria ende nuk e ka njohur rëndësinë e përfshirjes së grave në tryezën e negociatave.¹⁵¹

161. Përveç kufizimeve të vendosura ndaj grave në strukturat qeveritare nga lart-poshtë, diskriminimi me bazë gjinore vazhdon edhe në sferat socio-ekonomike të shoqërisë. Siç është theksuar nga Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK), Kosova ka shkallën më të ulët të pjesëmarrjes së grave në punë në rajonin e Ballkanit. Kjo i atribuohet një sërë faktorësh duke përfshirë pagat e ulëta, qasjen e kufizuar në kujdesin ndaj fëmijëve, rregulloret e punës dhe qëndrueshmërinë e normave shoqërore patriarkale. Grave iu ofrohen më shpesh kontrata afatshkurtra si një mënyrë për t'i shmangur ligjet dhe rregulloret e punës që lidhen me pushimin e lehonisë.¹⁵² Inspektimi joadekuat i shkeljeve mundëson vazhdimin e diskriminimit me bazë gjinore. Tabela 1 paraqet shkallën e papunësisë sipas gjinisë numerikisht dhe në përqindje, sipas të dhënave më të fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK).¹⁵³ Siç tregojnë të dhënat, gratë mbesin të nënperfaqësuar në tregun e punës me një normë të papunësisë prej 32.2 për qind krahasuar me normat e papunësisë tek meshkujt që ishin 23.5 për qind në vitin 2021.

149 Komisioni Evropian (2021), [Raporti Vjetor për Kosovën](#)

150 KDI (2021), [Kosovo Vibrant Democracy: Closing the deficit in women's full participation](#).

151 Rrjeti i Grave të Kosovës (2021), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2021.

152 Rrjeti i Grave të Kosovës, (2019), [Diskriminimi me baza gjinore dhe puna në Kosovë](#).

153 [Agjencia e Statistikave të Kosovës](#) (2021).

Tabela 2: Shkalla e papunësisë në Kosovë sipas gjinisë mes moshave 15-64 (2021)

2020	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Papunësia ('000)	80.173	41.206	121.379
Shkalla e papunësisë (përqindja)	23.5	32.3	25.9

162. Pjesëmarrja e grave tregon progres të dukshëm në sektorin e kujdesit shëndetësor dhe të arsimit të lartë. Në institucionet shëndetësore janë të punësuara më shumë gra se burra.¹⁵⁴ Më tej, të dhënat aktuale statistikore të vitit 2021 tregojnë se më shumë gra se burra janë të angazhuara si personel akademik dhe administrativ në universitetet publike.¹⁵⁵ Lidhur me këtë, raporte të tjera kanë treguar se femrat ua kalojnë meshkujve në nivelin e arsimit universitar. Nga ana tjetër, kjo nuk vlen për arsimin fillor dhe të mesëm në zonat rurale, ku shkalla e braktisjes së shkollës për vajzat mbetet më e lartë se ajo e djemve.¹⁵⁶

163. Pavarësisht zhvillimeve pozitive me Politikën kundër Ngacimit Seksual në Administratën Publike të nxjerrë në vitin 2020, ngacimi seksual brenda dhe jashtë mjediseve të vendit të punës mbetet një çështje që nuk raportohet sa duhet. Sipas hulumtimit të kryer nga RRGK dhe OSBE, vetëm dy (2) për qind e incidenteve të ngacimit seksual raportohen.¹⁵⁷ Në mjedisin e punës, RrGGK deklaroi se vetëm katër (4) për qind e incidenteve të ngacimeve seksuale raportohen tek autoritetet.¹⁵⁸ Për më tepër, përfaqësuesit e Inspektoratit të Punës dhe Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas më vonë kanë vërejtur dështimin e Inspektoratit të Punës dhe institucioneve të tjera për ta shfrytëzuar Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjatë periudhës raportuese.¹⁵⁹

164. Politika aktuale i adreson vetëm pjesërisht nevojat e grave nga komunitetet joshumicë. Qendra për Veprim Social Afirmativ (CASA) raporton se gratë nga komunitetet pakicë janë të përjashtuara nga përfaqësimi i duhur në PKBGJ dhe në planin e veprimit shoqëruar të tij. Nuk ka mekanizma adekuat pjesëmarrës për kontributin e konsiderueshëm të palëve të interesuara nga komunitetet joshumicë. Ngjashëm, raporti i vitit 2021 i Qendrës Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ) dhe raporti i IKD-së për vitin 2021 e konfirmojnë në mënyrë të pavarur shkëputjen mes qeverisë dhe çështjeve gjinore që kanë të bëjnë me gratë nga komunitetet joshumicë.

165. Shkalla e papunësisë së grave nga komunitetet jo-shumicë është jashtëzakonisht e lartë sipas

154 Guye, Elisabeth (2021), Barazia gjinore në Kosovë

155 Agjencia e Statistikave të Kosovës (2021), [numri i stafit akademik dhe administrativ sipas gjinisë](#).

156 Ibid.

157 [Zëri i Amerikës](#) (2021).

158 RRGK e cituar në Akademi Pune (2021), A po rritet vetëdijësimi i raportimit të ngacimeve seksuale në vendet e punës në Kosovë?.

159 [Takimi i Komisionit të KK për Të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Vikatimat e Dhunës Seksuale gjatë Luftës, Personat e Zhdukur dhe Peticione](#) (2021).

një studim të fundit të QKSGJ-së të vitit 2021 mbi gjendjen ekonomike të grave romë, ashkali dhe egjiptiane. Normat patriarkale, mungesa e kujdesit ndaj fëmijëve dhe diskriminimi etnik përmenden si arsye për shkallën e lartë të papunësisë së këtyre grupeve jo-shumicë.¹⁶⁰ Mungesa e mekanizmave institucionalë për adresimin e nevojave të komuniteteve rom-K, ashkali-K dhe egjiptian-K kontribuon në marginalizimin socio-ekonomik të grave me këtë përkatësi.¹⁶¹

166. Një studim i fundit i vitit 2021 nga QKGS mbi perceptimet dhe qëndrimet e popullatës së përgjithshme lidhur me të drejtat e grave në Kosovë tregon zhvillime pozitive me qëndrime më pak të njëanshme gjinore ndaj pjesëmarrjes së burrave dhe grave në jetën publike dhe në dinamikën e familjeve të tyre. Pavarësisht progresit të shënuar, studimi vë në pah hezitimin e segmenteve të caktuara të popullsisë për të ndihmuar në luftimin e diskriminimit me bazë gjinore kur ai përfshin gratë emigrante, komunitetet LGBTIQ+ dhe individët me prejardhje romë-K, ashkali-K dhe egjiptian-K.

167. Reagimi institucional ndaj dhunës me bazë gjinore dhe abuzimit në familje, deri më tani, është përqendruar në legjislacion. Siç u përmend më lart, Kushtetuta dhe Kodi Penal e kanë pasqyruar Konventën e Stambollit në legjislacionin për dhunën në familje dhe ngacmimin seksual duke i bërë ato vepra penale.¹⁶³ Ministria e Drejtësisë është në proces të hartimit të Strategjisë së re për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Planit të Veprimit (2022-2026). Në praktikë, vetëm disa ndërhyrje politike i trajtojnë format e dhunës me bazë gjinore jashtë dhunës në familje.

168. Në prill 2021, u publikuan udhëzime të reja cilësore për strehimoret për të mbijetuarat e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Si pjesë e projektit të financuar nga BE "Përforcimi i luftës kundër dhunës ndaj grave", fokusi kryesor ka qenë në trajnimin e punonjësve socialë lokalë dhe profesionistëve ligjorë për ta luftuar dhunën dhe për t'i mbështetur të mbijetuarit. Në tërë Kosovën ekzistojnë vetëm tetë (8) strehimore të drejtuara nga OJQ-të. Mesatarisht, në kryeqytetin e Prishtinës, rreth 120-140 gra, vajza dhe fëmijë janë të strehuar në strehimoret e grave si rezultat i dhunës në familje me bazë gjinore.¹⁶⁴ Financimi i këtyre strehimoreve është posaqërisht problematik pasi që ato financohen institucionalisht vetëm pjesërisht nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ndërsa pothuajse 50 përqind e financave janë plotësisht nga donatorët.

169. Në dhjetor të vitit 2021, u publikua udhëzuesi për ndërhyrje policore për rastet e dhunës ndaj grave. Udhëzuesi "ofron udhëzime praktike për policinë, duke iu mundësuar reagime efektive dhe duke i pasur parasysh aspektet gjinore të rasteve të dhunës ndaj grave dhe vajzave".¹⁶⁵

170. Policia e Kosovës raportoi gjithsej 2,200 raste të reja të dhunës në familje në Kosovë në vitin 2021.¹⁶⁶ Duhet të theksohet që sipas RrGK-së, Policia e Kosovës nuk ka arritur të marrë deklarata nga

160 Qendra Kosovare për Studime Gjinore (2021), [Situata ekonomike e grave romë, ashkali dhe egjiptiane](#).

161 IKD (2021), [Kosovo Vibrant Democracy: Closing the deficit in women's full participation](#).

162 QKSGJ (2021), [Perceptimet e Publikut për barazinë gjinore dhe dhunën me baza gjinore në Kosovë](#).

163 Për një pasqyrë të plotë të ndryshimeve të bëra në kodin penal, shih RRGK (2019), [Kodi Penal i Kosovës e Penalizon Dhunën në Familje, Ngacmimin Seksual](#).

164 Deutsche Welle (DW, 2021), [Kosove: Strehimoret e grave si vend strehimi](#).

165 Tuzi-Nushi, V. (2021, përkthimi ynë nga gjuha shqipe), Lansimi i ["Doracakut mbi shërbimet policore me ndjeshmëri gjinore për rastet kur vajzat dhe gratë i nënshtrohen dhunës"](#).

166 Klan Kosova (2022), [Më 2021 policia intervenoi në 2200 raste dhune në familje](#).

të mbijetuarat e dhunës në familje. Siç shihet në Tabelën 2, kjo shënon një rritje në rastet e raportuara në krahasim me vitin 2019 dhe 2020. Kjo jodomosdoshmërisht mund të jetë rezultat i dhunës së shtuar në familje në tërësi gjatë vitit 2021. Duke iu referuar raportit të përmendur më herët, numri i shtuar mund të jetë për shkak të rritjes së vetëdijësimit të popullsisë për atë se çfarë është dhuna në familje dhe si mund të raportohet.

Tabela 3: Rastet e dhunës në familje mes vitit 2019 dhe 2021

Viti	2019	2020	2021
Rastet e dhunës në familje në numra	1,915	2,069	2,200

171. Gjykatat vazhduan të jepnin dënime të ulëta në rastet e dhunës me bazë gjinore, ndërkohë që disa gjyqtarë ende inkurajonin pajtimin familjar dhe fajësonin viktimat për krimet e kryera ndaj tyre. Në shtator të vitit 2021, krahasuar me vitin 2020, gjykatat vazhduan me dënime jashtëzakonisht të ulëta për autorët e dhunës në familje. Sistemi gjyqësor shpesh nuk arrin të sigurojë mbrojtjen e duhur për viktimat e abuzimit në familje, pasi që autorët e veprave shpesh ikin nga sistemi i drejtësisë ose dënimet e dhëna nuk janë në përputhje me krimet e kryera. Një shembull ilustrues ishte aktgjykimi i Ilir Haxhiajt në Gjykatën Themelore të Prizrenit në shkurt të vitit 2022. Haxhiaj u dënua me 15 vjet burg pasi kishte rrahur gruan e tij, e cila më vonë vdiq nga plagët e marra.¹⁶⁷ Sipas Rrjetit të Grave të Kosovës, vonesat në sistemin e drejtësisë mbesin shqetësuese kur është fjala për dhunën me bazë gjinore.¹⁶⁸

172. Protesta në shkallë të gjerë të organizuara nga disa OSHC gjatë periudhës së raportimit në fund të gushtit shpërthyen në qytetin e Ferizajit dhe të Prishtinës pas rastit të vrasjes së një gruaje. Në veçanti, sistemi gjyqësor i Kosovës u kritikua pasi që i dyshuari mashkull nuk u mbajt në paraburgim.¹⁶⁹

173. Ndikimi i COVID-19 tek gratë në periudhën e raportimit ndoqi forma globale pasi që pati një rënie prej 65 përqind në orarin e punës me pagesë.¹⁷⁰ Sipas UNT, gratë më shumë se burrat kaluan më shumë kohë se para krizës shëndetësore duke përgatitur ushqim dhe duke pastruar.¹⁷¹ Ndërkohë që shifrat e sakta nuk janë të besueshme, ndikimi socio-ekonomik ishte më i lartë në mesin e komuniteteve rom-K, ashkali-K dhe egjiptian-K.

167 [Kallxo](#) (2021).

168 Raport i Rrjetit të Grave të Kosovës "Nga ligji në veprim", <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2021/05/KWN-GBV-Report-ENG-Final-2.pdf>.

169 Këshilli i Sigurisë i OKB-së (2021), [Raporti Vjetor për Kosovën](#).

170 Picciano, N. (2021), [Kosovo: Covid-19 and socio-economic impacts on women](#).

171 Ibid.

174. Rekomandime:

- QK duhet ta intensifikojë bashkëpunimin e Ministrisë së Drejtësisë dhe Zyrës së Koordinatorit kundër Dhunës në Familje me institucionet tjera relevante për t'i forcuar përpjekjet drejt zbatimit të ligjeve përkatëse;
- QK duhet ta krijojë një linjë të përhershme buxhetore që do të siguronte financim të qëndrueshëm për strehimoret për të mbijetuarat e dhunës në familje;
- KGJK duhet të ofrojë trajnime për barazi gjinore për gjykatësit, prokurorët dhe Policinë e Kosovës, veçanërisht në lidhje me dispozitat e Kodit Penal të rishikuar për ngacmimin seksual, dhunën në familje dhe detyrimet e reja të institucioneve publike me zbatimin e Konventës së Stambollit;
- QK duhet ta shtojë numrin e fushatave dhe vetëdijësimin për dhunën në familje;
- QK duhet ta krijojë një grup ekspertësh që e rishikon qasjen ekzistuese strategjike të QK-së në luftimin e diskriminimit gjinor dhe të identifikojë shtrirjen praktike dhe substanciale të reagimit institucional ndaj komuniteteve joshumicë në Kosovë.

7.2 Të drejtat e fëmijëve

175. Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (KDF), e cila i përcakton fëmijët si persona nën moshën 18 vjeçare, është drejtpërdrejt e zbatueshme në Kosovë sipas nenit 22 të Kushtetutës dhe i zëvendëson ligjet dhe aktet vendore të qeverisë. Ky dokument përcakton të drejtat e fëmijëve brenda gjashtë traktateve themelore të të drejtave të njeriut.¹⁷² Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve si shtyllë themelore e zhvillimit demokratik të Kosovës është e përcaktuar me Kushtetutë në nenin 50 (nga paragrafët 50.1-50.5). Kushtetuta e vë theksin në mirëqenien, barazinë dhe mbrojtjen e fëmijëve nga keqtrajtimi, dhuna dhe çdo formë e shfrytëzimit. Në përputhje me standardet ndërkombëtare, legjislacioni primar është plotësuar së fundmi me Ligjin nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës. Sipas një raporti të fundit të UNICEF-it të vitit 2021, ligji, i cili hyri në fuqi në vitin 2020, shënoi një "arritje historike" në kornizën ligjore të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.¹⁷³ Ai i mbron fëmijët nga format e ndryshme të keqtrajtimit fizik, mendor dhe emocional; neglizhimin; dhe shfrytëzimit në të gjitha sferat shoqërore që nga institucionet e përkujdesit e deri tek institucionet publike dhe shtëpia. Poashtu, në nenin 42.2 (Shëndeti), vizitat e rregullta në shtëpi për gratë shtatzëna dhe fëmijët deri në moshën tre vjeçare janë obligative si pjesë e shërbimeve të kujdesit themelor shëndetësor.

176. Mekanizmat institucionalë që e garantojnë zbatimin e legjislacionit janë të përcaktuar me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës. Ato përfshijnë Komitetin Ndërministror për të Drejtat e Fëmijëve, i

172 Zyra e Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut. [Konventa për të Drejtat e Fëmijës, 1990.](#)

173 UNICEF (2021), [Gjendja e të drejtave të fëmijëve në Kosovë.](#)

cili funksionon në kuadër të QK-së dhe Zyrës së Kryeministrit përmes ZQM-së. Instrument për sigurimin e zbatimit efektiv të mekanizmave për mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë është Strategjia për të Drejtat e Fëmijës (2019-2023).¹⁷⁴ ZQM-ja luan rol udhëheqës në proceset që lidhen me hartimin dhe zbatimin e Strategjisë. Në bashkëpunim të ngushtë me UNICEF-in, dokumenti parashtron katër objektiva strategjike që kanë si synim kryesor “[...] ndërmarrjen e nismave që e përmirësojnë situatën e fëmijëve në kontekstin ekonomik, social dhe politik në Kosovë.”¹⁷⁵ Fokusi kryesor është instrumentalizimi i kornizës ligjore. Prandaj, strategjia katërvjeçare ka në qendër përmirësimin e strukturave gjyqësore për mirëqenien e fëmijëve. Ajo fokusohet edhe në fuqizimin e fëmijëve në proceset vendimmarrëse dhe përfshirjen e fëmijëve në programet e zhvillimit të hershëm. Po ashtu, në Strategji përshkruhet hollësisht ofrimi i shërbimeve që kontribuojnë në shëndetin dhe mirëqenien e përgjithshme të fëmijëve.

177. Kontekstet legjislativ dhe institucionale në të cilat kuptohet mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në Kosovë janë të pandashme nga ndryshimet në klimën politike. Sipas OJQ KOMF, përmirësimi i legjislacionit që ka të bëjë me të drejtat e fëmijëve është shtyrë për shkak të riorganizimeve strukturore të qeverisë së re.¹⁷⁶ Në përputhje me Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën në vitin 2021, ndërprerjet vazhdojnë mes legjislacionit dhe zbatimit efektiv të tij nga sundimi i ligjit, duke çuar në masa të pamjaftueshme mbrojtëse për grupet në situata të cenueshme.

178. Udhëzimi Administrativ (UA) QRK-NR.01/2021 për Mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve si kryes të veprave penale nën moshën e përgjegjësisë penale u finalizua dhe u publikua në Gazetën Zyrtare të Kosovës më 22 janar 2021. Ai hyri në fuqi shtatë ditë pas nënshkrimit nga Kryeministri i Kosovës dhe e përcakton programin e mbrojtjes; ndërmjetësimin nga bashkëmoshatarët; ndihmën juridike; dhe trajtimin.¹⁷⁷

179. Udhëzimi Administrativ (UA) QRK-Nr.02/2021 për Zbatimin e Drejtësisë Mike ndaj Fëmijës në Procedurat Penale, Civile dhe Administrative u finalizua dhe u publikua në Gazetën Zyrtare më 22 janar 2021. Ai hyri në fuqi gjashtë muaj pas nënshkrimit nga Kryeministri i Kosovës dhe i përcakton rregullat e drejtësisë mike ndaj fëmijës, pasi që ato kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijës në procedurat penale, civile dhe administrative, bazuar në Udhëzimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për drejtësi mike ndaj fëmijëve e miratuar më 17 nëntor 2010.¹⁷⁸

180. Projektligji i Kodit Civil ka përfshirë një sërë nenesh të propozuara nga KOMF, OSHC-të e lidhura me të dhe UNICEF-i, të cilat konsiderohen vendimtare për përmirësimin e mbrojtjes së fëmijëve pa kujdes prindëror. Propozimet e ratifikuara kanë të bëjnë me mbështetjen e zgjeruar institucionale dhe financiare për fëmijët që e kanë arritur moshën madhore në kujdestari. Një propozim shtesë kishte të bënte me kufizimin e afateve ekzistuese në procedurat e adoptimit në Kosovë në rastet kur fëmija është braktisur dhe/ose kur nuk dihet vendndodhja e prindit.¹⁷⁹

174 [Strategjia Kombëtare për të Drejtat e Fëmijës 2019-2023.](#)

175 Ibid., p. 11.

176 Ato i referohen shpërbërjes së Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe bashkimit të saj me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, gjë që zgjati proceset e miratimit të projektligjeve të reja për Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe për Financat e Pushtetit Lokal.

177 Terres des Hommes (2022), të dhëna për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi Të Drejtat e Njeriut për vitin 2021.

178 Ibid.

179 KOMF (2022), [Propozimet për mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror miratohen në Projekt Kodin Civil.](#)

181. Trafikimi i fëmijëve mbetet shqetësim serioz.¹⁸⁰ Të dhënat tregojnë se përqindja e fëmijëve të identifikuar si viktime të trafikimit është rritur me kalimin e viteve. Në vitin 2021, autoritetet e Kosovës identifikuan 21 viktime të trafikimit, nga të cilat 18 janë fëmijë. Komunitetet etnikisht të marginalizuara dhe vajzat e reja janë veçanërisht të cenueshme ndaj trafikimit. Gati 90 për qind e viktimitave të identifikuar janë vajza të reja që shfrytëzohen për prostitucion.

182. Qendrat për Mirëqenie Sociale (QPS) në mbarë Kosovën përballen me një sërë sfidash. Kjo vlen veçanërisht për burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare që mund t'i adresojnë nevojat sociale të fëmijëve në situata të cenueshme. Në këtë aspekt, shërbimet sociale nuk kanë qenë prioritet i pushtetit në vend. Përveç kësaj, QPS-ve iu mungon personeli profesional i specializuar në fushën e mbrojtjes së fëmijëve. Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (neni 15) përcakton se çdo QPS do ta caktojë së paku një zyrtar përgjegjës dhe të specializuar për t'i koordinuar masat dhe ndërhyrjet për mbrojtjen e fëmijëve, edhe pse në praktikë vetëm katër QPS e kanë emëruar një punonjës të specializuar për mbrojtjen e fëmijëve me mbështetjen e OJQ-ve.

183. Numri i fëmijëve që jetojnë në varfëri në Kosovë mbetet alarmues. Sipas raportimeve të KOMF-it, 22.8 përqind e fëmijëve në Kosovë jetojnë në varfëri, 22.8 përqind e fëmijëve në Kosovë jetojnë në varfëri, 7.2 përqind e tyre në kushte të varfërisë ekstreme.¹⁸¹ Ligji nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë përmban një sërë kriteresh diskriminuese që e përjashtojnë një numër të konsiderueshëm fëmijësh dhe familjesh nga skema e ndihmës sociale. Një zhvillim pozitiv ka qenë miratimi i përfitimeve të fëmijëve si një instrument efektiv për zbutjen e varfërisë dhe pabarazisë mes fëmijëve. Megjithatë, shumica e ulët është e kufizuar për fëmijët deri në 16 vjeç, duke përjashtuar kështu fëmijët nga moshën 16 deri në 18 vjeç.

184. Dhuna si mjet disiplinimi mbetet një fenomen i ngulitur në normat socio-kulturore të Kosovës përkundër Ligjit 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës i cili shërben për mbrojtjen e fëmijëve nga çdo formë e dhunës fizike, emocionale dhe psikologjike. Statistikat e ofruara nga KOMF tregojnë se 72 për qind e fëmijëve të moshës 1-14 vjeçare kanë përjetuar dhunë si mjet disiplinimi. Në vitin 2021, veprimet e ndërmarra nga OSHC-të për ta rritur ndërgjegjësimin e publikut kundër formave të disiplinimit fizike rezultuan në një fushatë sensibilizimi dyjavore të titulluar "dhuna nuk ka justifikim".¹⁸² Fokusi i fushatës ishte ndryshimi i qëndrimeve normative në lidhje me format fizike të disiplinimit të një fëmije. Në qendrat e shtatë qyteteve më të mëdha të Kosovës u vendosën pankarta ku shkruhej "dhuna nuk është disiplinë", "Asgjë më shumë dhe asgjë më pak se siguri" dhe "Prindërit duhet të më mbrojnë, e jo të më rrahin".¹⁸³

185. Përveç dhunës fizike, shfrytëzimi i fëmijëve përmes punës së fëmijëve dhe lypjes ka ndodhur pa pengesa në vitin 2021. KOMF raporton se 5 për qind e fëmijëve në Kosovë janë të angazhuar në

180 Ibid.

181 Përkufizimi i varfërisë ekstreme në këtë raport korrespondon me përkufizimin e Kombeve të Bashkuara për termin, si "një gjendje e karakterizuar nga privimi i rëndë i nevojave themelore njerëzore, duke përfshirë ushqimin, ujin e pijshëm të sigurt, objektet sanitare, shëndetin, strehimin dhe informacionin. Kjo varet jo vetëm nga të ardhurat, por edhe nga qasja në shërbime" (OKB 1995, Raporti i samitit botëror për zhvillimin social).

182 Fushata u mbajt në pesë komuna të Kosovës dhe u organizua nga OSHC Syri i Vizionit në bashkëpunim me Save the Children.

183 [Kallxo](#) (2021)

punë të kryer nga fëmijët, pjesërisht për shkak të kushteve të këqija ekonomike dhe sociale të segmenteve të popullsisë. Policia e Kosovës konfirmoi vazhdimin (dhe rritjen e lehtë) të fëmijëve lypës krahasuar me vitin 2020 (shih tabelën 3). Në këtë drejtim, KOMF thekson rëndësinë e veprim-it të qeverisë për ta luftuar shfrytëzimin e fëmijëve në formën e lypjes. Situata e fëmijëve në rrugë nuk është përmirësuar shumë. Sipas OSHC-së Terres des Hommes, fëmijët detyrohen të lypin në rrugë, ndërsa veprimi institucional për ta adresuar këtë çështje është vetëm ad-hoc pa një zgjidhje konkrete afatgjatë.

186. Fëmijët nga komunitetet joshumicë përbëjnë fëmijët në pozitën më të cenueshme në aspektin social, ekonomik dhe kulturor. Problem mbeten fëmijët lypës, veçanërisht në mesin e komuniteteve rom-K dhe ashkali-K. Autoritetet kanë lëvizur në mënyrë të pamjaftueshme përtej përcaktimeve legjislative drejt veprimeve dhe programeve sociale.

187. Përkundër masave parandaluese dhe fushatave për ngritjen e vetëdijes kundër martesave të hershme, martesat e fëmijëve dhe martesat e hershme të detyruara mbeten poashtu të spikatura në komunitetet rom dhe ashkali. Sipas OSHC-së BSFK, një nga faktorët që e rrit numrin e martesave të hershme janë kushtet e këqija ekonomike. Për shkak se këto martesa shpesh mbeten të paraportuara në Qendrat për Punë Sociale, kjo praktikë vazhdon e papenguar. Për më tepër, mekanizmat e mbrojtjes së fëmijëve nuk funksionojnë efektivisht në parandalimin e fenomenit. Nga njëra anë, hezitimi i Policisë dhe prokurorëve të Kosovës për ta zbatuar ligjin i atribuohet normave tradicionale kulturore të këtyre komuniteteve. Nga ana tjetër, prindërit, shkollat dhe Qendrat për Punë Sociale nuk kanë koordinim të mjaftueshëm për parandalimin e këtij fenomeni. Nga viti 2019 deri në 2021, OSHC RROGRAEK organizoi një fushatë të titulluar "derë më derë" përmes së cilës u organizuan diskutime me familjet për martesat e hershme.¹⁸⁴ BSFK-ja thekson se përkundër hapave të ndërmarrë për përfshirjen e fëmijëve në arsim, 1 në 4 vajza nga komunitetet rom-K, ashkali-K dhe egjiptian-K janë analfabete. Ata shprehen se kjo situatë e rritë ndjeshëm rrezikun e varfërisë së fëmijëve dhe për rrjedhojë i detyron ata të fillojnë të punojnë. Rreth 17 përqind e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë janë të angazhuar në punë. Rreth 12 për qind e vajzave martohen para moshës 15 vjeçare dhe 43 për qind para moshës 18 vjeçare. Bazuar në këto të dhëna si dhe në sfidat me të cilat përballen fëmijët e këtij komuniteti, një vëmendje e veçantë duhet kushtuar përmirësimit të situatës së këtyre fëmijëve dhe rritjes së mundësive për përfshirjen e tyre. Situata në të cilën gjenden fëmijët nga komunitetet rom-K, ashkali-K dhe egjiptian-K është e lidhur ngushtë me varfërinë e këtyre komuniteteve.¹⁸⁵

188. Kosova nuk bën strehimin e fëmijëve në institucione të mëdha rezidenciale. Në vend të kësaj, janë zhvilluar zgjidhje alternative të kujdesit për fëmijët e privuar nga kujdesi prindëror. Mirëpo, kujdestaria për fëmijët pa përkujdesje prindërore nuk ofrohet në të gjitha komunat e Kosovës pasi që nuk i plotësojnë kërkesat.

189. Pandemia e COVID-19 pati një ndikim në komunitetet në situata të cenueshme, veçanërisht në lidhje me fëmijët dhe arsimin. Vlerësohet se gjithsej 9,070 (ose 2.8 për qind) fëmijë nuk janë përfshirë në mësimin në distancë të organizuar gjatë periudhës mars-qershor 2020, gjatë pandemisë, për shkak të mungesës së qasjes në mjete dhe pajisje mësimore.¹⁸⁶ Kjo ka rezultuar në një

184 RROGRAEK (2022), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2021.

185 BSFK (2022), të dhëna për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2021.

186 Komisioni Evropian (2021), [Raporti Vjetor i Progresit](#).

rënie të përgjithshme të rezultateve shkollore të fëmijëve dhe rritje të numrit të braktisjes së shkollës nga fëmijët e komuniteteve jo-shumicë, në veçanti romët, ashkallitë dhe egjiptianët. Tre vite pas miratimit të Udhëzimit Administrativ Nr.19/2018 për Themelimin dhe Funkcionimin e Qendrave Arsimore, MASHTI dhe MFPT ende nuk kanë gjetur zgjidhje afatgjate dhe të qëndrueshme për financimin dhe menaxhimin e qendrave arsimore. Kjo ka krijuar një barrë të shtuar për autoritetet komunale të cilat, varësisht nga vullneti politik, i udhëheqin qendrat e lartpërmendura pa bazë të qartë ligjore dhe me rrezik të mbylljes për shkak të mungesës së financimit të qëndrueshëm.¹⁸⁷ Pandemia e ka rritur edhe numrin e rasteve në nevojë për shërbime sociale. Shërbimet e ofruara nga institucionet dhe OJQ-të për fëmijët nuk janë zgjeruar deri në kapacitetet e tyre të plota. Poashtu, agjencitë shtetërore të nivelit qendror dhe komunal janë përqendruar pothuajse krejtësisht në menaxhimin e pandemisë së COVID-19, shpesh duke e injoruar ofrimin e shërbimeve sociale.

190. Rekomandime

- QK duhet ta miratojë një strategji konkrete dhe një plan të veprimit për mbrojtjen e fëmijëve nga varfëria dhe situatat e dhunës në familje dhe abuzimit;
- QK duhet ta miratojë Strategjinë e re për përfshirjen e komuniteteve rom-K dhe ashkali-K në shoqërinë e Kosovës dhe Planin e saj të Veprimit;
- QK duhet ta miratojë Strategjinë e re për Parandalimin dhe Luftimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe Planin e saj të Veprimit;
- Duhet të zbatohet Ligji i ri për Mbrojtjen e Fëmijës, i cili i mbron fëmijët nga të gjitha format e dhunës fizike dhe mendore. Duhet të miratohen tetëmbëdhjetë pjesë të legjislacionit të zbatueshëm;¹⁸⁸
- Meqenëse masat parandaluese dhe fushatat kundër martesave të hershme në mesin e komuniteteve rom dhe ashkali nuk sollën ndryshime të mjaftueshme, QK duhet të hartojë dhe ta ndryshojë legjislacionin ekzistues për të ofruar mbështetje financiare për viktimat e martesave të hershme, veçanërisht për ato me fëmijë;
- QK dhe Komunitat duhet t'i shqyrtojnë mundësitë për ta rritur numrin e punëtorëve socialë brenda Qendrave për Punë Sociale në mënyrë që të mund t'i trajtojnë me efektivitet rastet brenda mandatit të tyre;
- QK duhet t'i ndjekë trendet e praktikave më të mira nëpër botë për përshtatjen e sistemit arsimor në përputhje me nevojat e studentëve në Kosovë dhe situatën ekonomike, duke përfshirë ligjëratat në mënyrë elektronike;

187 Terres des Hommes (2022), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2021.
188 Komisioni Evropian (2021), [Raporti Vjetor i Progresit](#).

- QK duhet të zhvillojë plane strategjike ndërministrorë për ta kapërcyer hendekun mes arsimit dhe tregut të punës në Kosovë për ta bërë arsimin më të orientuar drejt nevojave të tregut të punës, duke përfshirë këtu edhe ofrimin e më shumë mundësive për përvojë praktike të paguar për studentët në fushat e tyre të studimeve;
- QK duhet t'i shqyrtojë mundësitë e ofrimit të fondeve të mjaftueshme dhe afatgjata për OJQ-të e licencuara që ofrojnë shërbime të specializuara për fëmijët në situata të cenueshme;
- Autoritetet duhet ta rrisin mbështetjen financiare për t'i rritur shërbimet sociale dhe shëndetësore të bazuara në komunitet për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe t'i rrisin përpjekjet për t'i integruar ata në mënyrë efektive në institucionet arsimore.

7.3 Të drejtat e të rinjve

191. Korniza ligjore e Kosovës i përkufizon “të rinjtë” në Ligjin nr. 03/L-145 për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e Rinisë (neni 3 1.1) si “grupmosha e të rinjve mes pesëmbëdhjetë (15) dhe njëzet e katër (24) vjeç”.¹⁸⁹ Kjo kategori përbën një segment të madh të përbërjes demografike pasi që 35 përqind e popullsisë së përgjithshme të Kosovës është mes 15 dhe 24 vjeçare. Për këtë arsye, Ligji nr. 03/L-145 luan rol kyç për të siguruar “[...] pjesëmarrjen e vazhdueshme të të rinjve [...] në zhvillimin e një shoqërie demokratike”.¹⁹⁰

192. Mekanizmat institucionalë të ngarkuar me detyrën e zhvillimit të politikave dhe programeve për të rinjtë bëjnë pjesë në Departamentin për të Rinjtë në Ministrinë e Rinisë, Kulturës dhe Arsimit. Përderisa Ligji e parasheh edhe organizimin vullnetar të një Këshilli Qendror të Veprimit Rinor (KQVR), asnjë këshill i tillë nuk ka funksionuar nga viti 2018. Institucionet qendrore dhe komunale janë të caktuara edhe me përgjegjësi themelore për fuqizimin e sektorit të rinisë në Kosovë duke i mbikëqyrur Programet për të Rinjtë dhe Qendrat Rinore. Portali i Kosovës raporton gjithsej 150 organizata rinore të ndara në 100 rrjete dhe 50 qendra. Megjithatë, IKD thekson që ka mungesë të konsiderueshme të Planeve dhe strategjive Vendore për të Rinj për fuqizimin dhe pozicionimin e KVRL-ve.¹⁹¹

193. Strategjia për Rininë 2019-2023 në përputhje me Ligjin nr. 03/L-145 për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e Rinisë përbën bazën themelore për rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset e vendimmarrjes, në jetën publike, pjesëmarrjen në arsimin joformal, në punësim, arsim, në promovimin e shëndetësisë, në kulturë, sport dhe rekreacion.¹⁹² Kështu, strategjia poashtu “synon ta promovojë bashkëpunimin mes organizatave rinore aktivitetet e të cilave kanë të bëjnë me rininë, si dhe mes organeve qendrore e komunale për fuqizimin e politikave dhe programeve për të rinjtë”.¹⁹³ Përkundër kësaj strategjie, përfshirja e të rinjve në proceset qeveritare të vendimmarrjes mbesin të kufizuara me mundësinë për të votuar në zgjedhjet e fundit të përgjithshme dhe lokale të vitit 2021.

189 [Law No. 03/L-145](#).

190 Ibid.

191 IKD Kosovë (2021), [Youth Conference: Speak Youth to Power](#).

192 MKRS, ‘Strategjia për Rininë 2019 – 2023’ (maj 2019), f.10.

193 [Departamenti për Rini, Ministria e Rinisë, Kulturës dhe Sportit](#) (2022).

194. Në gusht të vitit 2021 u themelua Komisioni Shtetëror për Rininë. I përbërë nga 8 ministri të qeverisë, qëllimi i tij kryesor është ta rrisë bashkëpunimin ndërinstitucional, të hartojë politika horizontale për fuqizimin e rinisë dhe ta rishikojë legjislacionin aktual. KSHR është përgjegjës edhe për hartimin e Strategjisë së re për Rininë. Gjatë takimit të parë të KSHR-së në shtator 2021, Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e theksoi rolin qenësor të KSHR-së në përpjekjet e qeverisë për ta zbatuar “strategjinë e re dhe transformuese për rininë”.¹⁹⁴

195. Papunësia në mesin e të rinjve mbetet një problem me pasoja të mëdha në shkallë të gjerë për zhvillimin socio-ekonomik të rajonit pasi që e nxit emigrimin dërrmues të kësaj grup moshe. Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) raportoi një Shkallë të Papunësisë tek të Rinjtë (SHPR) prej 46.8 përqind për vitin 2021. Poashtu, raporti i Komisionit Evropian konstatoi një shkallë të jo aktivitetit tek të rinjtë prej rreth 62 përqind.¹⁹⁵ Përkundër një rënieje me kalimin e kohës që nga viti 2018 (shih Tabelën 4), për shkak të kushteve socio-ekonomike të rinjtë kosovarë nuk arrijnë ta ndjenjë një lidhje të mirëfilltë mes standardeve të Kosovës dhe të Evropës Perëndimore të prosperitetit dhe zhvillimit ekonomik. Sipas Anketës së Fuqisë Punëtore të vitit 2021, shkalla e papunësisë në mesin e të Rinjve është më e lartë në mesin e të rinjve femra (53.5 përqind) se sa tek të rinjtë meshkuj (46.1 përqind).¹⁹⁶

Tabela 4: Shkallët e Papunësisë në Kosovë në grupmoshën 15 deri në 24 vjeç

Viti	2018	2019	2020	2021
Shkalla e Papunësisë tek të Rinjtë (SHPR) në përqindje	55.41	49.76	49.66	46.8

196. Për ta ulur shkallën e lartë të papunësisë, nevojitet të bëhet rishikimi i Planit të Veprimit për Punësimin e Rinisë për periudhën 2018-2022 dhe i Strategjisë Sektoriale të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS).¹⁹⁷ Qeveria është zotuar se do të zbatojë skemën e Punësimit të Garantuar për Rininë në korrik të vitit 2021. Qëllimi i kësaj skeme është t’i mbështesë të papunët nën moshën 30 vjeçare përmes programeve të trajnimit dhe edukimit brenda një periudhe të caktuar papunësie pas lënjes së shkollën ose mbetjes të papunë. Qeveria ende nuk ka nisur përgatitjet konkrete si caktimi i një koordinatori, trupi koordinues dhe zhvillimi i një plani të zbatimit për Punësimin e Garantuar për Rininë.¹⁹⁸

197. Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike (ERP) u publikua për miratim në qershor të vitit 2021 me qëllim që të kufizoheshin pasojat ekonomike të pandemisë tek të rinjtë. Masa 1.4 për skemën e punësimit të garantuar për të rinjtë përfshin një buxhet prej 10 milionë eurosh për ta trajtuar prob-

194 Vendimi i QK-së Nr. 10/24 (11 gusht 2021).

195 Komisioni Evropian (2021), [Raporti Vjetor i Progresit](#).

196 Agjencia e Statistikave të Kosovës (2021), [Anketa e fuqisë punëtore për tremujorin e parë 2021](#).

197 MPMS(2021), [‘Raporti Vjetor i Monitorimit 2020, të Planit të Veprimit për Punësimin e të Rinjve 2018](#).

198 Komisioni Evropian (2021), [Raporti Vjetor i Progresit](#).

lemin e papunësisë për të rinjtë e moshës 18 deri në 24 vjeç. Në strategjinë e paraparë, qeveria iu garanton të rinjve “punën e parë, të subvencionuar nga shteti në nivelin e pagës minimale.”¹⁹⁹ ERP ka planifikuar edhe trajnime në fushën e TI-së (masa 1.5), duke cekur se “për t’i orientuar talentët e rinj drejt fushës së TI-së, do të ofrojmë kuponë përmes të cilëve mund të ndiqen kurset e TI-së ose trajnime në praktikë. Atyre që e përfundojnë me sukses kursin ose trajnimin do t’iu ofrohet mbështetje për punësim për 3 muajt e parë.”²⁰⁰

198. Një perspektivë gjinore për të drejtat e të rinjve në Kosovë tregon se dinamikat stereotipike patriarkale mbeten të përhapura në shoqërinë e Kosovës. Sipas një raporti të fundit të UNICEF-it për të rinjtë, prithshmëritë tradicionale gjinore vazhdojnë të jenë të pranishme në arsim dhe në vendin e punës.²⁰¹

199. Rekomandime:

- Institucionet qendrore dhe lokale duhet t’i përfshijnë të rinjtë në të gjitha nivelet e proceseve vendimmarrëse pasi që kontributi i të rinjve nuk mund të anashkalohet gjatë hartimit të legjislacionit që ndikon drejtpërdrejt në mirëqenien e tyre socio-ekonomike. Nevojat dhe interesat e të rinjve plotësohen më mirë përmes politikëbërjes në të cilën përfshihen këto grupmosha (15-24 vjeç);
- MASHTI duhet t’i rishikojë politikat ekzistuese dhe të përdorë qasje transformuese e cila mundëson harmonizimin e arsimit të lartë me atë të një konteksti dhe tregu evropian të punës;
- QK duhet ta zbatojë Planin për Punësimin e Garantuar për të Rinjtë duke e emëruar organin koordinues;
- QK duhet ta hartojë një strategji ndërministrorë e cila e plotëson hendekun mes arsimit dhe nevojave të tregut të punës. Kjo mund të bëhet pjesërisht duke ofruar mundësi pune praktike për studentët në fushën e tyre përkatëse të studimeve;
- Për funksionimin e mirëfilltë të mekanizmave të KVRQ dhe KVRL-ve, nevojitet më shumë mbështetje institucionale dhe financiare. Për këtë arsye, ndryshimi i Ligjit për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e të Rinjve mund ta qartësojë statusin e KVRQ-së dhe KVRL-ve;
- Qeveritë lokale duhet të zhvillojnë Plane të Veprimit Rinor Lokal dhe të miratojnë buxhete për zbatimin e këtyre planeve.

7.4 Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara

200. Korniza ligjore në të cilën mbështetet vlerësimi i situatës së zbatimit të të drejtave të njeriut të personave me aftësi të kufizuara në Kosovë përbëhet nga Kushtetuta së bashku me ligje dhe rregullore të shumta në të cilat referohen në mënyrë specifike këtij segmenti të popullsisë. Pjesë e kornizës legjislative përmes të cilës mbrohen të drejtat e personave me aftësi të kufizuara është

199 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (2021, f. 4), [Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike](#).

200 Ibid.

201 UNICEF (2021), [Zërat e Rinj nga Kosova](#).

edhe Ligji nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti dhe Ligji nr. 03/L-022 për Përkrahje Materiale të Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme. Dy ligje të tjera që i mbështesin grupin specifik të personave me aftësi të kufizuara janë Ligji nr. 05/L -067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë dhe Ligji Nr. 04/L – 092 për Personat e Verbër. Një pjesë e kornizës ligjore të Kosovës e pasqyron Konventën e Kombeve të Bashkuara për Personat me Aftësi të Kufizuara (KPAK), por ende nuk është përfshirë në Kushtetutë si instrument ndërkombëtar i të drejtave të njeriut i zbatueshëm drejtpërdrejt sipas nenit 22. Kosova e ka përvetësuar edhe një vizion gjithëpërfshirës që përqendrohet në promovimin e të drejtave dhe kushteve të këtij komuniteti dhe objekteve të tij në Strategjinë për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023.

201. Legjislati i Kosovës bazohet në mënyrë implicite në instrumentet evropiane të të drejtave të njeriut, por i mungon harmonizimi i formuluar siç duhet dhe i qartë. Në nenin 22 të Kushtetutës, një sërë instrumentesh kyçe për të drejtat e njeriut shërbejnë si bazë për ligjet dhe rregulloret vendore, por nuk përfshihet KDPAK. Nga ana tjetër, ka përfunduar hartimi i Ligjit për Trajtimin dhe Kategorizimin e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe pret miratimin. Ky ligj do të fokusohet tek personat me aftësi të kufizuara dhe përfshin të gjitha format e aftësive të kufizuara. Mekanizmat institucionalë të themeluar për ta ruajtur kohezionin midis politikës dhe praktikës janë në kuadër të përgjegjësisë të Këshillit Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara (KKPAK). Megjithatë është themeluar për të vepruar në bashkëpunim me OSHC-të përkatëse, KKPAK nuk është në funksion që nga viti 2018. Pasi që roli kryesor i KKPAK-së është të përcaktohen llojet e politikave institucionale që i promovojnë rrethanat socio-ekonomike të këtij komunitetit, duhet të zgjidhet statusi i tij.

202. Lidhja e dobët mes politikave dhe praktikës përkthehet në realitete të diskriminimit të vazhdueshëm dhe në mungesë të kujdesit institucional.²⁰² Problemet infrastrukturore që e pengojnë qasjen në ndërtesa publike, shkolla, qendra mjekësore dhe në transport janë në kundërshtim me udhëzimet administrative që garantojnë qasje në hapësirat publike.

203. Personat me aftësi të kufizuara kanë qasje shumë të kufizuara në qendrat themelore të kujdesit shëndetësor dhe në shërbimet sociale që ofrohen nga autoritetet publike. Sipas raportit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2021, vetëm 10 përqind e fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë kanë përfituar nga shërbimet shëndetësore dhe sociale.²⁰³

204. Nga një këndvështrim socio-ekonomik, HANDIKOS i identifikon personat me aftësi të kufizuara në mesin e grupeve sociale më të varfëra të popullsisë.²⁰⁴ Për të kundërshtuar këtë çekuilibër ekonomik, Masa 1.4 e Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike (PRE) specifikon mbështetjen e punësimit që do të marrin personat me aftësi të kufizuara: “për ta arritur qëllimin e një shteti të barabartë për të gjithë, do ta mbështesim çdo punonjës me aftësi të veçanta me 50 përqind të pagës, deri në maksimumi 150 euro në muaj [...] për 6 muajt e parë.”²⁰⁵

202 HANDIKOS (2021), Raporti vjetor i progresit.

203 Komisioni Evropian (2021), [Raporti Vjetor i Progresit](#).

204 Ibid.

205 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (2021, f. 4), [Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike](#).

205. Papunësia e lartë e personave me aftësi të kufizuara pasqyron mospërputhjen ndërmjet legjislacionit të Kosovës dhe realitetit të përjashtimit dhe diskriminimit të vazhdueshëm. Kjo mospërputhje vazhdon pavarësisht zbatimit të Ligjit nr. 03/L-019 për Aftësimin Profesional, Rehabilitimin dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara që përfshin kuotën e punësimit të një personi me aftësi të kufizuara të punësuar për pesëdhjetë individë të punësuar. Përvoja e individëve me aftësi të kufizuara është se ata janë në disavantazh pasi që aftësia e kufizuar e tyre luan një rol vendimtar në mundësitë e tyre për punësim, pavarësisht nga kompetencat dhe aftësitë e tyre.

206. Mungesa e ndërgjegjësimit të disa institucioneve publike dhe popullatës në përgjithësi i privon personat me aftësi të kufizuara nga mbështetja financiare dhe sociale që iu takon ligjërisht. Fëmijët në veçanti janë të përjashtuar nga mbështetja financiare për shkak të mungesës së njohurive të ofruesve mjekësorë për disa lloje të aftësive të kufizuara, e kombinuar me mungesën e të kuptuarit të ligjeve dhe udhëzimeve administrative që garantojnë mbështetje financiare.

207. Lidhur me paragrafët e mësipërm, shtatë lëndë gjyqësore janë ngritur përmes IAP-së për shkak të diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, gjashtë prej të cilave mbeten në pritje. Në Amicus Curiae (Opinion Ligjor), IAP konstatoi se Komuna e Prishtinës e ka shkelur Kushtetutën duke mos iu dhënë personave me aftësi të kufizuara qasje fizike në hapësirat publike.

208. Integrimi social i fëmijëve me aftësi të kufizuara nuk është i zhvilluar dhe pjesëmarrja në shoqëri është e kufizuar, veçanërisht në fushën e arsimit. Sipas raporteve më të fundit të UNICEF-it, rreth 3,645 studentë me aftësi të kufizuara janë të regjistruar në arsim (11 deri në 12 përqind).²⁰⁶ Raporti përmend arsye të ndryshme nga mungesa e një qasjeje institucionale nga niveli qendror në lokal deri në stigmatizimin dhe traditatat nga niveli më i ulët deri tek ai më i larti. Qasja në arsimin e rregullt është veçanërisht sfiduese në rastin e fëmijëve me prejardhje rome-K, ashkali-K dhe egjiptian-K.

209. Angazhimi i HANDIKOS-it dhe organizatave të tjera për personat me aftësi të kufizuara ka krijuar mundësi premtuese për përmirësimin e kushteve ekzistuese nga viti 2022 e më tutje. Sipas HANDIKOS-it, mundësitë përfshijnë miratimin e një plani strategjik tre-vjeçar që do t'i përmirësojë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, funksionalizimin e KKPAC-së dhe angazhimin e Kosovës për ndryshimin e Kushtetutës për ta përfshirë UNCRPD-në.

210. Viti 2022 mund të sjellë vëmendje më të mirë ndaj çështjeve që kanë të bëjnë me personat me aftësi të kufizuara marrë parasysh që ZQM (Zyra e Kryeministrit) e ka shpallur vit të personave me aftësi të kufizuara. Në koordinim me HANDIKOS-in dhe OSHC-të e tjera, këto aktivitete do të përqendrohen në kontekste të ndryshme lidhur me individët me aftësi të kufizuara (shëndetësia, ligji, siguria, arsimi, punësimi, mirëqenia sociale, kultura, sporti).

206 UNICEF (2021), [Gjendja me të drejtat e fëmijëve në Kosovë](#).

211. Rekomandime:

- QK duhet të sigurojë që praktikat dhe politikat duhet të jenë të harmonizuara plotësisht në të gjitha hapësirat institucionale dhe publike për të mundësuar qasje të barabartë për personat me aftësi të kufizuara;
- QK dhe KK duhet ta ndryshojë nenin 22 të Kushtetutës për ta bërë KDPAK-në drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë;
- QK duhet të ofrojë masa që sigurojnë përfshirjen e plotë të fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë në sistemin arsimor për të krijuar arsim të barabartë;
- QK duhet t'i japë prioritet përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në fushat socio-ekonomike të jetës publike;
- QK duhet të sigurojë që të drejtat dhe nevojat e personave me aftësi të kufizuara të vendosen në qendër të reagimit dhe rimëkëmbjes nga COVID-19, duke përfshirë të drejtën e tyre për të pasur qasje në informacionin kryesor duke ofruar përkthyes të gjuhës së shenjave në të gjitha konferencat zyrtare për shtyp dhe duke siguruar zbatimin e plotë të Ligjit Nr. 04/L-092 për Personat e Verbër.

7.5 Të drejtat e komuniteteve joshumicë

212. Korniza ligjore e parasheh parimet demokratike të multietnicitetit, diversitetit dhe barazisë së të gjitha grupeve etnike, fetare dhe gjuhësore në Kosovë.²⁰⁷ Kushtetuta e Kosovës deklaron në nenin 3.1 (Barazia para ligjit) që Kosova “është shoqëri shumëetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera”²⁰⁸ Komunitetet joshumicë të Kosovës përfshijnë komunitetin serb-K, turq-K, rom-K, ashkali-K, egjiptian-K, boshnjak-K, goran-K dhe kroat-K. Në Tabelën 5 më poshtë, është ilustruar ndarja demografike e komuniteteve përkatëse sipas regjistrimit të fundit të popullsisë (ASK, 2011).²⁰⁹ Përveç Kushtetutës, të drejtat e komuniteteve pakicë garantohen me Ligjin nr. 03/L-047 për Mbrotjtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve Pakicë dhe Pjesëtarëve të tyre në Kosovë. Në këtë ligj, “diversiteti kombëtar, etnik dhe fetar” i Kosovës përkufizohet si “burim i fuqisë dhe pasurisë për zhvillim të mëtejshëm të një shoqërie demokratike”.²¹⁰ Bazuar në këtë këndvështrim, ligji parasheh masa të veçanta që e mundësojnë zbatimin e statusit dhe integrimin e barabartë të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në shoqërinë kosovare. Për më tepër, në Ligjin nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve (Ligji i Gjuhëve) gjuha shqipe dhe serbe kanë status të gjuhëve zyrtare dhe gjuhët e komuniteteve joshumicë janë “zyrtarisht në përdorim” në komunat ku fliten gjuhët joshumicë si gjuhë amëtare nga më shumë se 20 përqind e popullsisë në fjalë.²¹¹

207 Demaj, U. & M. Vandenbroucke (2016), [Post-war Kosovo landscapes in Pristina: Discrepancies between policy and urban reality](#).

208 Kushtetuta e Kosovës (2008).

209 [Agjencia e Statistikave të Kosovës](#) (2021).

210 [Ligji nr. 03/L-047](#).

211 Ibid.

Përdorimi zyrtar i turqishtes në qarkun e Prizrenit është rast ilustrues i këtij Ligji në praktikë. Rasti i njëjtë është me gjuhën rome në Graçanicë.

Tabela 5: Popullsia sipas përkatësisë etnike duke përjashtuar opsionin 'tjetër' dhe 'preferoj të mos përgjigjem'²¹²

	Shqiptar-K	Serb-K	Turq-K	Boshnjak-K	Rom-K	Ashkali-K	Egjiptian-K	Goran-K	Gjithsej
Gjithsej	1,616,869	25,532	18,738	27,533	8,824	15,436	11,52	10,265	1,739,825

213. Mekanizmat institucionalë që i mbrojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e komuniteteve joshumicë në Kosovë janë pjesërisht pjesë e Këshillit Konsultativ për Komunitete (KKK) të Zyrës së Presidentit. Këshilli e plotëson hendekun ndërmjet institucioneve publike të Kosovës dhe komuniteteve. Roli i tij qendror është t'i artikulojë pikëpamjet e komuniteteve mbi legjislacionin, politikën dhe programet relevante për komunitetet joshumicë, të garantojë funksionimin efikas të organizatave përfaqësuese të komuniteteve dhe t'iu ofrojë komuniteteve mundësinë për të marrë pjesë në nismat ligjore dhe politike. Përveç Këshillit, Qeveria e Kosovës e ka miratuar edhe Strategjinë për Përfshirjen e Komuniteteve rom-K dhe ashkali-K në Shoqërinë Kosovare (2017-2022). Qeveria ende nuk e ka miratuar Strategjinë dhe Planin e Veprimit për periudhën 2022-2025, sipas OSHC-së BSFK. Vonesa e miratimit të strategjisë ka ndikim negativ në jetën e komuniteteve rom dhe ashkali në arsim, shëndetësi, banim, çështje sociale dhe anti-diskriminim. Qeveria e fundit (2022-2025) supozon më shumë veprime në lidhje me përfshirjen shoqërore të komuniteteve rom-K, ashkali-K dhe egjiptian-K.²¹³ Pas Deklaratës së Partnerëve të Ballkanit Perëndimor për Integrimin e Romëve në Procesin e Zgjerimit të BE-së (Deklarata e Poznan-it), QK e ka themeluar Grupin Teknik për Mbrojtje nga diskriminimi i komuniteteve rom-K, ashkali-K dhe egjiptian-K.²¹⁴

214. Konteksti multietnik i Kosovës karakterizohet nga ndërprerje mes statusit të saj zyrtar multietnik në letër dhe realiteteve të segregimit etno-hapësinor.²¹⁵ Kosova përfaqësohet si shoqëri etnikisht gjithpërfshirëse në ligjet dhe rregulloret e saj të ndryshme, por nocioni i "multi-etnicitetit" nuk përputhet me realitetet e ndarjes etno-hapësinore që u kristalizuan pas luftës së viteve 1998-1999. Manifestimi i ndarjes etnike si tipar definues i Kosovës e cenon themelin e një shoqërie të cilën mund ta ndajnë dhe ta konsiderojnë të tyre të gjitha komunitetet.²¹⁶

215. Pëkundër konfigurimit multi-etnik të Kosovës, mospërputhjet ekzistojnë edhe mes politikave gjithpërfshirëse dhe praktikave të përjashtimit etnik dhe fetar. Ligji për Përdorimin e Gjuhëve e përfaqëson konsolidimin e barazisë në legjislacionin e Kosovës. Përmes miratimit të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, KK e ka deklaruar përdorimin e barabartë të gjuhëve zyrtare, shqipes dhe serbishtes, dhe alfabetëve të tyre përkatëse, latin dhe cirilik. Poashtu e siguron përdorimin e

212 Shumica e serbëve e bojkotuan regjistrimin e popullsisë në Kosovë në vitin 2011. Si pasojë, ende nuk ka të dhëna zyrtare për numrin e banorëve etnikë serbë në Kosovë.

213 [Programi i qeverisë së Republikës së Kosovës](#) (2021).

214 Komisioni Evropian (2021), [Raporti Vjetor i Progresit](#).

215 Demaj, U. & M. Vandenbroucke (2016), [Post-war Kosovo landscapes in Pristina: Discrepancies between policy and urban reality](#).

216 Demaj, U. (2019), [What Color is your flag when it burns? Language, ethnic identity and conflict in the historical urban linguistic landscapes of Pristina, Kosovë](#).

gjuhës angleze si gjuhë zyrtare përderisa UNMIK-u të jetë i pranishëm në Kosovë. Meqenëse vetë ligji nuk identifikon mjete për ta mbështetur zhvillimin e kapaciteteve komunale për të siguruar zbatimin e tij, QK miratoi udhëzime administrative në vitin 2008 dhe themeloi Komisionin e Gjuhëve për ta mbikëqyrur zbatimin e tij. Krahas cilësisë së dobët të përkthimeve në serbisht, studimet raportojnë për përjashtimin dhe zëvendësimin sistematik të serbishtes me anglishte në sinjalistikën e autoriteteve zyrtare në kryeqytet.²¹⁷

216. Serbët vepruan kryesisht në përputhje me këshillat për masat zyrtare për COVID-19 dhe kufizimet e lëvizjes të lëshuara nga agjencitë publike në Serbi. Nevoja për veprim gjithëpërfshirës dhe kolektiv si një mënyrë e nevojshme për ta luftuar COVID-19 dhe për t'iu ofruar komuniteteve informata me kohë dhe qasje të barabartë në burime, mbështetet në strategjitë e shpërndarjes së informatave që i përfshijnë të gjitha komunitetet në gjuhët e tyre përkatëse.

217. Përderisa zgjedhjet e Kuvendit të Kosovës në vitin 2021 në përgjithësi u vlerësuan nga bashkësia ndërkombëtare si të lira dhe të drejta, në komunat serbe, veçanërisht në veri, u shënuan parregullsi.²¹⁸ Para zgjedhjeve, deputetja e KK-së, Duda Balje, akuzoi se ishte arritur një marrëveshje në prapaskenë midis Adriana Hoxhiq (deputete boshnjake-K e Partisë Komuniteti i Bashkuar), Gazmen Salijeвиq dhe partisë së tij, Nisma Rome dhe Lista Srpska për të siguruar vota nga komuniteti boshnjak-K, rom-K, egjiptian-K dhe ashkali-K për ta mbështetur Listën Serbe në Kuvendin e Kosovës, duke siguruar kështu kontrollin e tyre në njëzet (20) vendet e rezervuara për komunitetet joshumicë. Në ditën e zgjedhjeve, raportet në mediat sociale treguan se një numër i madh serbësh kishin votuar për partinë e Hoxhiqit. Kjo u vërtetua më vonë kur votat u numëruan dhe treguan se ajo kishte marrë disa mijëra vota në komunën e Mitrovicës së Veriut, Leposaviqit, Zveçanit dhe Zubin Potokut. Më pas u mor një vendim nga Paneli Zgjedhor për Ankesa për t'i anuluar rreth 4,000 vota që Hoxhiq kishte marrë në komunat serbe. Më pas ajo paraqiti ankesë e cila më vonë u refuzua nga Gjykata Kushtetuese. Ky ishte burim i një reagimi të konsiderueshëm në mesin e komunitetit serb, shumë prej të cilëve e hodhën poshtë idenë e parregullsive të përhapura dhe votimit taktik të sheshuara nga akterët politikë nga komuniteti shqiptar dhe ndërkombëtar.²¹⁹

218. Çështja e të drejtës së votës së komunitetit serb në referendumin e ardhshëm kushtetues të Serbisë shkaktoi polemika për shkak të rezolutës së fundit të Qeverisë së Kosovës për moslejimin e zgjedhjeve serbe në Kosovë.²²⁰ QK deklaroi që referendumi serb do të përbënte cenim të "sovrانيتit dhe rendit kushtetues të Republikës së Kosovës"²²¹ dhe do të ishte "në kundërshtim me praktikat dhe normat ndërkombëtare".²²² Bashkësia ndërkombëtare e dënoi vendimin e qeverisë së Kosovës me arsyen se serbët-K kanë të drejtë të "votojnë në zgjedhje dhe në procese zgjedhore". QK vendosi që serbët-K me nënshtetësi serbe mund të votojnë përmes postës ose përmes zyrës ndërlidhëse serbe.²²³ Në praktikë, kjo nuk u zbatua.

217 Demaj, U. & M. Vandenbroucke (2016), [Post-war Kosovo landscapes in Pristina: Discrepancies between policy and urban reality](#).

218 OJQ Aktiv (2021), kontribut për Raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në vitin 2021.

219 Caleb Waugh & Igor Marković (2021), Assessment of the Status of the Rights of Non-Majority Communities in Kosovo.

220 Foley, R. (2022), [Kuvendi i Kosovës e miraton rezolutën që e ndalimin e referendimit serb](#).

221 Ibid.

222 Ibid.

223 Ibid.

219. Një dimension vendimtar i çdo vlerësimi të situatës në lidhje me situatën e të drejtave të njeriut në Kosovë është siguria pasi ajo formëson perceptimet tona për tensionet ndërmjet komuniteteve. Në raportet e tyre përkatëse të progresit, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara dhe Komisioni Evropian përshkruajnë në mënyrë të pavarur një rritje të incidenteve që përfshijnë kryesisht komunitetet serbe dhe objektet fetare dhe kulturore ortodokse serbe.²²⁴ Katër incidente të ngacmimit, frikësimit dhe sulmit fizik të serbëve të Kosovës u raportuan në pjesën jugore të lumit Ibër në vitin 2021.²²⁵ Raporti i progresit i OKB-së i vitit 2021 më tutje shënoi gjithsej pesëmbëdhjetë (15) incidente të raportuara që përfshinin forma të ndryshme të vandalizmit, dëmtimit të pronës dhe grafiteve me gjuhë të urrejtjes në hapësirat fetare dhe kulturore serbe. Siç theksohet në Raportin e Komisionit Evropian, edhe pse autoritetet ligjore dhe forcat policore kanë reaguar me shpejtësi, incidentet e sigurisë “ndjellin një përshtypje të pasigurisë në mesin e viktimave dhe kështu ndikojnë në marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve”.²²⁶

220. Për dallim nga politikëbërja gjithëpërfshirëse, komunitetet romë-K, ashkali-K dhe egjiptianë-K përballen me diskriminim në bazë të përkatësisë së tyre etnike, përkundër Ligjit nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi i cili e parandalon diskriminimin në bazë etnike. Stigma që i është caktuar kulturës së tyre i ka shtyrë edhe më shumë në margjinalizim duke rezultuar në qasje të pabarabartë në kujdesin shëndetësor, punësim dhe arsim.²²⁷ Raporti i Komisionit Evropian i kërkon QK-së që t’i përshpejtojë përgatitjet për Strategjinë e re dhe Planin e Veprimit 2021-2026 që i lufton qëndrimet mbizotëruese dhe ofron qasje në pjesëmarrje të barabartë në të gjitha sferat e jetës shoqërore. Përveç kësaj, malazezët dhe kroatët ballafaqohen me beteja të ngjashme si pakicat e tjera kur bëhet fjalë për qasje të barabartë në kujdesin shëndetësor, punësim dhe përfshirje në sferat e tjera shoqërore që iu garanton të drejta dhe mundësi të barabarta në Kosovë.

221. Përkundër Planeve Vendore të Veprimit për integrimin e komuniteteve rom-K, ashkali-K dhe egjiptianë-K, institucionet përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e tyre nuk kanë burime të mjaftueshme njerëzore dhe kapacitete financiare për t’i realizuar objektivat e synuara. Në vend të kësaj, një raport i BSFK-së i vitit 2022 zbuloi se shumica e aktiviteteve për përfshirjen e këtyre komuniteteve në shoqëri janë kryer nga OSHC-të dhe partnerët zhvillimorë.²²⁸

222. Gjuha e urrejtjes dhe aktet e diskriminimit ndaj komuniteteve joshumicë dhe personave në situata të cenueshme vazhduan në vitin 2021.²²⁹ Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi përcakton një kornizë të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në mënyrë që të zbatohet parimi i trajtimit të barabartë.²³⁰ Përkundër kësaj, institucionet publike dështojnë të veprojnë në përputhje me ligjin dhe të ofrojnë qasje dhe kushte të barabarta sociale për komunitetet joshumicë. Një rast i diskriminimit i shënjestruar ndaj një familjeje romë përfshiu sulm fizik nga rojet private të sigurisë në njërën nga qendrat tregtare në Prizren për shkak të mosmbajtjes së maskës, përkundër faktit se as qytetarët e tjerë nga komunitetet e tjera nuk po mbanin maska. Po ashtu, spitali rajonal i Prizrenit nuk ka ofruar trajtim adekuat shëndetësor për familjen dhe i ka

224 Raporti iu referohet dy raporteve ndërkombëtare: Raportit të Progresit nga Komisioni Evropian (2021) dhe Raportit të Këshillit të Sigurimit të OKB-së (2021).

225 Aktiv (2021), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2021.

226 Komisioni Evropian (2021), [Raporti Vjetor i Progresit](#).

227 Kapitulli 7.1 dhe 7.2 i raportit aktual e diskuton situatën e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian nga perspektiva e të Drejtave të Grave dhe të Fëmijëve.

228 BSFK (2022), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në vitin 2021.

229 Komisioni Evropian (2021), [Raporti Vjetor i Progresit](#).

230 [Law no. 05/L-021](#)

liruar viktimat pa të dhëna mjekësore. Vetëm pas presionit të vazhdueshëm nga përfaqësuesit politikë jo-shumicë, spitali bëri një ekzaminim të duhur mjekësor dhe lëshoi të dhënat mjekësore të nevojshme për gjykimet gjyqësore. Grupi Punues Teknik për mbrojtjen nga diskriminimi i komuniteteve rom-K, ashkali-K dhe egjiptian-K e trajtoi këtë çështje dhe shprehu përkushtimin për të ndërmarrë veprime konkrete për parandalimin e akteve të ngjashme diskriminuese në të ardhmen.²³¹ Sipas raportit të pestë të Këshillit të Evropës për Vlerësimin e të Drejtave të Komunitetit, ka nevojë për ta rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve për diskriminimin dhe për t'i ngritur kapacitetet për adresimin e rasteve të mosdiskriminimit.²³²

223. Në tetor të vitit 2021, dhjetë shqiptarë etnikë u akuzuan pas një sulmi të motivuar etnik ndaj 11 serbëve etnikë gjatë një mosmarrëveshjeje të nxehur që shpërtheu rreth identifikimit të targave në vijën kufitare administrative të Mitrovicës veriore (ABL).²³³ Poashtu në vitin 2021, u vandalizuan disa gurë varresh të serbëve-K në varrezat e fshatit në qendër të Graçanicës.

224. Rekomandime:

- Grupi Punues Teknik për mbrojtjen nga diskriminimi i komuniteteve rom-K, ashkali-K dhe egjiptian-K duhet të nxjerrin masa konkrete dhe të realizueshme parandaluese;
- Institucionet gjyqësore duhet t'i adresojnë në mënyrë të duhur krimet me motive etnike;
- Institucionet e Kosovës duhet t'i adresojnë në mënyrë të duhur krimet potenciale me motive etnike;
- Policia e Kosovës duhet të rekrutojë më shumë zyrtarë policorë nga komunitetet joshumicë, duke e fuqizuar poashtu praninë policore në komunitet sipas rekomandimeve të Komisionit Evropian.

7.6 Të drejtat e komunitetit LGBTIQ+

225. Kushtetuta e Kosovës ofron mbrojtje shumë të favorshme për komunitetet lezbike, homoseksualë, biseksualë, transgjinjorë, interseks dhe queer (LGBTIQ+). Përveç dispozitave të përgjithshme për barazinë sipas ligjit, Kushtetuta parashih ndalim të qartë të diskriminimit në bazë të orientimit seksual.²³⁴ Në një zhvillim pozitiv legjislativ, ndryshimet në Kodin Penal iu mundësojnë prokurorëve të bëjnë hetime dhe gjyqtarëve të shqiptojnë dënime më të ashpra kur vërtetohet se autori ishte i motivuar për ta kryer një vepër në bazë të orientimit seksual të viktimës ose për shkak të një perceptimi në lidhje me orientimin seksual.²³⁵

231 AT (2021), të dhëna për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në vitin 2021.

232 OSBE Kosovë (2021), [Raport për Vlerësimin e të Drejtave të Njeriut, Botimi i 5-të](#).

233 [Balkan Insight](#) (2021).

234 Në nenin 24.

235 KCGS & CSGD, 2021.

226. Situata pandemike padyshim që ka sjellë sfida dhe vështirësi të reja për personat LGBTIQ+ në Kosovë. Me disa kufizime, situata e personave LGBTIQ+ nuk ka ndryshuar shumë që nga periudha e mëparshme e raportimit. Ndërgjegjësimi i publikut për të drejtat e personave LGBTIQ+ dhe pranimi i përgjithshëm raportohet të jetë i ulët. Ka pasur poashtu incidente të gjuhës së urrejtjes ndaj komunitetit LGBTIQ+, veçanërisht në mediat sociale dhe rastet e krimeve të urrejtjes ndaj personave LGBTIQ+ ende nuk hetohen dhe ndiqen penalisht siç duhet. Zbatimi i Planit të Veprimit të PKBGJ 2019-2022 nuk po përparon, pjesërisht për shkak të pandemisë COVID-19.²³⁶

227. Testimi i diskriminimit u realizua në Prishtinë dhe rezultatet treguan se, nga tri grupet e përfshira, komuniteti LGBTIQ+ është grupi më i diskriminuar në të gjitha zonat e testuara. Aktet e diskriminimit përfshijnë injorancën, shikimin, talljen dhe shakatë, deri te kërcënimet për dhunë fizike. Gjithashtu, aktet diskriminuese ndaj personave LGBTIQ+ nuk u kryen vetëm nga subjektet e testimit të situatës²³⁷ (stafi i lokaleve në Prishtinë dhe agjencive të pronave të paluajtshme), por edhe nga personat e tjerë që nuk ishin pjesë e testimit, si mysafirët e tjerë në lokale dhe kalimtarët, pavarësisht seksit, moshës, klasës apo tipareve të tjera personale.²³⁸

228. Aktivistët arritën ta mbajnë Paradën e pestë të Krenarisë në Prishtinë në korrik të vitit 2021. Marshi i Paradës së Krenarisë shënoi mbylljen e Javës së Krenarisë 2021. Një numër i konsiderueshëm njerëzish u mbledhën në sheshet kryesore të Prishtinës për t'i festuar komunitetet LGBTIQ+ dhe për të kërkuar të drejta dhe mundësi të barabarta. Parada e Krenarisë vazhdon të jetë revolucionare dhe një përkujtim se duhet të vazhdojmë të luftojmë për lirinë, të drejtat dhe liritë e komuniteteve LGBTIQ+. Java e Krenarisë pati një numër të madh aktiviteteve kulturore dhe ndërgjegjësuere të cilat ishin me interes të madh për pjesëmarrësit. Gjatë konferencës së mbajtur në Javën e Krenarisë, vazhdoi të theksohet rëndësia e përfshirjes së martesës së seksit të njëjtë në Kodin Civil.

229. Komuna e Prishtinës njoftoi se do ta financonte dhe ndërtonte një strehimore gjatë vitit 2021 për personat LGBTIQ+ të cilët janë të mbijetuar të dhunës në familje ose janë të pastrehë për shkak të refuzimit nga familjet e tyre. Megjithatë, ka pasur vonesa të konsiderueshme në këtë proces deri më tani. Si rezultat, gjatë vitit 2021, OJQ-ja Qendra për Barazi dhe Liri (CEL) ofroi mbështetje për 9 viktima të dhunës fizike dhe psikologjike, 7 prej të cilave iu ofrua strehim i përkohshëm. Nga 9 rastet, 3 raste ishin të mitur për të cilët CEL punonte vazhdimisht në bashkëpunim me Qendrën për Punë Sociale pasi që nuk kishte mundësi për strehim të personave LGBTIQ+. Strehimi adekuat është thelbësor për mirëqenien e personave LGBTIQ+, megjithatë strehimoret aktualisht kanë mangësi të mëdha pasi personat transgjinorë nuk mund të strehohen në mënyrë dinjitoze për shkak të ndarjes në bazë të seksit biologjik. Personave të strehuar iu ofrua edhe ndihmë psikologjike nga CEL. Seancat psikologjike pro bono janë një program i vazhdueshëm në CEL që iu ofrohet personave LGBTIQ+. CEL raportoi një nevojë gjithnjë në rritje për seanca psikologjike dhe si rrjedhojë organizata u desh ta rriste numrin e psikologëve nga katër në gjashtë.²³⁹

236 Komisioni Evropian (2021), [Raporti Vjetor i Progresit](#).

237 Sipas raportit të cituar, testimi i situatës është një metodë për ta vërtetuar diskriminimin dhe raporti në vijim paraqet rezultatet e përdorimit të kësaj metode për t'i treguar format dhe mënyrat më të zakonshme të diskriminimit ndaj lezbikeve, homoseksualëve dhe grave romë në Kosovë në qasjen në mallra, shërbime dhe banim.

238 Qendra Kosovare për Studime Gjinore dhe Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore, Raport mbi testimin e situatës së diskriminimit ndaj lezbikeve, homoseksualëve dhe grave romë në fushat e qasjes në mallra, shërbime dhe banim, 2021.

239 Qendra për Barazi dhe Liri (2022), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi Situatën e të Drejtave të Njeriut në Kosovë në vitin 2021.

230. Rishikimet ligjore për ta lejuar njohjen ligjore të gjinisë janë duke u zhvilluar. Si pasojë e disa rasteve gjyqësore, nisi ngritja e një grupi punues pranë Agjencisë së Regjistrimit Civil për hartimin e një ligji për njohjen ligjore të gjinisë. Draft koncept dokumenti është përpiluar dhe është në fazën përfundimtare, por ende nuk është përshtatur.²⁴⁰ Prandaj, ende nuk është siguruar një kornizë ligjore e caktuar dhe e drejtë për njohjen gjinore. Kjo prek të gjitha sferat e jetës së komunitetit LGBTIQ+ që nga aftësia për ta shprehur identitetin ose orientimin e tyre gjinor dhe ushtrimi i të drejtës së tyre për një jetë private dhe familjare, deri te arsimimi, punësimi, qasje në kujdesin shëndetësor, etj.²⁴¹

231. Mediat raportohet se janë përfshirë gjithnjë e më shumë në temën e të drejtave të komunitetit LGBTIQ+ dhe po zhvillohen më shumë diskutime në lidhje me orientimin seksual dhe identitetin gjinor. Ndonëse jo të gjithë janë pozitivë apo të mirëinformuar, angazhimi i shfaqur në tërësi ka mundësuar që kjo çështje të diskutohet më gjerësisht. Rritja e ndërgjegjësimit të medias dhe institucioneve dhe bashkëpunimi i tyre me shoqërinë civile ka mundësuar, siç u shtjellua më lart, të zhvillohet Parada e Krenarisë së komunitetit LGBTIQ+. Përkundër këtyre zhvillimeve pozitive, Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore (CSGD) dhe Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ) raportojnë nevojën për përmirësime në një numër fushash që do ta mbështesnin ose garantonin trajtim të barabartë sipas ligjit për anëtarët e komuniteteve LGBTIQ+.

232. KPK vazhdon të mbajë një mekanizëm për gjurmimin e krimeve të urrejtjes. Megjithatë, mbledhja e përgjithshme e të dhënave për krimet e urrejtjes mbetet e pamjaftueshme. Gjuha e urrejtjes ndaj komuniteteve të cënueshme dhe joshumicë vazhdon, veçanërisht në mediat sociale. Roli i zyrtarëve kundër diskriminimit në komuna dhe ministri duhet të forcohet me linja të qarta raportimi dhe përshkrime të detyrave. Ka pasur edhe incidente të gjuhës së urrejtjes ndaj komunitetit LGBTIQ+, veçanërisht në mediat sociale. Rastet e krimeve të urrejtjes kundër personave LGBTIQ+ ende nuk hetohen si duhet dhe nuk sillen para drejtësisë.²⁴² Rastet e shpifjes dhe të gjuhës së urrejtjes në internet dhe në mediat sociale rrallë trajtohen me përcjellje efektive gjyqësore.²⁴³

233. Në dhjetor të vitit 2021, QK e miratoi Projekt Kodin Civil, i cili është në pritje të miratimit nga Kuvendi i Kosovës në kohën e raportimit. OSHC-të shprehën shqetësimet dhe mospajtimet e tyre me trajtimin e pabarabartë dhe antikushtetues të komuniteteve LGBTIQ+ në Projekt Kodin Civil në lidhje me rregullimin e martesës dhe të bashkëjetesës. Më konkretisht, u ngritën shqetësime serioze për kushtetutshmërinë e dispozitave që e përcaktojnë martesën si marrëdhënie ndërmjet personave të sekseve të ndryshme. Ndërsa projektkodi civil përcakton se bashkimet civile midis çifteve të të njëjtit seks do të rregullohen me një ligj të veçantë në të ardhmen, OSHC-të dhe aktivistët e të drejtave të njeriut argumentojnë se dispozitat e tilla nuk janë në përputhje me ndalimin që ia bën Kushetuta diskriminimit në bazë të orientimit seksual.

240 Ibid.

241 Qendra Kosovare për Studime Gjinore & Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore, Mbrojtja nga Diskriminimi në Kosovë, 2021.

242 Komisioni Evropian (2021), [Raporti Vjetor për Kosovën](#)

243 Ibid.

234. Rekomandime

- KPK duhet të sigurojë zbatimin efektiv të dispozitave të reja të Kodit Penal që iu mundësojnë prokurorëve të bëjnë hetime dhe gjykatësve të shqiptojnë dënime më të ashpra kur vërtetohet se autori ishte i motivuar për kryerjen e një vepre penale në bazë të orientimit seksual të viktimës ose për shkak të një perceptimi në lidhje me orientimin seksual.
- Policia e Kosovës, Prokuroria dhe mediat duhet të veprojnë në rastet e gjuhës së urrejtjes dhe krimeve të urrejtjes ndaj komunitetit LGBTIQ+.
- Duhet të bëhen më shumë përpjekje për ta rritur ndërgjegjësimin anti-diskriminues në mesin e të gjitha grupeve të cenueshme duke përfshirë personat LGBTIQ+.
- Strehimoret duhet të jenë të pajisura për të mundësuar strehim të mjaftueshëm dhe mirëqenie të të gjithë personave LGBTIQ+, duke përfshirë personat transgjinerë.
- Duhet të ofrohet më shumë mbështetje për ta plotësuar nevojën në rritje për mbështetje psikologjike për personat LGBTIQ+.
- Institucionet kompetente (QK, KK) duhet të sigurojnë plotësimin e duhur të kornizës ligjore sa i përket njohjes gjinore në mënyrë që të garantohet përgjithmonë realizimi i kësaj të drejte.
- KK duhet t'i korrigjojë dispozitat jokushtetuese në lidhje me martesën dhe bashkëjetesën në Projekt Kodin Civil.
- Prokuroria dhe gjyqësori duhet t'i zbatojnë në mënyrë të mirëfilltë dispozitat në lidhje me elementin e "urrejtjes" në rastet penale;
- Prokuroria duhet t'i organizojë më mirë të dhënat lidhur me krimet e urrejtjes dhe gjuhën e urrejtjes ndaj grupeve të cenueshme.

7.7 Personat në lëvizje

235. Korniza ligjore e Kosovës e promovon dhe e lehtëson kthimin e sigurtë të "personave të zhvendosur brenda vendit" në nenin 156 të Kushtetutës, ndërsa njëkohësisht garanton asistencë në kthimin e pronës dhe posedimeve.²⁴⁴ Poashtu, në janar të vitit 2018, QK nxori Rregulloren nr. 01/2018 për Kthimin e Personave të Zhvendosur brenda Vendit (PZHBV) dhe Zgjidhje të Qëndrueshme. Rregullorja, mes tjerash, i përcakton përgjegjësitë e organeve kompetente, vendim-marrëse dhe zbatuese si dhe procedurat dhe kriteret e asistencës.

244 Kushtetuta e Kosovës (2008).

236. Mekanizmat institucionalë përgjegjës për asistimin e të kthyerve dhe PZHBV-ve janë të përcaktuar me Rregulloren nr. 01/208 dhe përfshin Komisionin Qendror për Ankesa, i cili bën shqyrtimin e ankesave. Sipas Rregullores, Komisioni Komunal për Kthim (KKK) duhet t'i përcjellë të gjitha rekomandimet e tij tek Komisioni Qendror për Rishikim (KQR) për miratim final. Megjithatë, KK i dorëzon vetëm rastet pozitive ndërsa rastet e tjera nuk përpunohen dhe kështu mbesin pa vendim final nga KQR.²⁴⁵

237. Ka mospërputhje të konsiderueshme në zbatimin e politikës për të kthyerit dhe PZHBV-të. Në bazë të kornizës ligjore të Kosovës, personave të zhvendosur iu garantohet e drejta për t'u kthyer në vendin e tyre të origjinës. Disa familje të kthyer që banojnë në banesa private janë subjekt i presionit të vazhdueshëm nga pronarët e tyre për t'u dëbuar, për shkak të kushteve të tyre të këqija socio-ekonomike, gjë që i lë ata të paafte për t'i mbuluar kostot e qirasë dhe faturat e shërbimeve. Poashtu, ka raste që janë miratuar nga Komisioni Qendror për Rishikim në vitin 2011 dhe ende nuk kanë përfutuar strehim. Projektet e lehtësuara vazhdojnë ta targetojnë vetëm një grup të komunave të përzgjedhura, kështu që ndihma për kthim në komunat e tjera është neglizhuar. Për më tepër, të kthyerit romë dhe ashkali nga Maqedonia e Veriut nuk kanë përfutuar nga ndihma për strehim pasi nuk janë marrë në konsideratë nga komuna e Obiliqit që nga viti 2017.²⁴⁶ Për më tepër, Ministria për Komunitete dhe Kthim nuk e ka zhvilluar Sistemin për Menaxhimin e të Dhënave i cili do t'iu jepte përparësi rasteve bazuar në kriteret e cenueshmërisë.

238. Një numër i kufizuar i të kthyerve dhe PZHBV-ve vazhdojnë të përballen me sfida/pengesa gjatë procesit të marrjes së dokumenteve të gjendjes civile. Fëmijët që lindin jashtë institucioneve dhe nuk kanë dokumente të prindërve, kanë vështirësi në marrjen e identitetit ligjor dhe në gëzimin e të drejtave të tyre dhe qasjes në shërbime. Ka probleme të tjera që ndikojnë në regjistrimin e lindjes së këtyre fëmijëve si mungesa e dokumenteve nga vendlindja (nënat) dhe gabime teknike në dokumente krahasuar me të dhënat në librat e gjendjes civile. Për më tepër, prindërit kanë një nivel të ulët të njohurive mbi procedurat dhe/ose adresimin e kërkesave për të drejtat e tyre. Rregullimi i këtij dokumentacioni përfshin kosto financiare, kështu që për shkak të gjendjes së tyre të keqe ekonomike, të kthyerit/PZHBV-të nuk ndërmarrin veprime përkatëse dhe nuk janë në gjendje të aplikojnë për ndihmë sociale ose përfitime të tjera sociale.²⁴⁷

239. Sipas të dhënave të sguaruara UNHCR, numri i të kthyerve në Kosovë për periudhën e raportimit ishte 473. Kjo është rritje e vazhdueshme në krahasim me vitin 2020 (191) dhe 2020 (394), siç shihet në tabelën në vijim.

245 AT (2021), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi Situatën e të Drejtave të Njeriut në Kosovë në vitin 2021.

246 Ibid.

247 Ibid.

Tabela 6: Të dhënat e UNHCR për personat e kthyer në Kosovë nga viti 2019 deri në 2021

	2019	2020	2021
Personat e kthyer	191	394	473

240. Kthimi vullnetar, spontan i personave të kthyer, duke përjashtuar koordinimin e akterëve përkatës të kthimit, po rezulton të jetë një detyrë shumë sfiduese. Kthimi i fundit i gruas serbe në komunën e Gjakovës ka shkaktuar reagim negativ nga komuniteti lokal, i cili publikisht e kundërshtoi një kthim të tillë nga frika e kthimit të mëtejshëm të mundshëm në këtë zonë.²⁴⁸ Kjo situatë u pasua nga incidente të sigurisë dhe refuzim të shërbimeve nga marketet lokale.

241. Nga 1 janari deri më 31 tetor 2021, në mbarë Kosovën janë regjistruar 31 incidente me të kthyerit/PZHBV-të e komuniteteve joshumicë. Serbët e kthyer vazhdojnë të jenë cak i vjedhjeve, gurëve, dëmtimeve pronësore dhe frikësimeve, duke krijuar kështu një perceptim negativ të situatës së sigurisë dhe duke ndikuar në procesin e pajtimit.

242. Për shkak të situatës politike dhe të sigurisë në Mitrovicën e Veriut, shqiptarët e zhvendosur kanë perspektiva të kufizuara për t'u kthyer në vendin e tyre të origjinës.

243. Kosova ende mbetet rrugë transiti për lëvizje të përziera. Deri në mesin e dhjetorit të vitit 2021, u paraqitën 538 kërkesa për mbrojtje ndërkombëtare dhe 33 prej tyre ishin me mbrojtje ligjore të njohur. Azilkërkuesit dhe refugjatët vuajnë nga ushqimi i pamjaftueshëm dhe nga qasja dhe trajtimi i kufizuar dhe selektiv brenda shërbimeve të ndihmës sociale, duke përfshirë Qendrën për Punë Sociale, zyrat komunale për komunitete dhe kthim, zyrat komunale të punësimit për të përmendur vetëm disa prej tyre. Si çështje shqetësuese është regjistruar edhe pasiguria fizike dhe sociale në Qendrën e Azilit në Magurë.²⁴⁹

244. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit ndërmjet BE-së dhe Kosovës vendos themelin për bashkëpunim ndërmjet BE-së dhe Kosovës në lidhje me azilin dhe një pikëpamje drejt reflektimit të standardeve të përfshira në Konventën e Gjenevës të vitit 1951 lidhur me statusin e refugjatëve.²⁵⁰ Këtu hyn edhe Protokolli i vitit 1967 i cili siguron parimin e moskthimit dhe të drejtat e njeriut për azilkërkuesit dhe refugjatët.

245. Ligji Nr. 06/L-026 për Azilin ofron një bazë të shëndoshë ligjore e cila garanton qasjen në territor dhe respektimin e parimit të moskthimit, kushtet e pritjes, qasjen në procedurat e përcaktimit të statusit të refugjatit, lirinë e lëvizjes dhe alternativat ndaj ndalimit. Ligji ofron edhe një kornizë ligjore që e rregullon bashkimin familjar duke kontribuar kështu në procesin e integritetit të refugjatëve me status të njohur në Kosovë. Ligje të tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe të

248 [Telegrafi](#) (2021),

249 PSHDC (2022) kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut 2021.

250 [Stabilization and Association agreement between the European Union and the European Atomic Energy Community, of the one part, and Kosovo](#) (2015).

drejtat e njerëzve në lëvizje përfshijnë Ligjin Nr. 04/L-219 për të Huajt, i cili përcakton refugjatët konform standardeve të përcaktuara ndërkombëtarisht dhe Ligjin Nr. 04/L-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit. Me rëndësi është Ligji nr. 04/L-219 për të Huajt i cili iu jep prioritet masave alternative ndaj ndalimit të të huajve, kur është e mundur.

246. Njerëzit në lëvizje përballen me rrezik të shtuar të infektimit me COVID-19 për shkak të aftësisë së tyre të kufizuar për respektimin e masave të distancës fizike dhe qasjes së kufizuar në ushqimin e duhur, PPM, produkte higjienike dhe barna esenciale për sëmundjet kronike.²⁵¹ Këto çështje kanë pasur implikime për të drejtat e tyre për jetë, shëndet dhe ushqim adekuat. Megjithatë, institucionet shëndetësore të Kosovës ua kanë mundur qasjen në procesin e imunizimit dhe një numër i konsiderueshëm i azilkërkuesve dhe refugjatëve janë vaksinuar.

247. Rekomandime

- Duhet të rritet koordinimi në nivel lokal dhe qendror dhe QK duhet të zhvillojë një qasje për adresimin e ndjenjat negative në rast të kthimit spontan individual;
- Autoritetet komunale duhet të nisin aktivite të ngritjes së besimit në zonat me të kthyer serb-K;
- Përkundër faktit se institucionet e Kosovës i kanë bërë hapat e parë drejt integritit të refugjatëve me status të njohur në Kosovë, nevojitet më shumë mbështetje institucionale për përfshirjen e tyre në mundësi socio-ekonomike;
- QK duhet të sigurojë qasje në të drejta dhe shërbime themelore për të gjithë azil kërkuesit dhe refugjatët me kohë dhe t'i përmirësojë kushtet e jetesës në të gjitha qendrat e azilit në Kosovë;
- QK duhet ta rrisë bashkëpunimin dhe koordinimin ndërinstitucional për t'u përgjigjur me efektivitet ndaj nevojave dhe kërkesave të refugjatëve me status të njohur dhe personave me status të mbrojtjes shtesë në Kosovë për integrimin e tyre ligjor dhe socio-ekonomik.

251 Ibid.

8. Pjesa D: ÇËSHTJE TË NDËRLIDHURA/ ÇËSHTJE SPECIFIKE LIDHUR ME TË DREJTAT E NJERIUT

8.1 Drejtësia tranzicionale dhe të drejtat e njeriut

248. Hartimi i një strategjie ndërkombëtare gjithpërfshirëse për drejtësinë tranzicionale në Kosovë, deri më tani, është penguar nga nismat paraprake që vuanin nga “mungesa e koordinimit”.²⁵² Megjithatë, adresimi i të kaluarës është njohur si pjesë thelbësore e tranzicionit të Kosovës në një shoqëri demokratike: Trajtimi i ankesave dhe ofrimi i drejtësisë sociale dhe kompensimit të luftës për viktimat hap mundësitë për paqe dhe pajtim. Qeveria aktuale ka dëshmuar një nevojë për një qasje gjithpërfshirëse kombëtare në kontekstin e drejtësisë tranzicionale. Si rrjedhojë, Ministria e Drejtësisë e ka caktuar grupin punues prej dhjetë ekspertësh për hartimin e strategjisë kombëtare me një program bërthamë të drejtësisë dhe dëmshpërblimit për viktimat e krimeve të luftës.

249. Një koncept dokument që ka të bëjë me themelimin e një Mekanizmi të autorizuar nga qeveria për dokumentimin e krimeve të luftës është hartuar nga Ministria në vitin 2021 dhe është ndryshuar përmes grupit punues të emëruar pas konsultimeve të afërta me organizata të ndryshme të të drejtave të njeriut dhe me OSHC-të relevante. Arsyeja për themelimin e këtij mekanizmi është përcaktuar në tekstin e dhënë në uebfaqen zyrtare, si në vijim, “dokumentimi i cenimeve të rënda të të drejtave të njeriut përmes krimeve të luftës mund të ndimohet të arrihet drejtësia për viktimat dhe shoqërinë dhe kështu të luajë rol kyç në drejtësinë tranzicionale”.²⁵³ Përkundër këtij objektivit të përgjithshëm, OSHC të ndryshme, duke përfshirë YIHR KS-në, e kanë kritikuar dokumentin në bazë të disa mangësive. Në veçanti, në përshkrim nuk është detajuar se çfarë mund të specifikohet si krim lufte në Kosovë. Shtyllat e drejtësisë tranzicionale që ngrihen në të drejtat themelore të viktimave për të vërtetën, për dëmshpërblime dhe për mospërsëritje nuk janë trajtuar sa duhet në këtë dokument. Ngjashëm, mes tjerash, dokumenti nuk e ka një plan të shtjelluar që i anashkalon përshkrimet e njëanshme dhe që i qaset të kaluarës në një mënyrë që është etnikisht gjithpërfshirëse dhe shumë-dimensionale. Për momentin, mbetet të përgjigjet pyetja se si do të përcaktohet ky Mekanizëm nga nocionet relevante. Në këtë aspekt, themeli për diskurse gjithpërfshirëse është vendosur përmes OSHC-ve relevante. Nisma Parimet e Ballafaqimit me të Kaluarën (Parimet BMK) si nismë e dalluar në Ballkan dhe më gjerë i ka përcaktuar gjithsej dhjetë parime për të ndihmuar në drejtimin e diskursit publik për mënyrën si duhen trajtuar viktimat, të mbijetuarit dhe e kaluara e Kosovës.²⁵⁴ Mbetet të shihet nëse këto parime do të merren parasysh në strukturat e mekanizmit të ri.

252 [Balkan Insight](#) (2021).

253 Shih [draft konceptin](#) (2021)

254 [Parimet BMK në Kosovë](#) (2021).

250. Që nga përfundimi i mandatit ekzekutiv dhe gjyqësor të EULEX-it, Prokuroria Speciale (PS) ka marrë mbi 900 raste dhe ka pranuar 100 raste të reja të krimeve të luftës. Me vetëm katër prokurorë, PS vuan nga numri i tepërt i lëndëve dhe mungesa e mbështetjes. Në vitin 2021, Kodi i ndryshuar i Procedurës Penale (KPP) u miratua nga Kuvendi i Kosovës për t'i bërë të mundura gjykimet që përfshijnë shkeljen e pretenduar të të drejtave ndërkombëtare të njeriut në mungesë. Kjo mund t'i përshpejtojë procedurat penale pasi që i pandehuri nuk duhet të jetë fizikisht i pranishëm për t'u paraqitur në gjyq dhe nuk kërkohet njohuri për vendndodhjen e tij/saj.²⁵⁵ Po ashtu, baza elektronike e të dhënave për krimet e luftës e zhvilluar për Njësinë për Hetimin e Krimeve të Luftës në Policinë e Kosovës (PK, Njësia për Hetimin e Krimeve të Luftës) me mbështetjen e Organizatës së Kombeve të Bashkuara aktualisht përfshin dy raste plotësisht të dixhitalizuara²⁵⁶ dhe ka qenë instrument i rëndësishëm për procesimin e rasteve penale. QBPZH e ka mbështetur PK-në, Njësinë për Hetimin e Krimeve të Luftës, në digjitalizimin e të gjitha (5,711) dosjeve fizike të personave të zhdukur.²⁵⁷ Për më tepër, QBPZH në bashkëpunim me EULEX e ka krijuar serverin ku futen të gjitha dosjet e personave të zhdukur. Kjo bazë e të dhënave së shpejti do të jetë në dispozicion të institucioneve përkatëse dhe akterëve të tjerë. PK-ja po përdor edhe bazën e të dhënave për hetimin e rasteve të personave të zhdukur. Në vitin 2021, Këshilli i Sigurimit i OKB-së raportoi për vendimet e nxjerra në dy raste të krimeve të luftës. Në mars të vitit 2021, gjykatat e Kosovës nxorën aktgjykime për dy raste të krimeve të luftës, duke përfshirë dy aktgjykime që përfshijnë dy ish-pjesëtarë të Policisë së Serbisë, të cilët u shpallën fajtorë për krime lufte kundër civilëve shqiptarë në fshatrat Nerodime e Epërme, në rajonin e Ferizajit. Poashtu, në mars të vitit 2021, një shqiptar-K u vendos në paraburgim mbi dyshimin se ka kryer krime lufte në Skënderaj.²⁵⁸ Në korrik të vitit 2021, Gjykata Themelore e Prishtinës e shpalli një ish-polic serb të Kosovës fajtor për krime lufte, duke përfshirë përdhunimin dhe dëbimin e civilëve shqiptarë dhe e dënoi atë me 10 vite burgim.²⁵⁹ Vendimi ishte një aktgjykim historik pasi që përbën dënimin e parë për dhunë seksuale në lidhje me konfliktin (DHSLK) nga gjykatat e Kosovës.²⁶⁰ Më pas, në tetor të vitit 2021, Gjykata Themelore e Prishtinës e shpalli Goran Stanisiqin fajtor për krime lufte ndaj popullatës civile në Lipjan dhe e dënoi me 20 vite burgim.²⁶¹

251. Aktualisht, dy kriminelë të dënuar të luftës vazhdojnë të ushtrojnë pozita publike duke përfshirë edhe shefin ekzekutiv të Arkivit Shtetëror të Kosovës, Bedri Zyberaj. Lahi Brahimaj, i cili është drejtor i përkohshëm i administratës në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës, ka qenë i dënuar nga Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë.²⁶²

252. Në shtator të vitit 2021, Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) filloi gjykimet e para kundër ish-pjesëtarëve të UÇK-së për krime lufte. Ekzistenca e Gjykatës kontestohet gjerësisht nga

255 Drita Hajdari (2021) në [Balkan Insight](#).

256 Raporti i Këshillit të Sigurimit të OKB-së (2021), [Raporti Vjetor për Kosovën](#).

257 Qendra Burimore për Persona të Zhdukur (2022), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2021.

258 Ibid.

259 Ibid.

260 Ibid.

261 [Gjykata Themelore e Prishtinës](#) (2021).

262 Tribunali Ndërkombëtar Penal për Ish-Jugosllavi (2021), [përmbledhje e aktgjykimit](#).

popullata shqiptare. Pas publikimit të dokumenteve të ndjeshme, PS e akuzoi udhëheqjen e Shoqatave të Veteranëve të Luftës së UÇK-së për pengimin e drejtësisë dhe frikësimin e viktimave.²⁶³ Në shtator, u arrestuan shtatë protestues të Partisë Social-Demokrate (PSD) pas pengimit të një aktiviteti të organizuar nga DHSK dhe kryetarja e saj.²⁶⁴

253. E drejta për të vërtetën është një komponent i brendshëm i drejtësisë tranzicionale që e kthen vëmendjen tek familjet e personave të zhdukur dhe e drejta e tyre për ta sqaruar fatin e të dashurve të tyre. Deri në vitin 2021, ende nuk është ndriçuar fati i 1,622 personave të zhdukur (263 gra dhe 1,359 burra) si rezultat i konfliktit në Kosovë në vitet 1998-1999. Shumica e personave të listuar si të zhdukur janë shqiptarë, por ka edhe persona të zhdukur me prejardhje serbe dhe rome. Komisioni Qeveritar i Kosovës për Personat e Zhdukur (KQKPZH) është agjencia qeveritare e ngarkuar me hetimin e rasteve të personave të zhdukur. KQKPZH merr pjesë në Delegacionin e Prishtinës në Grupin Punues për Persona të Pagjetur në lidhje me Ngjarjet në Kosovë (zakonisht i referuar si Grupi Punues për Personat e Zhdukur - GPPZH). I themeluar në vitin 2004, Grupi Punues merret me këmbimin e informatave dhe e përfshin Komisionin Serb për Persona të Zhdukur në Beograd. Më 26 maj, GPPZH njoftoi për përfundimin e gërmimeve në varrezën masive në Kizhevak (komuna e Rashkës) në Serbi pas vazhdimin të gërmimeve më 5 maj 2021, pasi që ishin pezulluar nga nëntori i vitit 2020 për shkak të kushteve të këqija të motit. U zhvarrosën mbetjet mortore të së paku nëntë individëve, duke përfshirë dy të cilët ishin identifikuar gjatë fazës së parë të procesit të gërmimeve në varrezën masive në Rudnicë të Serbisë si viktima të masakrës së Rezallës në të cilën u vranë së paku 80 civilë. Në fund të shtatorit, Kosova dhe Serbia këmbyen me njëra-tjetrën mbetjet mortore të tre serbëve-K të zhdukur të zhvarrosur në Kosovë dhe mbetjet e shqiptarëve-K të zhvarrosur në Kizhevak, respektivisht. Sipas Ligjit Nr. 4/L-023 për Personat e Zhdukur,²⁶⁵ KQKPZH mbledh, organizon dhe mban të dhënat personale të personave të zhdukur në Regjistrin Qendror të personave të zhdukur. Në vitin 2021, u zhvarrosën mbetjet mortore të tre personave të zhdukur nga një varr masiv dhe u rivarrosën në varrezat e Shipolit në Mitrovicën Veriore. Kjo vjen pas zhvarrosjes së mbetjeve mortore të 11 viktimave në varreza të fshehura në vitin 2020 dhe pas zhvarrosjes së trupave të katër viktimave të tjera. KQKPZH i ka mbështetur ceremonitë e rivarrosjes në bashkëpunim të ngushtë me institucionet komunale dhe familjet e personave të zhdukur.

254. Procedura e ndryshimit për Ligjin Nr. 04/L-023 për Personat e Zhdukur në Kosovë filloi në vitin 2021 dhe është përgjegjësi qendrore e QK-së në vitin 2022. Sipas Qendrës Burimore për Persona të Zhdukur (QBPZH), e drejta për të ditur mbetet e shkelur, e politizuar dhe e ndaluar në vazhdimësi me ndryshimin e kushteve politike të Kosovës dhe marrëdhënieve të Kosovës me Serbinë.²⁶⁶ Afati kohor i ligjit mund të ndryshojë, duke i përjashtuar kështu personat që janë zhdukur pas konfliktit të vitit 1998-1999 në Kosovë.

255. Në gusht të vitit 2021, Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (KNPZH) publikoi një udhëzues praktik me praktikat dhe parimet e zbatuara nga institucionet përkatëse në përpjekjet e tyre për të dhënë llogari për vendndodhjen e personave të zhdukur si rezultat i ngjarjeve të viteve 1990 në Jugosllavi. Qëllimi i udhëzuesit është t'i informojë njerëzit pasi publiku i informuar është

263 Komisioni Evropian (2021), [Raporti Vjetor i Progresit](#).

264 [Balkan Insight](#) (2021).

265 Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur (2021, f. 35-40), [Resolving the Missing Persons Issue in the Western Balkans. A Q&A Topical Guide](#).

266 QBPZH (2022), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2021.

"parakusht për ta mbështetur sundimin e ligjit dhe për të siguruar qasje në drejtësi".²⁶⁷

256. Bashkëpunimi i ndërsjellë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për shkëmbimin e të dhënave të kohës së luftës dhe rasteve të personave të zhdukur mbetet i vështirë. Të vërtetat dhe narrativat reciproke ekskluzive të konfliktit në Kosovë e kufizojnë ndërveprimin ndërmjet të dyjave në zgjidhjen e ngjarjeve dhe shkëmbimin e informatave për rastet e lidhura me konfliktin. Dy OSHC, Nisma e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut (YIHR) Kosovë dhe Serbi iu kanë bërë thirrje të dy delegacioneve që të nxjerrin një marrëveshje publike për shkëmbimin e arkivave sekrete, pasi që kjo mund të ndihmojë në zbulimin e vendndodhjes së personave të humbur.²⁶⁸ Në deklaratën e tyre të përbashkët, të dy organizatat e YIHR-së artikulojnë nevojën për ndryshimin e ligjeve për personat e zhdukur në mënyrë që Konventa e OKB-së për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë (2007) të zbatohet për krimet që lidhen me rastet e personave të zhdukur.

257. Puna e GCMP nuk është transparente sa duhet, siç raporton NSI. Komisionit i mungon një uebfaqe zyrtare funksionale, dhe si rezultat, qasja e publikut të gjerë në informacione rreth punës së tyre është e mangët. Njësoj, edhe pse e garantuar me ligj, dhe përkundër përpjekjeve të Sindikatës së Shoqatave të Familjeve të Personave të Rrëmbyer dhe të Zhdukur (SShFPRrZh), Kryeministri i Kosovës ende nuk e ka emëruar një zëvendëskryetar nga komunitetet joshumicë në KQPZH.²⁶⁹

258. Krahas presionit të ushtruar nga shoqëria civile, edhe akterët e kulturës janë përpjekur ta përcjellin zërin e publikut të gjerë duke i kërkuar qeverisë që t'i zgjidhë rastet e personave të zhdukur. Një ekspozitë artistike e titulluar "Më i mirë ish varri sesa mos me ditë" u zhvillua nga nëntori 2021 deri në janar 2022 për të nxjerrë në pah nevojën që autoritet t'i intensifikojnë përpjekjet e tyre për ndriqimin e fatit të personave të zhdukur në lidhje me luftën e viteve 1998-1999.²⁷⁰ Megjithatë, përkujtimi gjithmonë kërkon një qasje më gjithpërfshirëse dhe të drejtuar që fokusohet në përvojat e të gjitha komuniteteve.

259. Në vitin 2021, u ngrit një pllakë përkujtimore nga Komuna e Podujevës për viktimat e bombardimeve të NATO-s më 1 maj 1999. Megjithatë, pllaka mban emrat e 31 viktimave shqiptare-K, duke i përjashtuar 13 viktimat serbe-K që poashtu e humbën jetën në këtë ngjarje tragjike.²⁷¹

260. Një dimension thelbësor i qasjes së drejtësisë tranzicionale është dhuna seksuale e lidhur me konfliktin (DHSLK). Sipas Ligjit nr. 04/L-054 për Pensionin familjar pas vdekjes së invalidit të UÇK-së dhe nr. 04/L-172 për Statusin dhe të Drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave të dhunës seksuale të luftës, viktimave civile dhe familjeve të tyre, të mbijetuarit e dhunës seksuale të lidhur me luftën në Kosovë gjatë periudhës 1998-1999 kanë të drejtë të marrin statusin e viktimës së dhunës seksuale.²⁷² OSHC-të kanë

267 Ibid., f. 2

268 [Balkan Insight](#) (2021).

269 [NSI për Radio Kontakt Plus](#).

270 [Balkan Insight](#) (2021).

271 [Kossev](#) (2021).

272 Raporti i referohet Ligjit për Statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave të dhunës seksuale të luftës, viktimave civile dhe familjeve të tyre.

avokuar për përfshirjen e të mbijetuarve të DHSLK-së pas datës zyrtare të përfundimit të luftës. Raporti i Këshillit të Sigurimit të OKB-së për vitin 2021 dhe Raporti i Komisionit Evropian i vitit 2021, në mënyrë të pavarur theksojnë se që nga themelimi i tij në 2018, KQNVS ka pranuar 1528 aplikime individuale nga të cilat 987 deri më tani janë pranuar për statusin e viktimës së dhunës seksuale gjatë kohës së luftës dhe 222 raste janë refuzuar. Stigma shoqërore e lidhur me dhunën seksuale të lidhur me konfliktin i pengon përpjekjet e qeverisë për t'iu ofruar individëve mbështetje materiale dhe psiko-sociale. Në vitin 2018, qeveria licencoi katër OJQ për t'i ndihmuar të mbijetuarit t'i dorëzonin aplikimet e tyre.²⁷³

261. Në vitin 2021, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara raportoi për vendimin historik kundër një ish-pjesëtari të policisë rezerviste serbe, i cili u dënua për DHSLK. Ky është dënimi i parë i bërë nga strukturat e gjykatave lokale të Kosovës për DHSLK.

262. Për herë të parë që nga konflikti i armatosur, është iniciuar një projekt nga Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) me qëllim të dokumentimit të krimeve të dhunës seksuale të kryera gjatë konfliktit. Përveç rasteve të përpunuara nga QKRMT, dokumentacioni përfshin edhe rastet e menaxhuara nga organizatat partnere dhe OJQ-të e licencuara. Baza e të dhënave është gjithëpërfshirëse pasi përfshin të gjitha komunitetet dhe vendndodhjet gjeografike ku janë kryer krimet seksuale. Dokumentacioni nuk kufizohet vetëm me periudhën zyrtare të konfliktit të përcaktuar me ligj, por përfshin edhe raste konflikti të dhunës seksuale të kryera pas vitit 1999 dhe si pasojë janë refuzuar nga Komisioni Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë luftës në Kosovë. Baza e të dhënave është e qasshme përmes faqes zyrtare të QKRMT-së, ndërsa rastet janë publikuar përmes raportit “E drejta për të vërtetën – Viktimat pa emër” të vitit 2021.

263. Dispozitat për dëmshpërblime të garantuara me Ligjin nr. 04/L-054 për Statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave të dhunës seksuale të luftës, viktimave civile dhe familjeve të tyre mbetet diskriminues ndaj komuniteteve joshumicë.²⁷⁴ Ndërkohë që data zyrtare e përfundimit të konfliktit në Kosovë përkufizohet si fundi i qershorit 1999, shumë vrasje, raste të DHSLK dhe zhdukje kanë ndodhur pas asaj date. Në veçanti, shumica e viktimave të konfliktit pas vitit 1999 i takojnë komuniteteve joshumicë si pasojë e hakmarrjes nga shqiptarët.²⁷⁵

264. Rekomandime:

- Edhe pse numri i prokurorëve që merren vetëm me krime të luftës është rritur nga dy në katër, ky numër duhet të rritet edhe më tej;
- Të gjithë zyrtarët, duke përfshirë zyrtarët policorë, prokurorët dhe gjykatësit duhet të marrin trajnime të specializuara për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të luftës dhe krimeve të tjera sipas të drejtës ndërkombëtare;

273 [Balkan Insight](#) (2021).

274 [Ligji nr. 04/L-054](#).

275 [HLC](#) (2016).

- Duhet të hiqet kufiri kohor për të mbijetuarit e dhunës seksuale të lidhur me konfliktin për të aplikuar për ta marrë statusin si të tillë dhe për njohje të paraparë me Ligjin nr. 04/L-054 për Statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave të dhunës seksuale të luftës, viktimave civile dhe familjeve të tyre;
- QK duhet t'i mbështesë edhe më tej dhe të realizojë fushata të gjera për të mbijetuarit e DHSLK në mënyrë që të luftohet stigma pasi që ajo i parandalon shumë të mbijetuar/a nga aplikimi për status;
- Institucionet e Kosovës duhet të marrin një qasje gjithëpërfshirëse për të siguruar dokumentacionin e duhur dhe gjithëpërfshirës për ta përkujtuar luftën në formën e një muzeu, shënimit e dukshëm të vendeve të krimit dhe forma të tjera të përkujtimit. Nismat duhet të përmbahen nga politizimi i mëtejshëm i çështjeve të drejtësisë tranzicionale dhe të jenë në përputhje me një qasje të përqendruar në të drejtat e njeriut dhe viktimave.

8.2 Korrupsioni dhe të drejtat e njeriut

265. Lidhja mes korrupsionit dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut, ndër të tjera ka të bëjë me qasjen e barabartë në dispozita, drejtësi dhe siguri. QK ka priorizuar një sërë masash kundër korrupsionit në strategjinë e re dhe planin e veprimit për periudhën 2021-2026. Sipas Raportit të OKB-së,²⁷⁶ qeveria është në procesin e 'vettingut' në sistemin e drejtësisë dhe në hartimin e një ligji të ri për t'i adresuar pronat e paligjshme. Në këtë aspekt, raporti i Komisionit të BE-së shton se realizimi i mundshëm i një rivlerësimi të plotë të të gjithë prokurorëve dhe gjykatësve është shqetësues, duke deklaruar që duhet të jetë "opsioni i fundit, pasi të jenë shfrytëzuar të gjitha mjetet dhe mekanizmat për të siguruar integritet dhe për ta luftuar korrupsionin në mbajtësit e zyrave gjyqësore".²⁷⁷

266. Sa iu përket masave kundër korrupsionit në gjyqësor, është funksionalizuar Departamenti i Korrupsionit dhe Krimin Financiar në PSK. Kodit Penal të Kosovës i është shtuar edhe një masë kundër korrupsionit, e cila thotë se të gjitha aktgjykimet e lexuara duhet të motivohen nga një arsyetim që lexohet para të gjithë përfaqësuesve ligjorë. Megjithatë, siç shënon Drejtësia Sot, gjyqtarët në shumë raste vazhdojnë të shkojnë kundër detyrimit të tyre ligjor për t'i motivuar dhe publikuar vendimet e tyre.

267. Mungon vullneti dhe ndjekja e vazhdueshme e agjentëve publikë për ta luftuar korrupsionin e përhapur në nivelin më të lartë të qeverisë. Sipas IKD-së, rastet e profilit të lartë nuk përcillen sa duhet me aktgjykim të formës së prerë. Ata përmendin një sërë rastesh, duke përfshirë akuzat ndaj ish-kryetarit të Komunës së Lipjanit, Shukri Buja, të cilat filluan në mars të vitit 2011, për shkak të dyshimeve se e kishte shpronësuar pronën e qeverisë. Edhe pse ai u dënua me burgim efektiv në tri

²⁷⁶ Raport i Këshillit të Sigurimit të OKB-së (2021), [Raport Vjetor për Kosovën](#).

²⁷⁷ Komisioni Evropian (2021), [Raporti Vjetor i Progresit](#).

raste, rastet skadojnë në mars të vitit 2021. Një tjetër çështje e rëndësishme e profilit të lartë që ka të ngjarë të përfundojë pa një vendim përfundimtar përfshin gjashtë të akuzuarit në rastin FAN që përfshin ish-deputetin e Lidhjes Demokratike (LDK), Naser Osmani. Ata akuzohen se e kanë keqpërdorur pozitën e tyre në Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) pas privatizimit të Fabrikës së Armaturës Ndërtimore (FAN). Sipas prokurorisë, Agim Deshishkut i ka sjellë përfitim pasuror prej 5,400,000 euro, duke e dëmtuar buxhetin e qeverisë dhe punonjësit e kësaj ndërmarrje. Rasti kundër tyre do të përfundojë më 20 janar 2022 pa mundësi për leximin e një vendimi të formës së prerë pasi që proceset e rigjykimit në shkallë të parë ende nuk kanë filluar. Krahas këtyre rasteve, IKD ka publikuar një listë të hollësishme të rasteve të tjera të profilit të lartë të përfshira në korrupsion, të cilat me gjasë do të rrezikojnë të parashkruhen në vitin 2022 si rezultat i proceseve aktuale gjyqësore.²⁷⁸

268. Qeveria e Kosovës ka punuar ngushtë me organizatën ndërqeveritare Nisma Rajonale Kundër Korrupsionit për ta luftuar korrupsionin dhe për t'i afruar mekanizmat institucionalë në përputhje me kornizat përkatëse të BE-së dhe OKB-së. Megjithatë, integriteti i Kosovës në raport me vlerësimet ndërkombëtare është në rrezik pasi zyrtarët në pozita qeveritare dhe publike janë arrestuar dhe akuzuar për akte të mëdha të korrupsionit dhe ryshfetit.²⁷⁹ Ngjashëm, raporti i Komisionit të BE-së përshkruan një mungesë të madhe të zbatimit adekuat të rregulloreve ekzistuese me vonesa të raportuara në rishikimin e legjislacionit për financimin e partive politike.²⁸⁰

269. Po ashtu, përpjekjet e vazhdueshme të Policisë së Kosovës kanë rezultuar në rritje të numrit të arrestimeve për dyshimet për korrupsion dhe ryshfet. Sipas Raportit të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, 33 punonjës të Ministrisë së Bujqësisë janë arrestuar për financim të paligjshëm dhe nën dyshimin për ryshfet. Policia e Kosovës ka arrestuar edhe kryesuesin dhe një zyrtar tjetër të Komisionit të Pavarur për Media (KPM). Keqpërdorimi i gjerë i pozitave zyrtare vazhdon të jetë problem shqetësues në Kosovë. Përpjekjet e vazhdueshme të Policisë së Kosovës në vitin 2021 kanë rezultuar me arrestimin dhe ngritjen e aktakuzave ndaj dy kryetarëve të komunave, ish-ministrit për Integritime Evropiane dhe së fundmi ish-sekretarit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe zyrtarëve të tjerë për veprën penale marrje e ryshfetit në rastin shumë të njohur të Brezovicës.²⁸¹

270. IKD ka monitoruar gjithsej 4,706 seanca gjyqësore në Gjykatat e Kosovës; 1,234 në Departamentin e Krimeve të Rënda, 232 në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë, 2,044 seanca në Divizionin Penal, 942 në Divizionin Civil të Departamentit të Përgjithshëm, 106 të tjera në Departamentin për Çështje Administrative, 35 në Gjykatën Ekonomike, 74 në Gjykatën e Apelit dhe 39 seanca në Dhomat e Specializuara në Hagë. Nga këto seanca të monitoruara, 708 prej tyre kanë qenë raste të korrupsionit me 14 zyrtarë të profilit të lartë. Deri më tani nuk është marrë asnjë aktgjykim në të cilin është dënuar ndonjë zyrtar i lartë publik me burgim efektiv.

271. Sipas një raporti të fundit të Indeksit të Performancës së Institucioneve të Sundimit të Ligjit në Kosovë (IPISLK), popullata e përgjithshme e rendit Policinë e Kosovës në mesin e institucioneve më efektive që mund ta luftojnë korrupsionin në vitin 2021 (38.2 përqind e të anketuarve).²⁸² Për

278 IKD (2021), [Korrupsioni ne Prag te Vjetersimit](#).

279 IKD (2021), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2021.

280 Ibid.

281 [Kallxo](#) (2022).

282 GLPS (2021), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2021.

Për më tepër, publiku beson se Prokuroria është më efektive në luftimin e korrupsionit sesa gjykatat e Kosovës. Në luftën e Kosovës kundër korrupsionit, vetëm një numër i kufizuar njerëzish i besojnë efektivitetit të EULEX-it (7.8 përqind) dhe gjykatave (8.2 përqind). Kjo është befasuese pasi që EULEX-i ka udhëhoqur përpjekjet e kaluara në luftimin e nivelit të lartë të korrupsionit në Kosovë. Krahasuar me EULEX-in dhe gjykatat, mediat (13.16 përqind) dhe Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit (AKKK) (16.6 përqind) perceptohen më mirë nga popullata e përgjithshme.

271. Rekomandime:

- Kryetari i trupit gjykues duhet të ofrojë shkurtimisht një arsyetim prapa aktgjykimit të dhënë kundër të akuzuarit nëse i akuzuari është duke u dënuar, liruar apo nëse rasti është hedhur poshtë;
- Si akterë qendrorë të drejtësisë, prokuroria dhe gjykatat duhet ta rrisin përfshirjen e tyre në luftën kundër korrupsionit dhe ta rrisin besimin e publikut në këto institucione;
- Prokurorët në Departamentin për Korrupsion dhe Krim Financiar në PSRK duhet të emërohen në bazë të kritereve të meritës, ndërsa Prokuroria e Kosovës dhe PSRK-ja duhet të investojnë në vazhdimësi në ngritjen profesionale të prokurorëve në këtë departament;
- PSRK duhet ta rrisë numrin e rasteve të hetimeve ex officio;
- PSRK duhet ta themelojë një departament për luftën kundër korrupsionit;
- Duhet të përshpejtohet rishikimi i legjislacionit për financimin e partive politike dhe të miratohen ndryshimet.

8.3 Mjedisi dhe të drejtat e njeriut

272. Të drejtat e njeriut nuk mund të gëzohen pa një mjedis të qëndrueshëm, të sigurt dhe të shëndetshëm. Efektet negative të ndryshimeve klimatike kërcënojnë gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat për një mjedis të qëndrueshëm, të sigurt dhe të shëndetshëm, të drejtën për jetë, ujë, sanitari, ushqim, shëndet, strehim, vetëvendosje, kulturë dhe zhvillim.²⁸³ Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor synon ta pasqyrojë Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane në mënyrë proporcionale dhe të përshtatur në Ballkanin Perëndimor. Qëllimi është të shndërrohen sfidat rajonale mjedisore dhe klimatike në mundësi. Duke qenë se burimet natyrore dhe ndryshimet klimatike nuk njohin kufij, Agjenda e Gjelbër parashikon veprime të përbashkëta rajonale, të cilat do të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik dhe rimëkëmbjen e gjelbër të të gjithë rajonit në periudhën pas pandemisë. Kosova duhet të kontribuojë duke e zbatuar me sukses këtë vizion të përbashkët rajonal me një ambicie të lartë. Si të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, Kosova e miratoi Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor në Samitin e Sofias në nëntor të vitit 2020. Marrëveshja e Gjelbër Evropiane kërkon një transformim të plotë të ekonomisë

283 [OHCHR](#) (2022).

së Kosovës, transportit dhe shumë faktorëve të tjerë, dhe si e tillë, varet edhe nga një konsensus për të ardhmen e gjelbër të Kosovës. Kjo është veçanërisht e rëndësishme, duke pasur parasysh se ndryshimi i klimës është ndër sfidat më të rëndësishme globale me të cilat është përballur njerëzimi në historinë e tij. Hulumtimet, raportet dhe analizat shkencore ndërkombëtare tregojnë se ngrohja globale po ndryshon në mënyrë drastike. Kosova nuk bën përjashtim nga kjo. Të dhënat e fundit meteorologjike tregojnë se Kosova po përballlet me dimër të butë, pranverë të lagësht, reshje të dendura shiu që shkaktojnë përmytje dhe thatësira, gjë që nuk ndodhte para rreth një dekade.

273. Kosova ka ndërmarrë një sërë veprimesh për monitorimin e ndryshimeve klimatike dhe përshtatjen dhe zbutjen e ndikimeve që i shkaktojnë ato. Kosova është duke punuar në hartimin e Ligjit për Klimën, ndërsa aspekte të tjera që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike janë integruar në legjisllacion, si në Ligjin për Mjedisin, Ligjin për Mbrojtjen nga Ndotja e Ajrit, Ligjin për Ujërat dhe legjisllacioni dhe aktet e tjera nënligjore. Aktet nënligjore përfshijnë udhëzime administrative për respektimin e udhëzimeve për emetimet e gazit, ekonominë e karburanteve dhe emetimet e CO₂ të automjeteve.

274. Emetimet e gazrave serrë si rezultat i aktivitetit njerëzor janë ndër kontribuesit kryesorë të ndryshimit të klimës dhe degradimit të mjedisit. Kosova ka përgatitur inventarin e emetimeve të gazrave serrë për vitet 2008-2019, i cili tregon se emetimet vjetore të gazrave serrë janë afro 9.6 milionë tonë CO₂. Burimi kryesor i emetimeve është prodhimi i energjisë (86 përqind), i ndjekur nga bujqësia dhe menaxhimi i tokës (8 përqind), plehrat me 5 për qind, ndërsa përpunimi industrial kontribuon me rreth 1 për qind. Sektori i bujqësisë është i vetmi sektor që kontribuon në uljen e emetimit të CO₂, me rreth -39,000 ton në vit.²⁸⁴

275. Raporti i BE-së për Kosovën për vitin 2021 theksoi se, në përgjithësi, Kosova ka një nivel të përgatitjes në fushat që kanë të bëjnë me Agjendën e Gjelbër dhe lidhjen e qëndrueshme dhe po merr pjesë aktive në takimet e Komunitetit të Transportit dhe Komunitetit të Energjisë. Raporti poashtu theksoi se Kosova ka bërë disa përparime gjatë periudhës së raportimit në sektorin e energjisë, veçanërisht me rritjen e investimeve të saj në burimet e ripërtëritshme. Pavarësisht këtij progresi, Kosova mbetet shumë e varur nga thëngjilli. Është bërë përparim i kufizuar në fushën e transportit, mjedisit dhe ndryshimeve klimatike. Kosova duhet ta rrisë ndjeshëm ambicien e saj për t'i zbatuar siç duhet standardet e BE-së për transportin dhe mjedisin. Kapacitetet administrative duhet të përforcohen në të gjithë sektorët. Strategjitë, planet e veprimit dhe legjisllacioni duhet të jenë më të qëndrueshme në të gjithë sektorët dhe duhet të jenë në përputhje me parimet dhe objektivat e Agjendës së Gjelbër.

276. Për më tepër, kanë filluar shumë aktivitete dhe fushata lidhur me gjendjen e mjedisit në Kosovë. Megjithatë, asgjë nuk duket se ka ndikuar në rritjen e ndërgjegjësimit të shoqërisë për rreziqet që paraqet mjedisi. Njerëzit përjetojnë kërcënime mjedisore të dorës së parë çdo ditë, duke filluar nga mohimi i të drejtës themelore të njeriut për qasje në ujë të pijshëm e deri te dëmtimi i vazhdueshëm i peizazhit natyror të Kosovës, shpesh përmes veprimtarive të paligjshme biznesore. Edukimi i pamjaftueshëm, ligjet e pazbatuara, politika e dobët mjedisore dhe keqinformimi i medias kontribuojnë në degradimin e vazhdueshëm të mjedisit. Janë ngritur dhjetëra padi kundër

284 Ibid.

kundër ndotësve në Kosovë që vazhdojnë të operojnë pa asnjë ndërhyrje ligjore, kryesisht për shkak se nuk raportohen nga mediat dhe nuk shihen si të rëndësishme nga autoritetet përgjegjëse.

277. Pavarësisht miratimit të ligjeve për mbrojtjen e ajrit dhe kornizës së ngjashme legjislative, Kosova është ende larg përmbushjes së standardeve të BE-së. Gjendja e ajrit në rajon është dëshmuar të jetë e dëmshme për popullsinë dhe mjedisin. Efektet shëndetësore të ndotjes së ajrit në Kosovë përfshijnë sëmundjet akute të frymëmarrjes, gjendjen e përkeqësuar të pacientëve që vuajnë nga problemet e zembrës dhe astmës, kanceret e shkaktuara drejtpërdrejt nga ndotësit, irritimet e syve ose hundës, stresi dhe dëmtimi i mirëqenies së përgjithshme. Poashtu, ndotja e ajrit ka ndikim të rëndësishëm mjedisor dhe ndikon drejtpërdrejt në florën dhe faunën. Për më tepër, efektet në shëndet dhe mjedis krijojnë edhe kosto të konsiderueshme në treg, si reduktimi i produktivitetit të punës, kosto shtesë shëndetësore dhe humbje e prodhimit bujqësor. Organizata Botërore e Shëndetësisë ka kryer një studim mbi ekspozimin e popullsisë ndaj PM në Kosovë për t'i analizuar efektet shëndetësore në popullsi. Studimi ka treguar se në 1000 vdekje në Kosovë, 6 janë për shkak të ndotjes së ajrit. Kontribuesit kryesorë në ndotjen e ajrit në Kosovë përfshijnë qymyrit që digjet nga termocentralet e KEK-ut, emetimet e transportit rrugor dhe djegia e drurit dhe qymyrit në familje si burim kryesor i energjisë.

278. Edhe lumenjtë e Kosovës vazhdojnë të përballen me degradim, ndotje, madje edhe keqpërdorim, pasi që po përdoren thjesht si burime. Hidrocentralet e udhëhequra në mënyrë të pahijshme i kanë dëmtuar si komunitetet lokale ashtu edhe biodiversitetin, ndërsa lumenjtë janë kthyer edhe në rezervuarë për të gjitha llojet e mbeturinave. Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë në Kosovë në vitin 2011, vetëm rreth 56 për qind e njerëzve kanë qasje në sistemin e kanalizimit. Shumica e mbeturinave në Kosovë përfundojnë në deponitë rajonale, duke shkaktuar një fatkeqësi mjedisore, për shkak të kontaminimit të tokës dhe ujërave nëntokësore. Emetimi i gazrave, përfshirë metanin, gjatë dekompozimit të mbeturinave në këto vende çon në zjarre të vazhdueshme. Kosova është shndërruar edhe në vendgrumbullim të automjeteve të vjetruara që janë nxjerrë jashtë përdorimit në vendet evropiane për shkak të emetimeve të tyre të dëmshme. Përdorimi i lëndëve djegëse fosile në industri dhe varësia e Kosovës nga qymyri për energji nënkupton që lëndët djegëse fosile shpesh e gjejnë rrugën e tyre për në tregun e zi, ku klientët i përdorin ato për t'i ngrohur familjet dhe bizneset.

279. Në tetor të vitit 2021, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që tri hidrocentrale në afërsi të qytetit të Deçanit duhet të mbyllën si termocentrale operuese pasi që do të mund të shkaktonin dëm të pariparueshëm për banorët vendas dhe mjedisin. Pas vendimit, Kelkos Energy, investitori kryesor i hidrocentraleve në Ballkan, hoqi dorë nga paditë ndaj dy aktivistëve, Shpresa Loshaj dhe Adriatik Gacaferi, të cilët kanë protestuar vazhdimisht kundër hidrocentraleve. Ky veprim erdhi edhe pas kritikave të shprehura nga Amnesty International, e cila i shihte paditë si një mënyrë për t'i frikësuar dhe heshtur ambientalistët.²⁸⁵

285 Ibid.

280. Rekomandime:

- QK duhet të ndërmarrë veprime vendimtare që përfshijnë krijimin e një inventarizimi të emetimeve të gazrave serrë si instrument kyç për identifikimin e burimeve kryesore të emetimeve në mënyrë që të marrë masa për t'i reduktuar aktivitetet që kontribuojnë drejtpërdrejt në ndryshimet klimatike;
- QK duhet të konsiderojë zhvillim e një angazhimi bashkëpunues thelbësor dhe të përmirësuar ndërmjet OSHC-ve dhe institucioneve qeveritarë në nivel qendror dhe lokal. Duke vepruar kështu, ajo do të synojë të sigurojë pjesëmarrje aktive dhe cilësore në politikë dhe vendimmarrje, në proceset e monitorimit për OSHC-të dhe njerëzit përmes proceseve të përcaktimit të prioriteteve në nivel komunal dhe rritjen e ndërgjegjësimit për dobitë e praktikave më të mira në fushat prioritare të Agjendës së Gjelbër;
- QK duhet ta ketë parasysh se legjitimiteti i qeverisë nuk rritet vetëm nga ofrimi i shërbimeve, por duke i përfshirë njerëzit në procesin e vendimmarrjes. Në mënyrë pozitive me QK-në, partnerët e projekteve synojnë të punojnë dhe ta promovojnë angazhimin gjithëpërfshirës të njerëzve, grave, të rinjve, personave me aftësi të kufizuara dhe të gjitha grupeve të tjera tradicionalisht të përjashtuara nga proceset vendimmarrëse si shtyllë themelore e demokracisë.

